

prof. dr. Gordana Lazhetiq  
dr. Nevena Petrovska  
prof. dr. L Lazar Nanev



**DORACAK**

**PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE  
NGA DHUNA NË BOTËN DIGJITALE**

shtator, 2020

**Autorë:**

prof. dr. Gordana Llazhetiq

dr. Nevena Petrovska

prof. dr. Llazar Nanev

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

004.738.5.056.5-053.2(035)

LLAZHETIQ, Gordana

Doracak për sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në botën digjitale / Gordana Llazhetiq, Nevena Petrovska, Llazar Nanev. - [Kavadarci] : [Këshilla për parandalimin kundër delikuençës së të miturve], 2020. - 86 стр. : илустр. ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 84-85

ISBN 978-608-66233-2-6

1. Petrovska, Nevena [автор] 2. Nanev, Llazar [автор]

а) Интернет -- Безбедност -- Деца -- Прирачници

COBISS.MK-ID 52677893



Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup

Shkup, shtator 2020

# PËRMBAJTJA

Parathënie	7
<b>PJESA I</b>	<b>9</b>
KARAKTERISTIKAT HYRËSE	9
1.1. Dedikimi dhe qëllimi i Doracakut	10
1.2. Fëmijët e kohës së internetit – Karakteristikat e kohës digjitale	10
1.3. Mitet dhe të vërtetat mbi dhunën digjitale	14
1.4. Përfitimet dhe rreziqet për fëmijët nga shfrytëzimi i internetit	16
<b>PJESA II</b>	<b>19</b>
PËRGJIGJET INSTITUCIONALE DHE KORNIZA RELEVANTE JURIDIKE	19
2.1. Vërejtje hyrëse	20
2.2. OKB	20
2.2.1. Raportuesi i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për dhunën ndaj fëmijëve	20
2.2.2. Grupi i punës ndërmjet resorëve për dhunë ndaj fëmijëve	21
2.2.3. Dokumentet e OKB-së	21
2.3. UNICEF-i (UNICEF)	22
2.4. Këshilli i Evropës	22
2.4.1. Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijës (2016-2021)	23
2.4.2. Komiteti i Këshillit të Evropës për Krim Kompjuterik	24
2.4.3. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Internet	25
2.5. BE	26
2.5.1. EU Kids Online 2020	26
2.6. EUROPOLI	27
2.7. KOVID-19 te fëmijët dhe roli i shkollës në transmetimin e virusit	28
2.8. Legjislatura vendase	28
2.8.1. Kodi penal	28
2.8.2. Ligji për arsim fillor	29
2.8.3. Ligji për arsim të mesëm	29
2.8.4. Ligji për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje	30
<b>PJESA III</b>	<b>31</b>
MEDIAT SOCIALE DHE FORMAT E KOMUNIKIMIT NË INTERNET	31
3.1. Hyrje	33
3.2. Raporti i shprehive të fëmijëve në internet	33
3.2.1. Si funksionon Interneti?	34
3.2.2. Konceptet e reja të internetit	34
3.2.3. Çfarë është çat/chat?	34
3.2.4. Çfarë është forumi?	35

3.2.5. Çfarë është blogu?	35
3.2.6. Çfarë është telefoni celular?	35
3.2.7. Rreziqet nga "miqtë me maska"	35
3.2.8. Mënyra e mbrojtjes	36
3.2.9. Popullariteti i platformave sociale	36
3.2.10. Diskord/Discord	37
3.2.11. Snapçat/Snapchat	38
3.2.12. Instagrami/Instagram	39
3.2.13. Tuiteri/Twitter	40
3.2.14. Tamblr/Tumblr	41
3.2.15. GrupMi/GroupMe	41
3.2.16. Kik Mesinxher/Kik Messenger	41
3.2.17. Tik Tok/TikTok	42

## **PJESA IV** **45**

<b>DHUNA NDAJ FËMIJËVE NË AMBIENTIN DIGJITAL</b>	<b>45</b>
4.1. Nocioni dhe përkufizimi i dhunës digjitale	46
4.2. Karakteristikat, format e dhunës digjitale dhe dallimet nga dhuna klasike	47
4.3. Format e dukurisë së dhunës nëpërmjet internetit	49
4.3.1. Komunikimi onlajn me qëllim të keqpërdorimit seksual (grooming)	49
4.3.2. Ndjekja nëpërmjet Internetit (cyberstalking)	51
4.3.3. Shfrytëzimi i profileve të rrejshme me qëllim të dëmtimit të viktimës (catfishing)	51
4.4. Trauma si pjesë e dhunës në internet	52
Nocionet dhe terminologjia e rëndësishme për dhunën digjitale	53

## **PJESA V** **57**

<b>SHKOLLA DHE DHUNA DIGJITALE</b>	<b>57</b>
5.1. Shënime hyrëse	58
5.2. Hulumtimi i realizuar	58
5.3. Parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna digjitale ndërmjet nxënësve në shkollë dhe jashtë saj	60
5.3.1. Programi për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna	62
5.4. Njohja dhe zbulimi i dhunës digjitale ndërmjet nxënësve ose dhunës së fëmijës nga një i moshuar (pedofil)	63
5.4.1. Nivelet e dhunës	63
5.4.2. Profili i fëmijëve viktimë – shenjat e dhunës digjitale	68
5.4.3. Si të reagojë mesimdhënësi / bashkëpunëtori profesional dhe si të bisedojë me nxënësit që janë viktimë të dhunës digjitale	69
5.5. Parandalimi, denoncimi, ndihma dhe përkrahja në trajtimin e fëmijës viktimë dhe fëmijës që kryen dhunën digjitale	71
5.5.1. Veprimi me një nxënës viktimë të dhunës digjitale	71
5.5.2. Profili i nxënësit që ushtron dhunë digjitale	73
5.5.3. Profili i nxënësve dëshmitarë ose vëzhgues të dhunës digjitale	73
5.6. Roli i shtetit dhe prindërve në parandalimin, zbulimin dhe pengimin e dhunës digjitale	74
5.6.1. Krijimi i rrjetit për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna digjitale në kuadër të komunitetit	74

5.6.2. Pse është i rëndësishëm bashkëpunimi i institucioneve të sistemit?	75
5.6.3. Kujdesi për fëmijët dhe kujdesi prindëror në erën e internetit	75
Këshilla për prindërit/kujdestarët për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna digjitale	76
<b>KONKLuzion</b>	<b>79</b>
Burimet e shfrytëzuara (sipas renditjes së citimit):	84



## PARATHËNIE

Përpilimi i Doracakut të veçantë për sigurinë e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna në botën digjitale u imponua si domosdoshmëri në kushte të një pandemie më afatgjate të virusit korona, me kufizimet e imponuara të lëvizjes, kontakteve, mënyrën e re të jetesës, format e reja të socializimit digjital, por edhe për shkak të rreziqeve që shumëfishohen në të a.sh “përditshmëri e re”.

Doracaku i kushton vëmendje shumë aspekteve në lidhje me botën digjitale, fëmijëve për rreziqet e internetit, dhunës digjitale, por edhe përfitimeve nga shfrytëzimi i platformave të reja digjitale, programeve kompjuterike, arritjes së aftësive dhe njohurive etj.

Dokumentet ndërkombëtare dhe legjislatura vendase i rregullojnë të drejtat e fëmijëve në botën digjitale, por edhe format e mbrotjes së tyre nga rreziqet që ndonjëherë vështirë vërehen, për të reaguar në kohë, për tejkalimin e pasojave etj.

Me transferimin e të gjitha aktiviteteve në sferën “online” të veprimit në nivel ditor, shumëfishohen edhe mundësitë dhe rastet për dhunë ndaj fëmijëve në ambientin digjital, për të cilin nuk kemi informata të mjaftueshme.

Duke marrë parasysh sistemin për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, në kushte të pandemisë dhe rasteve të rritura të dhunës familjare, mbyllja e shkollave dhe pamundësia e fëmijëve të kenë qasje deri te shërbimet profesionale psikologjike-pedagogjike të cilët janë të trajnuar dhe të aftë për të njohur, paraqitur dhe vepruar në rastet kur nxënësi është i ekspozuar ndaj dhunës (në shtëpi, në shkollë, në raste të dhunës nga moshatarët etj.), vetëm se përkeqëson gjendjen dhe kontribuon për rritjen e numrit të fëmijëve që janë viktimë e dhunës.

Është me rëndësi të veçantë prindërit dhe mësimmësuesit të jenë në hap me zhvillimin teknologjik, sepse përndryshe hendeku i gjeneratave bëhet edhe më i dukshëm dhe më i thelluar. Kjo gjendje e pamundëson identifikimin, njohjen e rreziqeve dhe masat për parandalim, pengim ose përgjegjësi.

Përvojat ndërkombëtare (The State of the World’s Children 2017) tregojnë se ekzistojnë gjashtë aktivitete prioritare për shfrytëzimin e fuqisë së digjitalizimit, prej së cilës kanë dobi fëmijët më të rrezikuar, si dhe për kufizimin e rrezikut që i përcjell më të cenuarit:

1. të gjithë fëmijëve t’u sigurohet qasje e pranueshme e burimeve të internetit me cilësi të lartë;
2. mbrojtja e fëmijëve nga rreziqet “online” – përfshirë keqpërdorimin, eksploatimin, tregtinë, sulmet kompjuterike dhe ekspozimin ndaj materialeve joadekuate;
3. mbrojtja e privatësisë dhe identitetit të fëmijëve në internet;
4. arsimimi digjital i fëmijëve që të jenë të informuar, të angazhuar dhe të sigurt në internet;
5. avancimi i standardeve etike dhe standardeve që i mbrojnë dhe nga të cilët fëmijët kanë dobi në internet, si dhe
6. vendosjen e fëmijëve në qendrën e politikës digjitale.

Agjenda 2020 e OKB-së për zhvillim të qëndrueshëm potencon domosdoshmërinë për sigurimin e sinergjisë ndërmjet Konventave të Budapestit, Stambollit dhe Lanzarotit me qëllim të ngritjes së vetëdijes për

dispozitat e këtyre konventave, shfrytëzimin e tyre në ndërtimin e kapaciteteve dhe këshillave për vendet, inkorporimin e autorizimeve procedurale dhe mjeteve për bashkëpunim ndërkombëtar.

Rekomandimi i Këshillit të Evropës nga viti 2018 i cili i përmban Udhëzimeve për respektimin, mbrojtjen dhe plotësimin e të drejtave të fëmijëve në ambientin digjital, e potencon nevojën për zhvillimin dhe forcimin e iniciativave dhe programeve për ngritjen e vetëdijes që do t'u mundësojë fëmijëve të kuptojnë dhe të ballafaqohen me përmbajtjet e dëmshme potenciale, sjelljen e dëmshme potenciale dhe pasojat potenciale nga mënyra se si informatat për fëmijët ose ato që jepen prej tyre mund të përhapen më tutje.

Për shkak të të gjitha këtyre arsyeve të cekuara më lart, autorët janë të bindur se përmbajtja e këtij Doracaku do të kontribuojë për pasurimin e njohurive nga sfera digjitale të mësimeve dhe shërbimeve profesionale në shkolla, në bazë të së cilës mund të pritët identifikim më i lehtë i rreziqeve të ndryshme të dhunës, formave të shfaqura të dhunës dhe gjetjes së përgjigjeve dhe zgjidhjeve më adekuate për tejkalimin e pasojave nga dhuna.

Shkup, shtator 2020

Autorët

**Pjesa I**

KARAKTERISTIKAT HYRËSE

## 1.1. Dedikimi dhe qëllimi i Doracakut

Shoqëria bashkëkohore po ballafaqohet me fenomen të ri të dhunës ndaj fëmijëve nëpërmjet teknologjisë informatike – komunikuese ose dhunës digjitale. Për këto arsye imponohet nevoja për krijimin e sistemeve efikase të parandalimit dhe mbrojtjes së fëmijëve, por edhe të trajtimit adekuat dhe përkrahjes gjatë shërimit të fëmijëve të cilët janë ballafaquar me dhunë në sferën digjitale.

Doracaku për sigurinë e fëmijëve në botën digjitale dhe mbrojtjen nga dhuna u dedikohet mësimeve të personave profesional në shërbimet e shkollave, respektivisht pedagogëve, psikologëve, punëtorëve socialë ose defektologëve, respektivisht edukuesve specialë, edukatorëve dhe të gjithë personave që punojnë në sferën e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve nga dhuna, keqpërdorimi dhe neglizhenca.

Analizat tregojnë se rastet e dhunës nëpërmjet internetit janë rritur për 70% gjatë muajve mars dhe prill të vitit 2020, pikërisht në mes të pandemisë. Është fakt se koha e kaluar në internet rrit edhe mundësitë për forma të ndryshme të dhunës digjitale në mënyrë proporcionale, respektivisht koha e kaluar në internet krijon më tepër mundësi për shqetësim, dhunë dhe keqpërdorim.<sup>1</sup>

Për shkak të mënyrës së re të funksionimit të sistemit arsimor, vetëm 20% e maltretimeve ndodhin në shkollë, ndërsa sfera e internetit i përfshin 80% të pjesës tjetër. Edhe para pandemisë fëmijët kalonin shumë kohë para kompjuterit, ndërsa në kohë të pandemisë pjesën më të madhe të kohës së tyre e kalonin nëpër shtëpi ose në forma të tjera alternative për kujdes duke shfrytëzuar vazhdimisht internetin që u bë mënyrë themelore për mësim, por edhe për komunikim, argëtim, lojëra etj.<sup>2</sup>

Është me rëndësi të përmendet se sipas të dhënave në dispozicion për shtetet e ndryshme, gjendja në raport me dhunën bazuar në gjini në sferën digjitale është si vijon:

- në SHBA dy nga dhjetë femra të reja, në moshë 18-29 vjeç, kanë qenë të maltretuara seksualisht nëpërmjet internetit dhe një në dy femra u janë dërguar fotografi me përmbajtje eksplicite;
- në Kanada, një në pesë femra kanë deklaruar se kanë përjetuar shqetësime nëpërmjet internetit
- në Francë, 15% e femrave kanë deklaruar se kanë përjetuar ndonjë lloj forme të shqetësimit kibernetik;
- në Bashkimin Evropian, 1 në 10 femra kanë deklaruar se kanë përjetuar shqetësim kompjuterik që nga moshë 15-vjeçare.

Qëndrimi në shtëpi, lëvizja e kufizuar, restriksionet, janë sfidë për shëndetin mental edhe te të rriturit, ndërsa te fëmijët ajo mund të shumëfishohet. Së këndejmi, rrethanat e këtilla rezultojnë me rrezik që disa fëmijë, frustrimet e tyre t'i manifestojnë nëpërmjet internetit, me ç'rast shpeshherë bashkëmohatarët e tyre bëhen cak, respektivisht vitkima, por gjendja e këtillë, fatkeqësisht e rrit motivimin e predatorëve për keqpërdorime dhe për dhunë ndaj fëmijëve nëpërmjet internetit.

Në kohë të kushteve të jashtëzakonshme, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve nga virusi KOVID-19, është rritur nevoja për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në internet dhe shfrytëzimin e sigurt të teknologjisë digjitale. Fatmirësisht, viteve të fundit, veçanërisht në planin ndërkombëtar po punohet për rregullimin e të drejtave të fëmijëve në botën digjitale, njëkohësisht edhe për zhvillimin e shkathtësive për shfrytëzimin konstruktiv të internetit dhe mbrojtjes nga dhuna dhe rreziqet potenciale.

1 <https://www.pandasecurity.com/mediacenter/mobile-news/covid-19-cyberbullying/>.

2 <https://www.stopbullying.gov/resources/facts>.

## Me Doracakun për sigurinë e fëmijëve në botën digjitale dhe mbrojtjen nga dhuna insistohet që të arrihet:

- Mësimdhënësit dhe personat profesionalë në shërbimet e shkollave që janë të përfshirë në procesin edukativ-arsimor të të rinjve dhe fëmijëve, të kontribuojnë për sigurinë e nxënësve në internet dhe të krijojnë kushte dhe përkrahje për lëvizjen e tyre të sigurt në botën virtuale si dhe për të marrë përgjegjësi për sjelljen personale;
- Përodrimi i drejtë i internetit, nëpërmjet dhënies së udhëzimeve të zbatueshme për mësimdhënësit;
- Mësimdhënësit dhe shërbimet profesionale të nxiten të mësojnë në lidhje me mundësitë e teknologjisë digjitale dhe internetit, se si të përdoret drejt, të fitojnë njohuri dhe të zhvillojnë shkathtësi për arsimim digjital dhe kompetencë digjitale;
- Nxitje që të vazhdohet hulumtimi lidhur me rëndësinë, por edhe rreziqet që i sjell me vete interneti;
- Të fitohen informata dhe këshilla të caktuara se në cilën mënyrë mund të sigurohen dhe të kontribuojnë për shfrytëzimin e sigurt dhe konstruktiv të internetit dhe pajisjeve digjitale nga ana e fëmijëve në shkollë (parandalimi dhe intervenimi);
- Informatat, njohuritë dhe shkathtësitë e fituara të ndahen me fëmijët duke kontribuar në arsimimin e tyre digjital, por edhe t'i ndihmojnë se si të mbrohen dhe të shfrytëzojnë internetin në mënyrë të sigurt;
- Të nxitet bashkëpunimi brenda në shkollë – aktivitete të përbashkëta të mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve, si dhe bashkëpunim me institucione dhe ente të tjera me qëllim të shfrytëzimit të sigurt të internetit;
- Të zhvillohen vlera pozitive në pajtim me rregullat për siguri në botën digjitale dhe të njëjtat të zbatohen edhe praktikisht

## 1.2. Fëmijët e kohës së internetit – Karakteristikat e kohës digjitale

Interneti është burimi më i madh dhe i pashterrshëm i informatave në historinë e civilizimit njerëzor i cili kontribuoi drejt një digjitalizimi të plotë të funksionimit të përditshëm të njeriut.

Është e pamundur të përcaktohet përfshirja e informatave që janë të qasshme në internet në çdo kohë, sepse ato vazhdimisht rriten. Me arritjet e shpejta teknologjike, mjetet për shfrytëzimin e komunikimit në internet u bënë të lira dhe në dispozicion të çdokujt.

Komunikimi gjithnjë e më i shpeshtë dhe i përditshëm realizohet në hapësirën "online". Veçanërisht në këtë periudhë me paraqitjen e pandemisë së COVID-19 kur masat për mbrojtje parashohin distancë fizike ndërmjet njerëzve, shfrytëzimi i shërbimeve të internetit u bë domosdoshmëri dhe u zgjerua në sferat që deri më tani aspak nuk janë shfrytëzuar ose që janë shfrytëzuar në masë të kufizuar, siç është mësimi "online" për të gjithë nxënësit dhe studentët, dhënia e provimeve, puna nga shtëpia, pagesa e llogarive dhe parashtrimi i dokumenteve në institucione, e-tregtia, e-blerja etj.

Trendi i lidhjes sociale nga largësia shkaktoi ndryshime në mënyrën e funksionimit dhe dizajnit të internetit.

**U paraqitën shumë platforma për realizimin e “online” takimeve, dhënien e provimeve me kontroll si Zoom, Skype, Google Classroom etj., të cilat nxitën krijimin e miteve për operacione, procedura dhe pasoja të caktuara që në esencë kanë të bëjnë me informimin e pamjaftueshëm, njohuritë e pamjaftueshme, bindjeve të gabuara, pavetëdije për rreziqet, pasojat nga aktiviteti i mediave sociale, dhe në sferën e informimit digjital, komunikimit dhe veprimit digjital.**

Kuptimi i përfshirjes së drejtë të aktiviteteve digjitale, efekti i tyre, pasojat, rreziqet dhe mundësitë, paraqesin prezantim krahasues të të dhënave në raport me internetin në botë dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV) në formë tabelore:<sup>3</sup>

Në botë:	Në RMV
<ul style="list-style-type: none"> <li>√ Qasje në internet në vitin 2019, kanë pasur 55% e popullsisë së botës;</li> <li>√ Në Evropë qasje kanë pasur 58,8% e popullsisë;</li> <li>√ Në Evropë në të njëjtin vit 307.000.000 njerëz kanë pasur FB si një prej ueb-platformave më të vizituara, në mesin e të cilëve edhe fëmijë nën moshën 13-vjeçare;</li> <li>√ Koha mesatare e kaluar në FB është 20 minuta në javë, ndërsa 50% e popullsisë prej 18-24 vjeç kyçen menjëherë në FB pasi të zgjohen nga gjumi;</li> <li>√ Në FB në ditë publikohen 300.000.000 fotografi;</li> <li>√ Në FB ka rreth 83.000.000 profile të rrejshëm;</li> <li>√ Në nivel të BE-së hulumtimet flasin se 1 në 3 shfrytëzues të internetit janë fëmijë;</li> <li>√ Gjysma e shfrytëzuesve të internetit nga 11-16 vjeç kanë hasur me dhunë në internet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>√ Në vitin 2019, 81.8% e familjeve kanë pasur qasje në internet nga shtëpia;</li> <li>√ 72.9% e popullsisë e kanë shfrytëzuar internetin çdo ditë;</li> <li>√ Internet kanë shfrytëzuar 81.4% e popullsisë nga moshja 15-74 vjeçare;</li> <li>√ 9% e fëmijëve, gjatë ditës kalojnë më shumë se nëntë orë në internet, 41,2% nga dy deri në pesë orë, kurse nga dy orë 36,1% e fëmijëve;</li> <li>√ Softuer për kontroll prindëror kanë instaluar vetëm 8% të familjeve;</li> <li>√ 6% e personave të dënuar për pedofili të publikuar në Regjistër janë dënuar për vepra penale: Paraqitja e materialit pornografik ndaj fëmijëve dhe prodhim, shpërndarje të pornografisë të fëmijëve (neni 193 dhe 193-a të KP të RMV)</li> </ul>

3 Të dhëna të siguruar nga: <https://www.internetworldstats.com/stats4.htm>; <https://zephoria.com/top-15-valuable-facebook-statistics/>; [https://ec.europa.eu/education/education-in-the-eu/european-education-area/digital-education-action-plan-action-7-cybersecurity-in-education\\_en](https://ec.europa.eu/education/education-in-the-eu/european-education-area/digital-education-action-plan-action-7-cybersecurity-in-education_en); <http://www.stat.gov.mk/>; <https://aek.mk/>; <http://registarnapedofili.mk/>;

## Test për mësime dhënë

Kontrolloni!

Sa dini për dhunën digjitale ndaj fëmijëve?

Deklaratë	E vërtetë	Mit
1. Dhuna digjitale nuk mund ta lëndojë fëmijën dhe ai është i sigurt sepse është në shtëpi para kompjuterit		
2. Dhuna digjitale ndërmjet fëmijëve është normale, ajo është mënyrë që të bëjnë shaka, flertojnë, zgjedhin lider...		
3. Fëmijët dijnë më shumë për internetin se sa mësuesit dhe prindërit dhe për këtë nuk kanë se çfarë të mësojnë		
4. Fëmijët nuk mund të keqpërdoren seksualisht nëpërmjet internetit		
5. Publikimi i fotografive të fëmijëve është mundësi që fëmijët të përjetojnë dhunë digjitale		
6. Dhuna digjitale mund të shkaktojë pasoja të rënda emocionale te fëmijët, madje edhe vetëvrasje		

Përgjigjet mund t'i krahasoni me kolegët tuaj dhe të hapni diskutime për të njëjtat.

## 1.3. Mitet dhe të vërtetat mbi dhunën digjitale

Ekzistojnë interpretime të ndryshme, arsytetime dhe racionalizime të formave të caktuara të sjelljes së njerëzve në ambiente dhe kultura të ndryshme, që kanë dalë nga mungesa e njohurive për dukuri të caktuara sociale, përfshirë edhe dhunën digjitale.

Kur njerëzit nuk posedojnë fakte dhe njohuri të vërteta lidhur me dukurinë, konkretisht për dhunën digjitale ndaj fëmijëve, paraqiten forma specifike të besimeve dhe krijimit të miteve. Dhuna digjitale ndaj fëmijëve shihet nëpër një sërë bindjeve të shumta dhe besimeve që ekzistojnë ndërmjet njerëzve e që nuk korrespondojnë me të vërtetën, por të njëjtat mbijetojnë edhe me kohën mirë themelohen dhe marrin karakter prej së vërteti. Për këtë arsye, shkenca, ligjet, hulumtimet, opinioni profesional dhe zyrtar insistojnë që të japin sqarime të argumentuara (fakte dhe të vërteta), të cilat e sqarojnë dukurinë e ndërlikuar me një gjuhë të thjeshtë, në një mënyrë më ndryshe, të afërt me njerëzit dhe që ndihmojnë në heqjen e tabuve dhe paragjyqimeve që imponohen nga mitet.

<b>Mit</b>	Dhuna digjitale ndodh në botën virtuale dhe për këtë është më pak e rrezikshme se sa dhuna që ndodh në botën reale
<b>E vërtetë:</b>	Dhuna digjitale ndonjëherë mund të jetë më e rrezikshme se sa dhuna klasike, nga problemet e sjelljes e deri te vetëvrasja. <sup>4</sup> Ajo mund të zhvillohet vazhdimisht madje edhe kur të çkyçet kompjuteri ose telefoni celular, sepse njerëzit janë të gatshëm ta thonë ose ta bëjnë atë që nuk do ta thoshin në komunikim direkt, ndërsa për shkak të anonimitetit është zvogëluar frika e zbulimit ose dënimit.
<b>Mit:</b>	Fëmijët që janë të dhunshëm nëpërmjet internetit, zakonisht janë të dhunshëm edhe në komunikim direkt.
<b>E vërtetë:</b>	Edhe pse anonimiteti u konvenon fëmijëve që duan të lëndojnë dikë nëpërmjet internetit, prapëseprapë fëmijët që janë të prirur ndaj dhunës digjitale, zakonisht janë të dhunshëm edhe në botën reale sepse të dy llojet kanë motivin e njëjtë – qëllimin për të lënduar tjetrin.
<b>Mit:</b>	Dhuna digjitale e moshatarëve ndërmjet fëmijëve është normale, ajo është mënyrë e shakasë, flirtimit, imponimit ...
<b>E vërtetë:</b>	Dhuna digjitale e moshatarëve është sjellje e papranueshme që duhet të pengohet dhe duhet të kërkohen arsyet për sjelljen e atillë.
<b>Mit:</b>	Fëmijët dijnë më shumë për teknologjinë digjitale sesa prindërit e tyre dhe për këtë nuk kanë se çfarë të mësojnë nga të rriturit.
<b>E vërtetë:</b>	Pa marrë parasysh se një pjesë e prindërve më rrallë shfrytëzojnë teknologjinë e re se sa fëmijët e tyre dhe nuk kanë shkathtësi digjitale, prapëseprapë ata kanë se çfarë t'i mësojnë fëmijët e tyre, sepse kanë përvojë të madhe jetësore, dije, ndërsa të njëjtat rregulla që vlejné gjatë komunikimit direkt, vlejné dhe janë të dobishme edhe për komunikimin digjital.

4 <http://www.youtube.com/watch?v=ej7afkypUsc>

<b>Mit:</b>	Prindërit patjetër duhet të vendosin rregulla të rrepta, kufij dhe dënime për fëmijët në lidhje me shfrytëzimin e internetit, p.sh. kompjuteri është në dhomë për qëndrim të përbashkët që të mos mund të kyçen deri te përmbajtjet e rrezikshme.
<b>E vërtetë:</b>	Stili autoritar edukues i prindit që përmban kufij të rreptë, rregulla dhe dënime nuk është i dobishëm për edukimin e fëmijëve në asnjë ambient jetësor, ashtu edhe për këtë. Mund të ketë edhe efekt të kundërt. Jetojmë në një erë të digjitalizimit, me qasje në internet në çdo hap, në mënyrë që prindërit nuk mund të vendosin një kontroll të plotë të fëmijëve. Nevojitet që prindërit të ndërtojnë një raport të sinqertë dhe të drejtë me fëmijët, me respektimin dhe besimin e ndërsjellë, që do ta lehtësojë komunikimin prind-fëmijë dhe për të ndarë përvojat për shfrytëzimin e internetit. Është me rëndësi që prindërit të vendosin një baraspeshë ndërmjet privatësisë, lirisë dhe të drejtës së përzgjedhjes së fëmijës dhe masat e mbrojtjes, kjo varet edhe nga mosha dhe personaliteti i fëmijës.
<b>Mit:</b>	Dhuna digjitale ndaj fëmijëve më së shpeshti ndodh jashtë shkollës dhe për këtë janë përgjegjës vetë prindërit, e jo shkolla dhe mësimmshënësit.
<b>E vërtetë:</b>	Dhuna digjitale ndodh gjithkund dhe në çdo kohë. Ndodh deri sa fëmija është në shtëpi, në shkollë, në autobus, në terren sportiv... Kur dhuna ndodh jashtë shkollës, raportet ndërmjet fëmijëve dhe pasojat reflektohen edhe në shkollë dhe në ambientin shkollor. Komunikimi bëhet më i dhunshëm dhe më i thelluar, duke prekur edhe ambientin shkollor. Për këtë shkolla është shumë e rëndësishme në parandalimin, mbrojtjen, zbulimin dhe pengimin e dhunës digjitale ndaj fëmijëve.
<b>Mit:</b>	Dhuna digjitale nuk mësohet, nuk ka lëndë mësimore për këtë, fëmijët duhet spontanisht të mësojnë të mbrohen në internet, nëpërmjet tentimeve dhe nga gabimet.
<b>E vërtetë:</b>	Arsimimi digjital mësohet, fëmijët mund të fitojnë njohuri dhe shkathtësi se si të sillen në mënyrë të sigurt në internet dhe të mbrohen nga dhuna digjitale. Për arsimimin digjital të fëmijëve është e obliguar shkolla, respektivisht sistemi i arsimit formal dhe kjo është e rregulluar me ligj.

## 1.4. Përfitimet dhe rreziqet për fëmijët nga shfrytëzimi i internetit

Interneti solli mundësi pozitive në sferën e komunikimit, informimit dhe edukimit, shfrytëzimit të programeve kompjuterike, aplikacioneve, gjuhëve të huaja gjatë komunikimit, kërkime etj, duke e ngritur arsimimin informatik, por edhe solli rreziqe serioze.

Shfrytëzimi i internetit hapi një fushë të madhe për manipulim, keqpërdorim dhe terren për kryerjen e veprave penale, por edhe kontribuoi për shfrytëzimin e shkurtesave dhe shprehjeve të caktuara që fituan statusin e "Internet slengut".

Përfitimet nga interneti	Rreziqet nga interneti
√ mësimi, qasje falas deri te burimet arsimore dhe programet;	√ varshmëria nga përdorimi i tepërt i internetit dhe izolimi social;
√ vizita virtuale të bibliotekave, muzeve, ngjarje sportive, qyteteve bukuri natyrore;	√ ekspozimi ndaj përmbajtjeve të dëmshme, përmbajtje seksuale dhe pornografike, gjuhës së urretjes dhe mashtrimit nga predatorët;
√ gjetja e informatave të dobishme;	√ përfshirja në dhunën digjitale;
√ përkushtim për veten, zhvillimin e takenteve, mësimin e gjuhëve të huaja, mësimin e instrumenteve, shkathësive kompjuterike;	√ ekspozimi ndaj informatave të rrejshme që mund të shkaktojnë dëme;
√ komunikimi dhe bashkëpunimin me moshatarët nga e tërë bota;	√ qasja në platforma nën moshën e përcaktuar;
√ shfrytëzimin e video lojrave;	√ kontakt me persona që mund ta keqpërdorin seksualisht fëmijën;
√ hulumtime nga sfera të ndryshme;	√ shpërndarja e të dhënave personale të anëtarëve të familjes me të tjerët;
√ lehtësimi i mësimin të fëmijet me nevoja të veçanta;	√ keqpërdorimi dhe vjedhja e të dhënave personale;
√ argëtim dhe rekreacion (film, muzikë, lojra...);	√ eksploatimi komercial, shpallje, reklama, "online" blerje/shitje;
√ zhvillimin e shkathësive të ndryshme;	√ pedofilia dhe tregtia me njerëz/fëmijë;
√ shkëmbimin e njohurive dhe informatave etj.	√ kontakti me armë dhe përmbajtje për radikalizimin e të rinjve dhe kyçjen e tyre në aktivitete terroristike dhe aktivitete të tjera.

Në tabelën në vijim janë prezantuar klasifikimet e rreziqeve potenciale në të cilat janë të ekspozuar fëmijët në internet.<sup>5</sup>

5 Hasebrink et al., 2009-преземено од EU Kids Online Network: Hasebrink, Livingstone & Haddon, 2009.

LLOJI I RREZIKUT	ROLI I FËMIJËVE	
	Aktive	Pasive
<b>Përmbajtja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendosja e përmbajtjes së palejuar dhe potencialisht të dëmshme (fotografi eksplicite, video incizime, porosi të blogjeve, profile...)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përcjellja e materialit pornografik, përmbajtjeve të dhunshme dhe raciste</li> <li>Përcjellja e materialit në internet që mund të ketë pasoja të dëmshme (anoreksia, vetëvrasja etj.)</li> </ul>
<b>Kontakti</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Seksting</li> <li>Shqetësim dhe dhunë digjitale ndaj të tjerëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mashtrimi i fëmijëve</li> <li>Shqetësimi dhe dhuna digjitale ndaj fëmijës</li> </ul>
<b>Shërbime komerciale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shfrytëzim i pautorizuar i të drejtave autoriale</li> <li>Online bixhoz</li> <li>Online blerje të rrezikshme</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fëmija është viktimë e shpalljeve, spameve, sponsorisimeve</li> <li>Hyrje e pavetëdijshme në kontrata të blerjes së prodhimeve</li> </ul>
<b>Siguria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbulimi i të dhënave personale</li> <li>Hakimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Instalim i pavetëdijshëm i kodeve qëllimkëqija, viruseve etj.</li> <li>Viktimë e vjedhjes së identitetit ose mashtrimit</li> </ul>



**Pjesa II**  
PËRGJIGJET INSTITUCIONALE DHE  
KORNIZA RELEVANTE JURIDIKE



## 2.1. Vërejtje hyrëse

Në kushte të pandemisë e cila gjeneron rreziqe për dhunë digjitale, vëmendja pa dyshim orientohet ndaj aktiviteteve të organizatave ndërkombëtare dhe kornizave të shënuara në dokumentet ndërkombëtare të cilat ndërmarrin aktivitete, respektivisht që përmbajnë norma për mbrojtjen e fëmijëve nga format e ndryshme të dhunës ku ata mund të ekspozohen. Aktivitetet e organizatave ndërkombëtare si dhe korniza juridike që është pjesë e këtij kapitulli ka për qëllim të theksojë obligimin e shtetit për të ndërmarrë masa dhe aktivitete me qëllim të identifikimit të rreziqeve, edukimit të personave profesionalë për zbulimin dhe parandalimin e tyre nga pasojat ndaj fëmijëve.

Në këtë kontekst, rëndësi të veçantë kanë edhe potencimet në raport me mungesën e rolit që duhet ta kenë shkollat në edukimin dhe socializimin, kundrejt rreziqeve të internetit pikërisht për shkak të mësimit nëpërmjet platformave "online". Në këtë kontekst sipas UNICEF-it, me mbylljen e shkollave dhe masave të rrepta të kufizimit të lëvizjes, më shumë se 1,5 miliard fëmijë dhe të rinj janë mbështetur në këto forma digjitale të komunikimit që nënkupton edhe mësim edhe argëtim.

Për shkak të gjendjes së këtyre, rreziqet rriten sepse fëmijët nuk posedojnë njohuritë, shkathtësitë dhe resurset e nevojshme për të qenë të sigurt në Internet, janë të ekspozuar në rreziqe të ndryshme duke u bërë viktima të predatorëve sidomos për shkak të kohës së gjatë dhe të pastrukturuar që e kalojnë në Internet.<sup>6</sup> Më tepër se gjysma e popullsisë botërore ishte në kushte të karantinës në fillim të muajit prill 2020, ku masat e karantinës dhe politikave të izolimit rritën shfrytëzimin e internetit ndërmjet 50% dhe 70%.<sup>7</sup>

Prej shkollave kërkohet të forcojnë politikave për mbrojtjen e nxënësve, por edhe që të sigurohen se fëmijët kanë qasje të vazhdueshme deri te shërbimet psikosociale për këshillim nëpër shkolla. Korniza relevante juridike, pozicionimi institucional si dhe mekanizmat e ndryshëm janë të prezantuar në tekstin e mëtejshëm të këtij kapitulli.

## 2.2. OKB

### 2.2.1. Raportuesi i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për dhunën ndaj fëmijëve

Raportuesi i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, për dhunë ndaj fëmijëve për herë të parë është emëruar më 1 korrik të vitit 2009.

Ai parashtron raport direkt për Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, kryeson me Grupin e punës ndërmjet resoreve pranë OKB-së për dhunë ndaj fëmijëve dhe bashkëpunon ngushtë me një rreth të gjerë partnerësh, brenda dhe jashtë kornizave të OKB-së.

Mandati i Raportuesit të posaçëm është për periudhë prej tre viteve. Në nëntor të vitit 2012, Komiteti i tretë i Asamblesë së Përgjithshme pranë OKB-së ka miratuar me konsensus Rezolutën për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (A/67/152) me të cilën i rekomandohet Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së ta vazhdojë mandatin e Raportuesit të posaçëm për dhunë ndaj fëmijëve për tre vite të tjera.

Raportuesi i posaçëm është përfaqësues i pavarur për parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve, kujdeset vazhdimisht për efektet e dëmshme të dhunës ndaj fëmijëve dhe kontribuon në takimet strategjike në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe nacional, kontribuon për identifikimin e praktikave dhe përvojave të mira.

6 <https://www.unicef.org/press-releases/children-increased-risk-harm-online-during-global-covid-19-pandemic>

7 <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2020/brief-online-and-ict-facilitated-violence-against-women-and-girls-during-covid-19-en.pdf?la=en&vs=2519>

Në Deklaratën e liderëve, përfshirë edhe Raportuesin e posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për dhunën ndaj fëmijëve – Dhuna ndaj fëmijëve: Kriza e fshehur e pandemisë COVID-19,<sup>8</sup> ku veçanërisht potencohet se pandemia COVID-19 ka ndikime fatale në tërë botën duke i ekspozuar fëmijët në rrezik të madh ndaj llojeve të ndryshme të dhunës.

Rreziqet nga stresi dhe shqetësimi të fëmijët rriten me kufizimin e lëvizjes, humbjen e të ardhurave, izolimit, pranisë së vazhdueshme në shtëpi ku janë të pranishëm një numër i madh i anëtarëve të familjes me çka rritet rreziku nga dhuna në raport me fëmijët të cilët jetojnë në familje të dhunshme dhe disfunktionale. Njëkohësisht, aktivitetet nëpërmjet Internetit u bënë kyçe për mësim, përkrahje dhe lojë të shumë fëmijëve, me çka, gjithashtu u rrit ekspozimi i tyre ndaj sulmeve kompjuterike, sjelljes së rrezikshme në internet dhe eksploatimit seksual. Situata është e përkeqësuar edhe për shkak të mungesës së kontaktit me shokët e shkollës, mësimdhënësit, punëtorët socialë dhe hapësirës dhe shërbimeve të sigurisë që sigurohen nëpër shkolla. Duhet të shfrytëzohen platforma të sigurta për e-arsim nëpërmjet të cilave do të jepen këshillat për siguri të fëmijëve nëpërmjet internetit. Patjetër duhet të bëhet më shumë me qëllim të identifikohen dhe ndalohen aktivitetet e dëmshme kundër fëmijëve nëpërmjet internetit, përfshirë edhe realizimin e kontakteve dhe fitimin e besimit nga fëmija me qëllim të keqpërdorimit seksual dhe krijimit dhe distribuimit të fotografive dhe videove për keqpërdorimin seksual të fëmijëve.

### 2.2.2. Grupi i punës ndërmjet resorëve për dhunë ndaj fëmijëve

Në Grupin ndërmjet resorëve marrin pjesë: UNHCR, IOM, UNICEF, UNODC, ILO dhe Zyra e Raportuesit të posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për dhunë ndaj fëmijëve. Ajo ka definuar një platformë për veprim dhe marrjen e masave.<sup>9</sup>

Sipas qëndrimit të këtij grupi, të gjitha vendimet dhe aktivitetet që i tangojnë fëmijët duhet të udhëhiqen nga parimi i interes më të mirë për fëmijën në kontekst të Konventës për të drejtat e fëmijës.

### 2.2.3. Dokumentet e OKB-së

Në kontekst të mbrojtjes së fëmijës, OKB-ja ka miratuar disa dokumente, në mesin e të cilëve si më të rëndësishëm mund të përmenden si vijon:

- **Konventa për të drejtat e fëmijës** - dokumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar i cili i mbron të drejtat e fëmijëve, e krijuar, miratuar dhe ratifikuar në kohë kur interneti ishte në fazën e vet të hershme të zhvillimit dhe që nuk i njeh nocionet e ambientit digjital që sot paraqet “ambient natyror” të fëmijëve. Konventa në mënyrë të prerë nuk përmend dhunën nëpërmjet internetit, por për këtë përmban (neni 19 dhe 36) dispozita të prera dhe gjithëpërfshirëse, sipas të cilave, secili shtet nënshkruar është i obliguar të ndërmarrë masa adekuate ligjore, administrative, sociale dhe edukative/edukative për të mbrojtur fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mentale, lëndimit ose keqpërdorimit, neglizhimit ose veprimi joadekuat, maltretimit ose eksploatimit, përfshirë edhe keqpërdorimin seksual;
- **Protokolli Fakultativ i Konventës për të drejtat e fëmijës që ka të bëjë me shitjen e fëmijëve, prostitucionit të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve** - është miratuar në vitin 2002 dhe përmban definicionet për shitjen e fëmijëve (çdo veprim me të cilin fëmija bartet me qëllim të kompensimit ose çfarëdo përfitimi tjetër); prostitucionit të fëmijëve (shfrytëzimit të fëmijës në aktivitete seksuale me kompensim ose përfitimi tjetër) dhe pornografisë së fëmijëve (çdo prezantim në cilëndo mënyrë, të fëmijës që është kryer në aktivitete reale ose të stimuluar eksplicite seksuale, ose çfarëdo përfaqësimi të pjesëve seksuale të fëmijës për qëllime primare seksuale);

8 <https://violenceagainstchildren.un.org/news/leaders-statement-violence-against-children-hidden-crisis-covid-19-pandemic>

9 [https://www.ohchr.org/Documents/Events/COVID-19/Agenda\\_for\\_Action\\_IAWG-VAC.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/Events/COVID-19/Agenda_for_Action_IAWG-VAC.pdf)

- **Komenti i përgjithshëm nr. 24 (2019) i të drejtave të fëmijëve në sistemin e drejtësisë së fëmijëve**<sup>10</sup>, e zëvendësoi Komentin të Përgjithshëm nr.10 prej më herët (2007) lidhur me të drejtat e fëmijëve duke synuar qëllimet si vijon: të sigurojë shqyrtimin bashkëkohor të parimeve relevante të Konventës për të drejtat e fëmijës dhe të shpijë shtetet drejt zbatimit holistik të sistemeve për drejtësinë e fëmijëve duke potencuar rëndësinë e parandalimit, intervenimit të hershëm dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në të gjitha stadiumet e sistemit si dhe promovimin e strategjive kyçe për zvogëlimin e efekteve të dëmshme nga kontakti me sistemin e drejtësisë penale. Në kuadër të elementeve themelore të politikës gjithpërfshirëse për drejtësi të fëmijëve.

## 2.3. UNICEF-i

UNICEF-i në shtetin tonë është aktiv në kushte të pandemisë edhe në kontekst të këtij Doracaku, vëmendje meriton analiza me propozimet për politikën në lidhje me efektet sociale dhe ekonomike nga COVID-19 ndaj fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut<sup>11</sup>.

Konstatimet në lidhje me dhunën tregojnë se dhuna në familje është rritur gjatë kohës së COVID-19, me ç'rast fëmijët paraqesin pothuajse 10% të viktimave. Janë paraqitur edhe rastet e dhunës ndërmjet moshatarëve të fëmijët nën përkujdesje në format e reja të kujdesit në sistemin e mbrojtjes sociale. Pakënaqësia, frustrimet dhe zemërimi i fëmijëve mund të jetë rrezik për dhunë si rezultat i faktit që për shkak të restriksioneve dhe kufizimeve të lëvizjes, është pamundësuar e drejta e takimeve të fëmijëve dhe prindërve me të cilët ata nuk jetojnë.

## 2.4. Këshilli i Evropës

Tri konventa janë kyçe kur bëhet fjalë për analizimin e dhunës nëpërmjet internetit:

- **Konventa për krim kompjuterik e Këshillit të Evropës** (CETS No.185) e njohur ndryshe edhe si “Konventa e Budapestit”, miratimi i së cilës u imponua si nevojë për shkak të ndryshimeve të thella të shkaktuara nga digjitalizimi, konvergimi dhe globalizimi i vazhdueshëm i rrjeteve kompjuterike dhe nevojës së bashkëpunimit ndërmjet shteteve dhe luftës kundër krimit kompjuterik, si dhe nevojës për të mbrojtur interesat legjitime gjatë shfrytëzimit dhe zhvillimit të teknologjive informatike, duke marrë parasysh Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijëve nga viti 1989 dhe Organizatën Ndërkombëtare të punës për format më të këqija të punës së fëmijës nga viti 1999;
- **Konventa për mbrojtjen e fëmijëve nga eksploatimi seksual dhe keqpërdorimi seksual**, e njohur ndryshe edhe si “Konventa e Lanzarotit” paraqet hap të madh përpara drejt parandalimit të veprave penale seksuale ndaj fëmijëve, përndjekjeve të kryerësve dhe mbrojtjes së fëmijëve viktime duke u fokusuar në respektimin e të drejtave të fëmijëve, sigurimit të mirëqenies së tyre, konsiderimin e qëndrimeve, nevojave dhe kujdesit të tyre, si dhe veprimet në çdo kohë për interesar më të mira të tyre. Në Konventë janë të shënuara edhe vepra penale në lidhje me prostitucionin e fëmijëve, pornografisë së fëmijëve (prodhimit, ofrimit, distribuimit, posedimit dhe shikimit nëpërmjet internetit të pornografisë së fëmijëve) dhe krijimit të raportit me fëmijët për qëllime seksuale (grooming) që për herë të parë është rregulluar me marrëveshje ndërkombëtare. Nocioni “grooming” ka të bëjë me krijimin e kushteve për

10 <http://docstore.ohchr.org/SelfServices/FilesHandler.ashx?enc=6QkG1d%2FPPrICAqhKb7yhsqkirKQZLK2M58RF%2F5F0vEnG3QGKUxFivhTofjGxYjV05tUAlgpOwHQJsfPdJXCiixFSrDRwow8HeKLLh8cgOw1SN6vJ%2Bf0RPR9UMtGkA4>

11 <https://www.unicef.org/northmacedonia/mk/socialnrite-i-ekonomskite-efekti-od-KOVID-19-vrz-decata>

keqpërdorim seksual të fëmijës, motivuar nga dëshira për të shfrytëzuar fëmijën për kënaqje seksuale, aktivitete seksuale ose prodhim të pornografisë seksuale;

- **Konventa për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës familjare**, e njohur ndryshe si "Konventa e Stambollit, parasheh mbrojtjen e fëmijeve nga të gjitha format e dhunës, si dhe pengimin, ndjekjen dhe eliminimin e dhunës ndaj grave dhe dhunën familjare, por edhe eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave duke krijuar kornizë gjithpërfshirëse, politika dhe masa për mbrojtjen dhe ndihmën e të gjitha viktimave të dhunës dhe dhunës familjare.

### 2.4.1. Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijës (2016-2021)

Në këtë Strategji<sup>12</sup> vëmendje të veçantë u kushtohet të drejtave të fëmijës në botën digjitale që është një përditshmëri e pashmangshme e fëmijëve dhe adoleshentëve. Ata rriten në botën digjitale pa marrë parasysh mënyrën se si ajo realizohet (nëpërmjet kompjuterit, lojrave me konzolë, tabletëve ose telefonave të mençur) bota digjitale i ekspozon fëmijët në shumë mundësi. Qasja në Internet dhe arsimimi digjital kanë marrë një dimension të një aspekti të rëndësishëm në lidhje me të drejtat e fëmijës lidhur me lirinë e të shprehurit, pjesëmarrjes dhe arsimimit.

Ambienti digjital padyshim i ekspozon fëmijët ndaj përmbajtjeve të dëmshme, efektet e të cilëve manifestohen me probleme të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave dhe rreziqe të tjera, përfshirë edhe keqpërdorimin seksual. Me rëndësi të veçantë është që prindërit dhe mësuesit të luftojnë dhe të jenë në hap me zhvillimin teknologjik, sepse në të kundërtën nyja e gjeneratave bëhet më e dukshme dhe më e thelluar. Gjendja e këtillë pamundëson identifikimin, zbulimin e rreziqeve dhe ndërmarrjen e masave për parandalimin, pengimin ose përgjegjësinë.

Në këtë Strategji veçanërisht potencohen përpjekjet e Këshillit të Evropës për zgjidhjen e çështjes së dhunës në shkolla me qasje transversale që përkrah forcimin e rolit të arsimit në drejtim të pengimit të formave specifike të dhunës, siç është maltretimi në shkolla, maltretimi homofobik, dhuna kibernetike dhe dhuna në lidhje me radikalizimin.

Këshilli i Evropës përkrah aktivitetet për ngritjen e vetëdijes dhe fushatat për shoqëri demokratike dhe edukim për të drejtat e njeriut të bazuara në materialet edukative, siç është video klipi "Rrahe maltretimin" („Beat Bullying") dhe publikimin "Të drejtat e njeriut dhe demokracia fillojnë me ne: Deklarata për të gjithë" ("Human Rights and Democracy Start with Us: Charter for All").


12 Council of Europe Strategy for the Rights of the Child (2016-2021), <https://rm.coe.int/168066cff8>

## 2.4.2. Komiteti i Këshillit të Evropës për Krim Kompjuterik

Komiteti<sup>13</sup> ka përpiluar studim për Mapimin e dhunës kibernetike që është miratuar në korrik të vitit 2018. Dhuna kibernetike përkufizohet si përdorim i sistemeve kompjuterike për shkaktimin, lehtësimin ose kërcënimin me dhunë ndaj njerëzve që rezulton ose mund të rezultojë me dëmtime ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike dhe mund të përfshijë edhe eksploatimin e rrethanave, karakteristikave ose dobësive të personave.

Ky studim ka për qëllim, mes të tjerash sigurimin e shembujve nga përvojat dhe përgjigjet – politikat, strategjitë, legjislatoren, rastet dhe praktikat gjyqësore në aspekt të akteve që paraqesin shembuj për dhunë nëpërmjet Internetit, por edhe diskutimit të përgjigjeve ndërkombëtare në pajtim me Konventën e Budapestit, Konventës së Stambollit dhe Konventës nga Lanzaroti.

Duhet të sigurohet sinergji ndërmjet Konventave nga Budapesti, Stambolli dhe Lanzaroti me qëllim të ngritjes së vetëdijes për dispozitat e këtyre konventave, shfrytëzimit të tyre për ndërtimin e kapaciteteve dhe këshillave për vendet, inkorporimin e autorizimeve procedurale dhe mjeteve për bashkëpunim ndërkombëtar nga Konventa e Budapestit, dhunës seksuale nëpërmjet Internetit dhe dhunës psikologjike, keqpërdorimit dhe shqetësimit seksual në kontekst të internetit dhe adresimit të eksploatimit seksual dhe keqpërdorimit seksual të fëmijëve nëpërmjet internetit në kontekst të Konventave të Stambollit dhe Lanzarotit.



Nga rekomandimet që i ka miratuar Këshilli i Evropës në raport me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në internet, vëmendje meriton edhe **Rekomandimi i vitit 2018 i cili i përmban Udhëzimet për respektimin, mbrojtjen dhe plotësimin e të drejtave të fëmijëve në fushën digjitale**<sup>14</sup>. Sipas udhëzimeve, teknologjitë informatike dhe komunikuese (TIK) janë mjet i rëndësishëm në jetën e fëmijëve për edukim, socializim, shprehje dhe inkluzion, përderisa njëkohësisht përdorimi i tyre mund të krijojë rreziqe, përfshirë dhunën, eksploatimin dhe keqpërdorimin.

Në kuadër të masave për mbrojtje dhe ngritjen e vetëdijes janë paraparë:

<sup>13</sup> Cybercrime Convention Committee of the Council of Europe (T-CY).

<sup>14</sup> Recommendation CM/Rec(2018)7 of the Committee of Ministers to member States on Guidelines to respect, protect and fulfil the rights of the child in the digital environment, [https://violenceagainstchildren.un.org/sites/violenceagainstchildren.un.org/files/documents/political\\_declarations/recomendation\\_of\\_the\\_committee\\_of\\_ministers\\_of\\_the\\_council\\_of\\_europe\\_to\\_member\\_states\\_on\\_guidelines\\_to\\_respect\\_protect\\_and\\_fulfil\\_the\\_rights\\_of\\_the\\_child\\_in\\_the\\_digital\\_environment.pdf](https://violenceagainstchildren.un.org/sites/violenceagainstchildren.un.org/files/documents/political_declarations/recomendation_of_the_committee_of_ministers_of_the_council_of_europe_to_member_states_on_guidelines_to_respect_protect_and_fulfil_the_rights_of_the_child_in_the_digital_environment.pdf)

- masat dhe politikat specifike për mbrojtjen e fëmijëve nga ekspozimi i parakohshëm në ambientet digjitale,
- mbrojtja e fëmijëve nga eksploatimi komercial në ambiente digjitale,
- inkurajimi i shteteve që të bashkëpunojnë me mediumet, duke respektuar lirinë e medimeve, me institucionet arsimore dhe faktorë të tjerë relevantë, me ç'rast do të zhvillohen programe për ngritjen e vetëdijes, të orientuara drejt mbrojtjes së fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme si dhe të pengohet përfshirja e tyre në aktivitete ilegale në internet,
- zhvillimi dhe implementimi i politikave që kanë të bëjnë me sulmet kompjuterike, shqetësimin dhe nxitjen e urrejtjes dhe dhunës nga ambienti digjital,
- zhvillimi dhe forcimi i iniciativave dhe programeve për nxitjen e vetëdijes që do t'u mundësojë fëmijëve të kuptojnë dhe të ballafaqohen me:
  - ◊ përmbajtje potencialisht e dëmshme (siç është dhuna dhe vetëlëndimi, pornografia e të rriturve, materiale për keqpërdorim seksual të fëmijëve, diskriminimi dhe racizmi, gjuha e urrejtjes).
  - ◊ sjellja potencialisht e dëmshme (siç është vërbimi i fëmijëve për qëllime seksuale ose grooming, maltretimi ose shqetësimi, përpunimi joligjor i të dhënave personale, shkelja e të drejtave të pronësisë intelektuale), dhe
  - ◊ pasojat potenciale nga mënyra se si mund të shpërndahen informatat për fëmijët ose informatat e dhëna nga ta.

### 2.4.3. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Internet

Në pajtim me qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat E Njeriut, për shtetet – palë nënshkruese të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, dalin edhe obligimet pozitive për të krijuar bazën në legjislaturën vendase që do të mundësonte realizimin ligjor të të drejtave dhe lirive themelore të mbrojtura me Konventë. Kjo mes të tjerash, nënkupton edhe sensibilizim për mbrojtje efektive të personave të prekur dhe pengimit të dhunës nëpërmjet internetit.<sup>15</sup>

Në kontekstin konkret të mbrojtjes së fëmijëve në botën digjitale, obligimet pozitive përfshijnë mes të tjerash edhe miratimin e masave nga ana e shtetit që ka për qëllim të sigurojë respektimin e, para se gjithash, të drejtës për jetë private (neni 8 i Konventës Evropiane) edhe atë jo vetëm në organe shtetërore ndaj individëve, por edhe në sferën e marrëdhënieve të individëve ndërmjet vete, për shembull, një shfrytëzues i internetit dhe ata që sigurojnë qasje deri te një uebfaqe e caktuar. Qëllimi është pengimi efikas i veprave të rënda të keqpërdorimit të të dhënave personale, me fokus të veçantë te fëmijët, të dhënat e të cilëve mund të keqpërdoren në hapësirën dhe komunikimin digjital për çka duhet që në nivel nacional të ekzistojnë dispozita dhe mekanizma adekuate penale.

15 Internet: Case-law of the European Court of Human Rights, [https://echr.coe.int/Documents/Research\\_report\\_internet\\_ENG.pdf](https://echr.coe.int/Documents/Research_report_internet_ENG.pdf)

### Pedofilia në internet

(K.U. v. Finland, no. 2872/02, 2 December 2008)

Një djalë dymbëdhjetë vjeçar ka qenë viktimë e një personi të panjohur i cili ka vendosur reklamë seksuale për të, në internet faqe. Babai i tij nuk ka mundur të iniciojë procedurë kundër dikujt, sepse legjislatura e Finlandës në atë kohë nuk ka lejuar që policia dhe gjykatat të kërkojnë nga ofruesit e shërbimeve të internetit të identifikojnë personin që ka publikuar shpalljen.

Gjykata Evropiane ka konstatuar se shteti nuk e ka plotësuar obligimin e vet pozitiv për të mbrojtur të drejtën e jetës private, integritetin fizik dhe mental të fëmijës.

Obligimi pozitiv i shtetit për të ofruar mbrojtje të fëmijëve dhe kategorive të cenueshme, ekziston edhe në kontekst të të drejtave të tjera të mbrojtura me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut, me ç'rast këtu duhet të theksohet e drejta e jetës (neni 2) dhe ndalesa për torturë ose veprime jonjerëzore (neni 3). Obligimi pozitiv me këto nene do të aktivizohej në veçanti nëse dhuna nga hapësira digjitale do të bartej edhe në jetën reale dhe e njëjta të rezultonte me ndonjë lëndim fizik ose trauma më të thella për viktimën.

Si palë nënshkruese e Konventës Evropiane, Republika e Maqedonisë së Veriut ka obligim të zbatojë aktvendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane por edhe të përcjellë dhe zbatojë praktikën e tyre, në mënyrë që të mundësohet realizimi efektiv i të drejtave, por edhe të parandalohet shkelja eventuale e Konventës me përgjegjësi për shtetin.

## 2.5. BE

### 2.5.1. EU Kids "online" 2020

Ky Raport<sup>16</sup> e përcakton qasjen në internet, praktikat nga interneti, aftësia, rreziqet nëpërmjet Internetit dhe mundësitë për fëmijët e moshës 9-16 vjeçare në Evropë. Ekipet e rrjetit të fëmijëve të BE-së "EU Kids", kanë bashkëpunuar në vjeshtë, gjatë vitit 2017 dhe verën, vitit 2019 për të zbatuar një hulumtim të madh që ka përfshirë 25.101 fëmijë në 19 vende evropiane: Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Rusia, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar.

Pjesa më e madhe e fëmijëve në shtetet e theksuara potencojnë se i shfrytëzojnë telefonët e tyre të mençur "çdo ditë" ose "pothuaj se tërë kohën". Për këtë vërehet një rritje e konsiderueshme e përqindjes së fëmijëve që shfrytëzojnë telefona të mençur, si dhe koha e kaluar duke përdorur internetin, në krahasim me hulumtimin që në aspekt të të njëjtëve indikatorë dhe kriterë është zbatuar në vitin 2010.

Në këtë hulumtim veçanërisht i kushtohet vëmendje faktit se, edhe pse koha që fëmijët e kalojnë përditë në internet është zmadhuar gati dyfish në disa vende, krahasuar me vitin 2010, shumë prej fëmijëve ende nuk kanë marrë këshilla adekuate për vetëmbrojtje dhe për shfrytëzim të sigurt të internetit nga ana e prindërve, mësimeve dhe miqve. Mirëpo, kur fëmijët kanë përvoja negative në internet, ata në masë të madhe këto përvoja, frikë, dilema, vështirësi ose pasoja i ndajnë me prindërit ose miqtë, ndërsa të rralla janë rastet

16 Smahel, D., Machackova, H., Mascheroni, G., Dedkova, L., Staksrud, E., Ólafsson, K., Livingstone, S., and Hasebrink, U. (2020). EU Kids Online 2020: Survey results from 19 countries. EU Kids Online. Doi: 10.21953/lse.47fdeqj01ofo, <https://www.lse.ac.uk/media-and-communications/assets/documents/research/eu-kids-online/reports/EU-Kids-Online-2020-10Feb2020.pdf>.

kur për këtë flasin me mësimdhënësit e tyre ose shërbimet shkollore ose në përgjithësi me persona që e kanë detyrë profesionale dhe punë t'i ndihmojnë fëmijët.

Në shumicën e vendeve, më pak se 10% e fëmijëve kanë paraqitur se janë viktimë e internetit që ndodh çdo muaj, ndërsa më pak se 5% kanë pranuar se ata në fakt janë në rolin e dikujt që maltreton të tjerët nëpërmjet internetit.

Prej atyre që kanë qenë viktimë e sjelljes së tillë në internet, një e pesta nuk kanë paraqitur kurrfarë dëmi, kurse një e pesta tjetër e ka bërë atë.

Në anketë janë intervistuar vetëm fëmijë më të moshuar (prej 12 deri më 16 vjeç) për ekspozim në sërë përmbajtje të dëmshme potenciale. Shumica e fëmijëve të moshës 12-16 vjeçare në shumicën e vendeve nuk kanë pasur lëndime fizike.

Në shumicën e shteteve, nga përmbajtjet më të shpeshta potenciale të dëmshme, fëmijët janë ekspozuar ndaj porosive (gjuhës) së urrejtjes – prej 4% (Gjermani) deri më 48% (Poloni).

## 2.6. EUROPOLI

Edhe EUROPOL-i<sup>17</sup> ka konstatuar se ndikimi global i COVID-19 nënkupton se njerëzit kalojnë më shumë kohë në internet. Kjo ka të bëjë edhe me fëmijët edhe të moshuarit.

Puna nga shtëpia për prindërit ndikon në mos gjetjen e kohës për të kontrolluar fëmijët, të cilët njëkohësisht janë vazhdimisht në internet. Në kushte të këtilla, fëmijët kanë qasje më të madhe, që ju lejohet në internet pa mbikëqyrje.

Gjendja e këtillë rezulton me këto rreziqe:

- fëmijët janë më shumë të ekspozuar ndaj pedofilëve nëpërmjet lojërave "online", përdorimit të grupeve të bisedave në aplikacione të ndryshme "online", tentime për të vendosur kontakte dhe marrëdhënie të besimit nëpërmjet e-postës, kontakte të padëshiruara në rrjetet sociale dhe nëpërmjet aplikacioneve më pak të sigurta për edukim nëpërmjet internetit;
- ekzistojnë rreziqe të zmadhuara për fëmijët, të marrin pjesë në përpilimin/incizimin e materialeve eksplicite për shkëmbim me moshatarët, me çka ata janë të ekspozuar ndaj rrezikut për të qenë viktimë të predatorëve seksual në internet;
- në disa raste, për shkak të vetmisë dhe izolimit, respektivisht kontakteve të kufizuara, fëmijët mund të bëhen viktimë të predatorëve të cilët do të tentojnë të realizojnë ndonjë dobi në kuptim të lidhjes më fëmijët në mënyrë që të vijnë deri te fotografitë ose incizimet e tyre, ose materiale të tjera eksplicite, si dhe vendosjen e komunikimit "online" duke krijuar kushte për keqpërdorim të mëtejshëm seksual (grooming).

17 <https://www.europol.europa.eu/covid-19/covid-19-child-sexual-exploitation>

## 2.7. KOVID-19 te fëmijët dhe roli i shkollës në transmetimin e virusit

Në Raportin për KOVID-19 edhe rolin e sistemit shkollor në transmetimin e virusit<sup>18</sup>, mes të tjerash, BE-ja konstaton se fëmijët me nevoja të veçanta mund të jenë më të prekur, sepse mund të ndihen më të izoluar kur shkollat dhe shërbimet speciale janë të mbyllura, ndërsa kanë mundësi të kufizuara për komunikim digjital.

Krahas kësaj, sa më shumë kohë që kalohet në internet, rritet edhe rreziku për maltretime kompjuterike.

Në pajtim me këtë, fëmijët janë të ekspozuar në rrezik më të madh të dhunës familjare gjatë kohës së mbylljes së shkollave, sepse shkolla atëherë nuk mund të zbulojë dhe paraqesë keqpërdorimin e fëmijëve, si dhe të shfrytëzojë shërbimet e rrjetit të jashtëm social dhe përkrahjes për ballafaqimin me keqpërdorime që ndodhin në kushte shtëpiake.

BE-ja me të drejtë potencon se keqpërdorimi i fëmijëve dhe neglizhimi i tyre kanë efekte afatgjate, përfshirë edhe dëmtime të shëndetit mendor, infeksione seksuale të transmetueshme, shtatzani të padëshiruara dhe përdorim të substancave të palejuara.

## 2.8. Legjislatura vendase

### 2.8.1. Kodi penal

Kodi Penal i RMV-së<sup>19</sup> përkufizon nocionet që janë të rëndësishme për këtë Doracak:

- dhuna në familje – maltretimi, ofendimi i ashpër, cenimi i sigurisë, lëndimit trupor, dhunës gjinore ose psikike-fizike me të cilën shkaktohet ndjenja e pasigurisë, cenimit ose frikës, ndaj bashkëshortit, prindërve ose fëmijëve dhe personave të tjerë që jetojnë në bashkësi martesore ose jashtëmartesore ose amvisëri të përbashkët, si dhe ndaj një ish-bashkëshorti ose personave që kanë fëmijë të përbashkët ose që janë në marrëdhënie të afërta personale (neni 122, paragrafi 21);
- pornografia e fëmijëve nënkupton materiale pornografike që në mënyrë vizuale prezanton veprime të dukshme gjinore me një të mitur ose person më të moshuar që duket si i mitur, ose që e prezantojnë të miturin ose personin më të moshuar që duket si i mitur, në një pozitë të qartë seksuale, ose fotografi reale që prezantojnë veprime të qarta gjinore me një të mitur ose që e prezantojnë të miturin ose të moshuarin që duket si i mitur në një pozitë të dukshme seksuale (neni 122, paragrafi 24);
- dhuna ndaj fëmijës krahas dhunës në familje, e përfshin edhe dhunën psikike, dhunën nëpërmjet internetit, dhunën e moshatarëve, si dhe përndjekjen dhe përcjelljen e fëmijës (neni 122, paragrafi 41).

Në kuadër të veprave të veçanta penale që e mbrojnë fëmijën nga veprimet e palejuara në lidhje me shfrytëzimin e internetit, në KP janë përcaktuar si vijon:

- Prezantimi i materialit pornografik ndaj një fëmije (neni 193) – ai i cili do t'i shesë, prezantojë ose në ndonjë mënyrë tjetër publike do t'i japë në dispozicion fotografi dhe mjete të tjera audiovizuale me përmbajtje pornografike ose do t'i tregojë përmbajtje pornografike një fëmije që nuk ka mbushur 14 vjet; më ashpër dënohet nëse vepra është kryer nëpërmjet mjeteve të informimit publik dhe nëse keqpërdoret fëmija që ka mbushur 14 vjeç (ndërsa edhe më ashpër nëse nuk ka mbushur 14 vjeç) për përpilimin e fotografive audiovizuale ose lëndë të tjera me përmbajtje pornografike ose prezantime pornografike, sikur edhe ai që merr pjesë në shfaqje. Sanksione të ashpra ligjvënësi ka paraparë për personat që do të detyrojnë fëmijë që nuk ka mbushur 14 vjeç (më të ashprat nëse fëmija nuk ka

18 COVID-19 in children and the role of school settings in COVID-19 transmission, <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/COVID-19-schools-transmission-August%202020.pdf>

19 Gazetë Zyrtare e RMV-së, nr. 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 41/2014, 115/2014, 132/2014, 160/2014, 199/2014, 196/2015, 226/2015, 97/2017 dhe 248/2018.

mbushur 14 vjeç) për përpilim dhe incizim të fotografi dhe mjete të tjera me përmbajtje pornografike ose shfaqje pornografike;

- Produksioni dhe shpërndarja e pornografisë me fëmijë (neni 193-a) – denohet ai që prodhon pornografi të fëmijëve me qëllim të distribuimit të saj ose e transferon ose e ofron në mënyrë që të kenë qasje ata që blejnë pornografi të fëmijëve për vete ose për të tjerë ose që posedojnë pornografi të fëmijëve, veçanërisht denohet nëse vepra është kryer nëpërmjet sistemeve kompjuterike ose mjeteve të tjera për komunikim masiv;
- Mashtrim për marrëdhënie ose veprime seksuale me fëmijë që nuk ka mbushur 14 vjeç (neni 193-b) - e sanksionon sjelljen e njohur si grooming, respektivisht kur një person cakton takim nëpërmjet mjeteve kompjuterike-komunikuese me një fëmijë që nuk ka mbushur 14 vjeç, me qëllim të marrëdhënies ose veprime të tjera gjinore ose të produksionit të pornografisë së fëmijëve nëse me atë qëllim ka realizuar takim direkt me fëmijën;
- Dhuna ndaj fëmijës (neni 201-a) – nga një person që kryen dhunë fizike, psikike ose formë tjetër të dhunës ndaj një fëmije.

## 2.8.2. Ligji për arsim fillor

Në Ligjin për arsim fillor<sup>20</sup> është paraparë se një prej qëllimeve të arsimit fillor është edhe arritja e standardeve nacionale për nxënësit, mes të tjerash edhe në sferën e arsimit digjital. Në ligj më tutje, ekzistojnë edhe disa dispozita që kanë të bëjnë me promovimin, reagimin dhe sjelljen jo të dhunshme, respektivisht obligimin për kallëzimin e rasteve të dhunës keqpërdorimit dhe veprimeve të ngjashme të palejueshme ndaj nxënësit.

Njëkohësisht, të punësuarit në shkolla filllore janë të obliguar të promovojnë barazi dhe drejtësi ndërmjet nxënësve dhe në mënyrë aktive t'u kundërvihen të gjitha formave të diskriminimit dhe dhunës.

Në aspekt të parandalimit të dhunës ndaj nxënësve (neni 66), drejtori i shkollës është i obliguar të paraqesë deri te organet kompetente të përcaktuara me ligj, të çdo forme të dhunës, keqpërdorimit dhe neglizhimit ndaj një nxënësi nga një nxënës tjetër, prind, respektivisht kujdestar, mësimdhënës, punëtor profesional ose cilido person tjetër i punësuar në shkollë. Në të kundërtën, është përcaktuar gjobë në shumë prej 401 deri në 500 euro në kundërvlerë të denarit për këtë shkelje të drejtorit të shkollës fillore. Në të njëjtën kohë, është përcaktuar edhe obligimi për përfshirjen e prindërve nëpërmjet formës së këshillimit (neni 76), kurse prindi, respektivisht kujdestari dërgohet për këshillim nëse, mes të tjerash, nxënësi merr pjesë në forma të ndryshme të dhunës, nëse nxënësi shpreh sjellje antisociale (devijuese) dhe asocial, përdor gjuhë të urrejtjes etj.

## 2.8.3. Ligji për arsim të mesëm

Në Ligjin për arsim të mesëm,<sup>21</sup> dukuria e dhunës aspak nuk është përpunuar që udhëzon për nevojën e ndryshimit dhe plotësimit të tij sa më të shpejtë në këtë drejtim, sipas shembullit të Ligjit për arsimin fillor të vitit 2019. Në Ligjin për arsimin e mesëm ekziston mundësia për thirrjen e prindërve për këshillim nëse, mes të tjerash, nxënësi merr pjesë në rrahje dhe të tjera të dhunës.

Dënimi trupor dhe maltretimi psikik i nxënësit është i ndaluar (neni 51), ndërsa nëse ndodh që një nxënës të dënohet fizikisht ose maltretohet psikikisht, është përcaktuar një kundërvajtje për shkollën e mesme e dënueshme me gjobë në shumë prej 1.600 euro në kundërvlerë të denarit.

Ligji nuk përmban kurrfarë obligimi që drejtori të paraqesë dhunën, keqpërdorimin ose neglizhimin e nxënësit, siç është kjo e përcaktuar në Ligjin për arsimin fillor. Prapëseprapë duke vepruar në interes më të

20 Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 161/2019

21 Gazetë Zyrtare e RMV-së, nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/2018

mirë për fëmijën, drejtori dhe të punësuarit e tjerë në shkollat e mesme janë të obliguar që të paraqesin rastet e dhunës që ndodhin në shkollën e tyre.

#### 2.8.4. Ligji për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje

Ligji për parandalimin, pengimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje<sup>22</sup>, përmban përkufizim në aspekt të dhunës në familje, sipas të cilit ajo nënkupton maltretim, ofendim, cenim të sigurisë, lëndim trupor, dhunë gjinore ose dhunë tjetër psikologjike, fizike ose ekonomike me të cilën shkaktohet ndjenja e pasigurisë, cenimit ose frikës, përfshirë edhe kërcënimet për veprimet e tilla ndaj bashkëshortit/es, prindërve ose fëmijëve, ose edhe personave të tjerë që jetojnë në bashkësi martesore ose jashtëmartesore ose në amvisëri të përbashkët, si dhe ndaj një bashkëshorti/te të mëparshme, partneri jashtëmartesor ose persona që kanë fëmijë të përbashkët ose që kanë marrëdhënie të afërta personale, pa marrë parasysh nëse kryerësi ndan apo ka ndarë apo jo të njëjtin vendbanim me viktimën.

Si forma të dhunës janë paraparë, si vijon:

- dhunë trupore/fizike është çdo veprim ku zbatohet forcë fizike ose veprim me të cilin cenohet shëndeti i viktimës;
- dhunë psikike, është çdo veprim i cili shkakton ndjenjë të frikës, rrezikut, shqetësimit ose cenimit të dinjitetit dhe integritetit të viktimës;
- ndjekje, është përsëritja e qëllimshme e kërcënimit ndaj viktimës, që shkakton frikë për sigurinë e vetë tek e njëjta;
- dhunë seksuale, është çdo veprim i aktit seksual dhe shqetësimit seksual ndaj një personi pa pëlqimin e tij;
- dhunë ekonomike, është çdo veprim i kufizimit ose pengimit për të disponuar me të ardhura personale dhe mjete financiare, për të ruajtur ekonominë e përbashkët familjare dhe kujdesje të fëmijës, me çka shkaktohet varshmëri ekonomike mbi viktimën;
- dhunë mbi baza gjinore ndaj grave paraqet dhunën drejtuar gruas nga se është grua ose pse e lëndon për nga pabarazia.

**Pjesa III**  
MEDIAT SOCIALE DHE FORMAT  
E KOMUNIKIMIT NË INTERNET



## Test për mësime të vlerave

Kontrolloni!

Çfarë qëndrime dhe vlera keni për sigurinë në internet brenda kolektivit!

Bëni këtë test së bashku me kolegët Tuaj.

✓ hapi i parë: secili le të shkruajë shkruajë për veten e tij **3 vlera** (bindje që konsideron se janë më të dëshiruara, më të dobishme dhe pozitive) të cilat nevojiten të zbatohen për shfrytëzimin e sigurt të internetit, të nxënësve në shkollë, p.sh.: sigurisë, pranimi të dallimeve, mbrojtjes, barazisë, altruizmit...

**Shkëmbeni** këto vlera dhe bisedoni me kolegët, se çfarë është e ngjashme e çfarë ju dallon. Jepni argumente dhe luftoni për vlerat e juaja. Bëni një listë me disa vlera kyçe për të cilat jeni të gjithë të pajtimit. Vlerat e caktuara nevojiten që të jenë produkt i vendimit të përbashkët.

✓ hapi i dytë: secilën vlerë shndërrone në **rregull të sjelljes** në botën digjitale që do ta mbrojë dhe ruajë vlerën. Lidhja ndërmjet vlerës dhe rregullës duhet të jetë e qartë dhe rregulla e sjelljes të çojë drejt miratimit të vlerës së dëshiruar

✓ hapi tretë: Pastaj shënoni **pasojat e mundshme** nga mosrespektimi i rregullave të caktuara. Qëllimi i pasojës nuk është që dikush të ndjehet keq, i përjashtuar dhe i nënçmuar, por që të korrigjohet sjellja e paparanueshme dhe përsëri të krijohet vlera e cenuar.

Vlera	Rregulla	Pasoja

**Është me rëndësi që kolegët tuaj, mësime të vlerave dhe shërbimi profesional të kenë konceptin e njëjtë të vlerave, rregullave dhe pasojave për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna digjitale dhe ky të jetë qëndrim kolektiv.**

Këtë test **mund ta realizoni me nxënës** me qëllim që të krijohen rregulla të propozuara nga ana e tyre, me pjesëmarrje direkte, sepse të njëjtat ëmë lehtë do të zbatohen. Për shembull:

Vlera	Rregulla	Pasoja
✓ "Surfimi" i sigurt në internet	<p>✓ Në internet nuk kontaktojmë me persona që nuk i njohim në jetën reale</p> <p>✓ Në FB nuk shkruajmë porosi me përmbajtje ofenduese</p>	<p>✓ Në FB të shkruhen porosi pozitive pr ndonjë nxënës që është etiketuar dhe merr porosi ofenduese</p> <p>✓ Të shkëmbehen porosi dhe vlera pozitive me të tjerët</p>

## 3.1. Hyrje

Mediat sociale janë të rrezikshme madje edhe nëse tinxherët i shfrytëzojnë me përgjegjësi.

Rreziqet rriten për shkak të mundësive të pakufizuara për komunikim nëpërmjet internetit, për shkak të shpejtësisë së komunikimit dhe për shkak të qasjes së madhe dhe të lehtë.

Gjendja me KOVID-19, kur i tërë aktiviteti realizohet nëpërmjet internetit, dukshëm e rrit edhe numrin e shfrytëzuesve por edhe rreziqet.

Nga rastet e zbuluara të dhunës në internet, sipas platformave sociale gjendja është si vijon:

- Instagram-i është përdorur në 1/3 e rasteve
- Fejsbuk-u është përdorur në 23% të rasteve dhe
- Snapçat në 14% të rasteve.

Brengos fakti që numri i rasteve ndaj të cilëve ka vepruar policia është rritur për 200% gjatë një viti<sup>23</sup>.

## 3.2. Raporti i shprehive të fëmijëve në internet

Në Raportin për shprehitë digjitale të fëmijëve<sup>24</sup>, nisur nga karakteristikat më të rëndësishme të katër kategorive të aplikacioneve – “online” video, media sociale, video lojra dhe arsimim, del se fëmijët kanë këto shprehje gjatë përdorimit të internetit:

- YouTube është ende mbret i videove “online” për fëmijët e moshës 4 deri në 15 vjeç, edhe përkundër faktit që është për moshën 13+, por pyetja është se edhe sa kohë do të ketë prioritet sepse TikTok dhe Netflix janë në rritje e sipër;
- Fëmijët tani kalojnë 85 minuta të pabesueshëm në ditë në YouTube, ndërsa në SHBA mesatarja është 100 minuta në ditë;
- Tiktok po i mund rrjetet sociale që sjell deri te rritja e përdorimit të aplikacioneve sociale për 100% në vitin 2019 dhe 200% në vitin 2020, kurse mesatarisht, tani fëmijët kalojnë nga 80 minuta në ditë në Tiktok;
- Mediumet sociale ndërpriten vetëm kur fëmijët flenë, duke e marrë kohën që duhet të kalojë në shkollë;
- Roblox është loja më e popullarizuar në SHBA dhe Britaninë e Madhe gjatë vitit 2019 dhe 2020, që luhet shumë më tepër se Fortnite, ndërsa mesatarisht luhet rreth 20 minuta më tepër se sa aplikacionet e tjera të video lojrave;
- Fëmijët kalojnë rreth 1 orë në ditë duke lozur video lojra, që ka qenë stabile në vitin 2019, por që është ashpërsuar gjatë Kovid-19;
- Luajtja e video lojrave e ka marrë kohën që duhet të kalohet në shkollë;

Aplikacionet për arsim tani janë të zbatueshme edhe për tek ne, sidomos Google Classroom, që e shfrytëzojnë 65% e fëmijëve, p.sh, në Spanjë.

23 <https://edition.cnn.com/2019/03/01/uk/nspcc-grooming-social-media-report-scli-gbr-intl/index.html>

24 <https://www.qustodio.com>

## Test për mësimdhënësit

Kontrolloni

Shkurani asociacione për “rrjete sociale”, e pastaj tentoni që të përkufizoni rrjetet sociale. Shkruani listë, cilat rrjete sociale i njihni. Kontrollni njohurinë tuaj në tekstin si vijon.

### 3.2.1. Si funksionon Interneti?

Interneti është një sistem i qasshëm publik, rrjet botëror i komunikimit që transmeton porosi, biblioteka më e madhe, qendra informative dhe vend për takime sociale në botë. Për të shfrytëzuar internetin, nevojitet që të kemi shërbim të internetit, nëpërmjet një ofruesi të shërbimeve të internetit ose kjo të mundësohet nëpërmjet një kompanie të telefonave celular. Lidhja në internet nënkupton qasje deri te shfletuesit e ndryshëm nëpërmjet të cilëve mund të hulumtohet.

Sot, dhuna digjitale më së shpeshti bëhet në formë të rrjeteve dhe platformave sociale për shpërndarjen e përmbajtjeve të videos si: Facebook, Google, My Space, Twitter, Ask.fm, Omegle, YouTube, Instagram, Flickr, Snapchat ose ëpërmes SMS porosive dhe thirrjeve telefonike, e-mailit nëpërmjet IMs- instant messages, WhatsApp, Skype, Viber, bllogjeve, forumeve, çat dhomave, “online” video lojrave.

Numri më i madh i “online” shërbimeve kanë një kufi të mjaftueshëm të moshës për shfrytëzimin e shërbimeve, e që më së shpeshti është mosha 13 vjevare (p.sh. Facebook, Ask.fm, Instagram, Twitter Snapchat, Viber, Skype etj.), kurse për disa është 16 vjet si p.sh.: WhatsApp. Por të rinjtë shpesh i keqpërdorin mjetet digjitale me vet faktin se prezantojnë të dhëna të rrejshme dhe i shfrytëzojnë në moshë më të re se ajo që është përcaktuar.

### 3.2.2. Konceptet e reja të internetit

**Shtetësi digjitale (Digital citizenship)** ndihmën e të rinjve që të praktikojnë sjellje respektuese dhe toleruese ndaj të tjerëve nëpërmjet internetit.

**Shtetësi qytetare plus** është e përkufizuar si “aftësi e nevojshme e të rinjve me qëllim të pjesëmarrjes së tyre të plotë në sferën akademike, sociale, etike, politike dhe ekonomike në botën tonë me zhvillim të shpejtë digjital.”

800 milion fëmijë i shfrytëzojnë mediat sociale.  
Çdo fëmijë mund të bëhet viktimë e dhunës “online”.

### 3.2.3. Çfarë është çat/chat?

Forma e komunikimit ndërmjet dy ose me tepër shfrytëzuesve nëpërmjet kompjuterit ose telefonit celular në kohë reale quhet çat (Chat). Nëpërmjet çatit dërgohen porosi të shkurta të cilat shfrytëzuesi i sheh menjëherë kur bashkëbiseduesi ja dërgon. Ekzistojnë edhe të a.sh çet dhoma të cilat janë shumë të famshme në mesin e fëmijëve dhe të rinjve në të cilat ata bisedojnë dhe njoftohen me shfrytëzues nga e tërë bota. Dhomat mund të kenë dhjetra, madje edhe qindra shfrytëzues të komunikimit, por mund të ndahen dhe të

komunikohet edhe në mënyrë private. Aplikacionet më të popullarizuara për çat siç janë Viber, Facebook, WhatsApp, Instagram kanë vendosur një sistem komunikues i cili siguron privatësi për shfrytëzuesin, por tregu i programeve për shkëmbimin e informatave gjithmonë ofron produkte të tjera.

### 3.2.4. Çfarë është forumi?

Në forum mblidhen shfrytëzuesit e internetit për të dhënë mendimin e tyre për një temë të caktuar ose për të kërkuar këshillë ose mendim nga të tjerët. Janë shumë të popullarizuara, forumet ku mblidhen shfrytëzues të moshave të ndryshme dhe interesime për politikë, sport, muzikë, shkollë. Mund të komentohet ndonjë muzikë, film, shërbim i caktuar. Shkrimet nëpër forume janë të përhershme dhe komentet nëpër to mund të lexohen edhe pas një kohe të gjatë.

### 3.2.5. Çfarë është blogu?

Faqe e internetit në të cilën shfrytëzuesi, zakonisht në formë kronologjike i shënon mendimet dhe qëndrime e veta sikur në ditar. Me ndihmën e blogut, shfrytëzuesi mund thjesht dhe lehtë të shkruajë një kolumnë personale, të publikojë poezi, ese, fotografi, të komentojë për tema aktuale, të njoftojë për ngjarje të caktuara. Blogu është interaktiv dhe mund të shkruhen komente publike ose të zhvillohet një komunikim ndërmjet autorit dhe lexuesve. Blogu mund të shfrytëzohet për argëtim, por edhe për lidhjen e njerëzve me komunitetin e biznesit, si dhe për punë ekipore, për zhvillimin e shkathtësive sociale, përmbushjen e nevojës për t'u shprehur dhe për përmirësimin e shkathtësive në të shkruar.

### 3.2.6. Çfarë është telefoni celular?

Telefoni i "mençur" ka zbatim të gjerë, që është në dispozicion të përditshëm për ta shfrytëzuar fëmijët nga moshë parashkollore e deri te personat në moshë të thyer. Përparësitë janë të mëdha, por edhe rreziqet si një mënyrë shumë më e popullarizuar për dhunë, veçanërisht në mesin e fëmijëve.

Dhuna nëpërmjet telefonit celular përfshin çfarëdo forme të porosisë, që mund të jetë tekstuale, video porosi, fotografi, thirrje ose kombinim i të gjithave, me qëllim që të shkaktohet dëm, ofendim, kërcënim për shfrytëzuesin e telefonit celular.

### 3.2.7. Rreziqet nga "miqtë me maska"

E përbashkëta për çatin, blogun dhe forumin është që mund të shfrytëzohen nofka dhe të mbeten anonim. Ajo nënkupton se shfrytëzuesit nuk e dinë se kush është personi i vërtetë në realitet, nuk e dinë emrin dhe mbiemrin, vendbanimin, moshën, gjininë... për njëri tjetrin dinë vetëm atë që publikojnë për veten në internet. Anonimiteti lejon që njerëzit të jenë të hapur, të prononcojnë qëndrimet në opinion prej të cilëve mund të ndihet keq nëse do të dihej identiteti i tyre i vërtetë, ku shpesh edhe flasin për fshhehtësitë, problemet, qëllimet e fshehta të cilat ndoshta janë edhe kriminale ose moralisht të paparanueshme. Kjo mënyrë e komunikimit mund të keqpërdoret dhe të shfrytëzohet për ofendime, gjuhë të urrejtjes, kërcënime, shënime me të pavërteta etj.

Jo të gjithë shfrytëzuesit janë qëllimshëm. Ata mund të jenë predatorë, pedofilë, njerëz të shtresave të ndryshme shoqërore që duan të hyjnë në kontakt me fëmijët me qëllim të keqpërdorimit të tyre. Qasja deri te informatat të një numri të madh të njerëzve, përfshirë edhe pedofilët, për të cilët interneti është një vend

i përsosur virtual në të cilin lehtë mund të vijnë deri te fëmijët, e të cilët mendojnë se janë të mbrojtur nga anonimiteti i vendbanimeve të tyre. Pedofilët mund që lehtë të mbledhin informata për një fëmijë nga të dhënat personale, deri te vendbanimi, shkolla, shoqëria e tij, të cilat janë udhëzime për të arritur më lehtë te ai.

Madje edhe një informatë e vogël mund t'ju ndihmojë që të përpilojnë mozaikun dhe lehtë të vijnë te fëmija. Për këtë është me rëndësi që fëmijët dhe të rinjtë nëpër blogjet e tyre ta ruajnë privatësinë dhe të mbrohen. Ka fëmijë që i publikojnë të dhënat e vërteta për veten e tyre së bashku me fotografi, me qëllim që të gjejnë ndonjë shok me të cilin nuk kanë qenë në kontakt një kohë të gjatë dhe pikërisht këto të dhëna keqpërdoren.

Veçanërisht është e rëndësishme që të kenë kujdes edhe me fotografitë që shpeshherë fëmijët i përdorin për të zbukuruar ueb-faqen e tyre, por nëse në to mund të shihet fytyra e fëmijës ose anëtarëve të familjes mund të vihet në rrezik njësoj si ta kishin shkruar emrin dhe mbiemrin e tyre. Nevojitet të kenë kujdes edhe me të dhënat e miqve ose anëtarëve të familjes, që të mos vijë deri te ekspozimi ndaj rrezikut të personalitetit dhe integritetit të tyre. Të gjitha publikimet e fëmijës kanë edhe publik të padëshiruar, e me këtë edhe pasoja të padëshiruara që në disa raste mund të jenë destruktive ose autodestruktive.

Mund të ndodhë "vjedhje" e palejuar e blogut nga të tjerët dhe plotësimin me përmbajtje të palejueshme ose seksuale, duke cenuar në këtë mënyrë digjitetin dhe privatësinë e njerëzve. Te viktimat, e veçanërisht te fëmijët mund të shkaktojë shqetësim dhe stres, ku varësisht nga intensiteti i sulmit kjo mund të marrë dimensionin e keqpërdorimit madje edhe kërcënimit me vdekje.

### 3.2.8. Mënyra e mbrojtjes

Çat dhomat përmbajnë opzione për të bllokuar ose injoruar shfrytëzuesin i cili dërgon porosi kërcënuese ose shqetësuese. Ajo paraqet një mundësi që problem të vihet nën kontroll. Por shpeshherë fëmijët nuk mund të vlerësojnë llojet e kërcënimeve dhe sa është rreziku real, andaj për këtë arsye është me rëndësi që fëmija të informojë të rriturit, respektivisht prindin/kujdestarin, mësimdhënësin ose një person të besuar. I rrituri mund ta kontaktojë administratorin në mënyrë që të pamundësohet komunikimi i rrezikshëm. Fëmijët asnjëherë nuk guxojnë të japin të dhënat e tyre personale.

Në forume më së shpeshti ka administratorë dhe moderatorë të cilët i lexojnë të gjitha temat dhe debatet duke bërë kujdes që të mos paraqiten format të ofendimit, publikimit të të dhënave personale dhe shkelje e të drejtave. Edhe shfrytëzuesi mund ta informojë administratorin për keqpërdorimin e forumit në mënyrë që të fshihet një shkrim ose të ndalohet qasja e ndokujt.

Përdorimi i gjerë i telefonëve celularë ka imponuar rregulla të caktuara të mbrojtjes. Është me rëndësi që numri i telefonit të mos shpërndahet me çdokënd, ndërsa thirrjet nga numrat e panjohur të mos pranohen fare. Për të mbrojtur fëmija, nevojitet që të këshillohet të mos dërgojë fotografi ose video incizime me të tjerët pa lejen e tyre, as porosi me përmbajtje ofenduese. Edhe nëse ndodh një gjë e tillë pa qëllim, gabimisht, është mirë që fëmijët të shprehin këtë problem me ndonjë të rritur për të gjetur një zgjidhje. Nëse ka ndonjë paralajmërim serioz, ofendim, kërcënim, duhet që të ruhen ato porosi me datën dhe kohën e pranimit dhe të njëjtat të paraqiten në polici.

### 3.2.9. Popullariteti i platformave sociale

Në rast kur dikush përdor teknologjinë në mënyrë që shkakton përsëritje të dëmit që i shkaktohet dikujt tjetër, mund të klasifikohet si sulm kompjuterik me elemente të dhunës. 'Cyberbullying' si maltretim nëpërmjet internetit sqarohet edhe si "Përvojë e padëshiruar fëmijërore" (Adverse Childhood Experience ACE) nga ana e Qendrave për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve në vitin 2017<sup>25</sup>.

25 StopBullying.gov. Bullying as an Adverse Childhood Event (ACE), 2017, <https://www.Stopbullying.gov/sites/default/files/2017-10/bullying-as-an-ace-fact-sheet.pdf>. Accessed August 3, 2020.

Sipas disa hulumtimeve, në korrik të vitit 2020 ka pasur përfërsisht 3,6 miliard shfrytëzues të internetit që përdorin rrjetet sociale dhe këta numra pritet që të rriten sepse përdorimi i pajisjeve telefonike dhe rrjeteve sociale mobile gjithnjë e më shumë është në rritje<sup>26</sup>.

### 3.2.10. Diskord/Discord



**DISCORD – CHAT FOR GAMERS** është një aplikacion i dizajnuar që t'u ndihmojë lojtarëve të video lojrave të bisedojnë njëri me tjetrin derisa luajnë video lojën.

Derisa luajnë lojë në pajisjet e tyre, shfrytëzuesit mund të kyçen edhe në Discord dhe të hyjnë në bisedë grupore me një ose më shumë lojtarë të tjerë të video lojrave, në mënyrë që të flasin përderisa luajnë.

Me cilësimet e duhura për privatësinë dhe përcjelljen, është e lehtë që të shfrytësohet Discord-i i sigurt. Sidoqoftë, ekziston gjithmonë një rrezik kur bëhet fjalë për faqe dhe aplikacione me biseda të hapura. Mënyra më e sigurt për të shfrytëzuar Discord-in është që të pranohen miqtë dhe të komunikohen vetëm me persona të njohur.

Cilët janë rreziqet? Funkcionaliteti sjell rreziqe për shfrytëzuesit më të rinj. Pafytyrësia dhe gjuha ofenduese janë standard deri sa luhen lojrat në Discord, shumë lojtarë diskutojnë për lojra "të pjekura" gjatë së cilave mendojnë dhe flasin për seksin, dhunën dhe drogën duke i bërë këto tema edhe pjesë të bisedave.

Discord i inkurajon shfrytëzuesit e informatave për çfarëdo aktivitete ose sjellje që mund të konsiderohen si keqpërdorime, që t'i paraqesin deri te shërbimet duke dërguar raport dhe imazhe nga ekrani. Ata potencojnë se kanë një ekip të ekspertëve që punojnë 24/7 për të shqyrtuar kallëzimet dhe të ndërmarrin aktivitete adekuate.

Kur luajnë video lojra në kompjuter, lojtarët shpeshherë duhet të zgjidhin dy probleme: se si të bisedojnë mes vete dhe si të organizojnë njerëzit për të filluar lojën.

Discord është më i riu në linjën e gjatë të aplikacioneve të dizajndizajnuara për të zgjidhur këtë problem. Discord është i mrekullueshëm për biseda me miqtë e juaj deri sa luani loja, por gjithashtu edhe i dobishëm për krijimin e vendeve ku mund të mblidhen njerëzit, të takohen dhe të gjejnë lojtarë të tjerë për t'u shoqëruar.

Discord është aplikacion falas VoIP (zë nëpërmjet IP) i dizajnuar para se gjithash për lojtarët (gejmerët) dhe shpërndanë një pjesë të madhe të funksionaliteteve në Skype (për të cilin është e njohur se i shfrytëzojnë shumë të rritur). Fillimisht u publikua në opinion se nga 9 maji 2015 e deri më dhjetor 2017 ka pasur 87 milion shfrytëzues. Është e nevojshme që të dihet se disa lojra mundësojnë lidhje ndërmjet gejmerëve nëpërmjet bisedës tekstuale, ndërsa lojrat e tjera sigurojnë vetëm mundësi për bisedë gojore.

Lojrat të tjera mundësojnë bisedë të plotë me video, përderisa te disa në fakt nuk lejohet asnjë nga të lartpërmendurat. Këtu e gjenë zbatimin e vet Discord-i. Ky aplikacion mundëson bisedë në cilën do mënyrë, me të tjerët, gjatë lojës dhe për lojën. Krahas kësaj ajo ka një funksionalitet robus për shkëmbimin e porosive, në mënyrë që të mund të bisedoni me një person tjetër një me një, ose të merrni pjesë në biseda grupore me deri në dhjetë shokë të tjerë.

26 J. Clement, Global social networks ranked by number of users 2020, <https://www.statista.com/statistics/272014/global-social-networks-ranked-by-number-of-users/>

Vetë aplikacioni nuk promovon shqetësim, urrejtje ose përmbajtje të tjera të dëmshme. Sidoqoftë si edhe me çdo aplikacion tjetër – gjithmonë ka një numër të vogël të shfrytëzuesve që kyçen me sjellje armiqësore dhe keqpërdorim të bisedave, përfshirë edhe maltretimet, racizmin dhe shqetësimin.

Në pjesën më të madhe, edhe prindërit dhe fëmijët konsiderojnë se Discord është aplikacion i sigurt nëse shfrytëzohet vetëm me njerëz të cilët i njihni dhe ju besoni.

Nëse lidheni vetëm në server privat dhe bisedoni me miqtë Tuaj, nuk do të ekspozoheni në diçka që nuk e keni dëgjuar ose parë në jetën reale me ata miq. Nëse lidheni në shumë forume publike të platformës, me gjasë do të hasni në disa përmbajtje të dyshimta, ofenduese dhe madje edhe grafike.

### Këshillë nga fëmijë shfrytëzues

E përdor Discordin me Rollboks, u lidha në dhomën publike për bisda me së paku 100 persona në server, ku vërejta shumë sharje, tema joadekuate, pornografi, maltretime, seks dhe shumë gjëra të tjera.

Mos u lidhni në serverë publikë dhe bisedoni vetëm me njerëz që i njihni dhe u besoni.

### 3.2.11. Snapçat/Snapchat



Snapçat (Snapchat) është aplikacion për pajisje mobile me Android dhe iOS. Një prej koncepteve themelore të aplikacionit është se secila fotografi ose videoporosi që dërgohet është e qasshme vetëm për atë të cilit i dërgohet për një kohë të shkurtër, e që më pas zhduket.

Kjo natyrë e përkohëshme e aplikacionit fillimisht ishte e dizajnuar për të nxitur vijimin e natyrshëm të interaksionit. Edhe pse Snapçati fillimisht ishte fokusuar për ndarje private të fotografite nga një person në një tjetër, tani mund të shfrytëzohet për disa çështje të ndryshme, përfshirë edhe krijimin e dukjes personale me përzgjedhjen e mundësive të ndryshme të ngjyrës së flokëve, syve, gjatësisë, veshjes etj., si dhe shpërndarjes së "tregimeve" kronologjike që publikohen për përcjellësit tuaj.

Nëpërmjet Snapçatit, nëse ka të aktivizuar lokacionin, mund që të publikohet lokacioni juaj drejtpërdrejt në një hartë globale. Por, çështja esenciale që duhet të kuptohet për Snapçatin është se bëhet fjalë për komunikim të drejtpërdrejtë nëpërmjet telefonit tuaj celular.

Snapçati e ndryshoi mënyrën se si komunikojmë në internet, sepse mund që t'i dërgoni mikut, një fotografi dhe pasi që ai ta hapë do të zhduket përgjithmonë ose mund të shihet më së shumti dy herë. Fotografia e dërguar mund të ruhet vetëm nëse e fotografon ekranin e telefonit (screenshot). Miqtë dhe përcjellësit tuaj mund të përgjigjen me fotografi të tyre ose me bisedë nëpërmjet videos, që mund ta bartin atë edhe në tregimet e tyre për miqtë dhe përcjellësit.

Snapçati ka kusht për moshën minimale prej 13 vjetëve, ndërsa shfrytëzuesit që hyjnë me një datë të lindjes nën moshën 13 vjeçare, në momentin kur duan që të bëhen shfrytëzues, nuk do t'u lejohet hapja e llogarisë (account).

Hutia kryesore që shkaktohet në Snapçat është që ju lejon shfrytëzuesve që të vendosin një afat kohor në fotografitë dhe videot që i dërgojnë para se të zhduken, duke i "inkurajuar" tinejxherët që më shpesh ta shfrytëzojnë këtë aplikacion për të shpërndarë fotografi ofenduese, turpëruese ose fotografi me përmbajtje seksuale. E gjithë kjo sepse konsiderojnë se nuk ka rrezik që ato të dalin në publik.

Shfrytëzimi i Snapçatit prapë se prapë sjell shumë rreziqe pasi që fotografia mund të ruhet me fotografim të ekranit të telefonit (screenshot) e më pas të dërgohet si fotografi nga ekрани, e jo si porosi e atij që e ka vendosur. Kjo paraqet rrezik për të cilin tinejxherët nuk mendojnë mjaftueshëm duke qenë të ekspozuar në ofendime, kërcënime, dhunë etj.

Instagrami është shumë më i rrezikshëm dhe i cënueshëm se Snapçati sepse punlikimi mund të mbetet përgjithmonë në internet dhe njerëzit të kenë qasje deri te ajo më lehtë se sa në Snapçat.

### 3.2.12. Instagrami/Instagram



Instagrami është platformë tërësishtë vizuale e cila ka për qëllim që t'u mundësojë shfrytëzuesve që të shpërndajnë fotografi ose video me publikun e tyre. Ajo paraqet një aplikacion për ndarjen e fotografive dhe një platformë për rrjetet sociale, e cila ekziston që nga viti 2012. Mundëson rregullimin dhe vendosjen e fotografive dhe videove të shkurta, mund të bëhet sqarim për secilin publikim, si dhe të vendoset lokacioni.

Dallohet nga Fejsbuk-u dhe Tviter-i, ku ka tekst dhe fotografi.

Ka zbatim shumë të madh për faktin që ky aplikacion është kompatibel me lloje të ndryshëm të telefonëve celularë dhe është i adaptuar sipas nevojave të shfrytëzuesve. Potencohet nevoja që të "kapet momenti" që është i rëndësishëm për shfrytëzuesin dhe i njëjti të ndahet me të tjerët. Interesi dhe përdorimi i gjerë është arritur nga frika se nëse nuk bëhet një fotografi që të shpërndahet "do të lëshohet mundësia" (FOMO – fear of missing out).

Çdo publikim nga një shfrytëzues mund të shihet në opinion kur është i shënuar me hashtage ose geo-shenja. Por, profilet mund të bëhen edhe privat, në mënyrë që përcjellësit publikimet të shihen vetëm nga përcjellësit e tyre.

Funksioni i Instagram dajrekt mundëson dërgimin e fotografive private deri te miqtë e tyre.

Përparësia e instagramit është që fotografitë mund që me një klikim të shpërndahen në një ose më shumë rrjete të tjera sociale (Tviter, Fejsbuk, Tamblr).

Popullaritetin e konfirmojnë edhe të dhënat në dispozicion. Respektivisht, 72% e tinejxherëve në SHBA e shfrytëzojnë platformën, e cila tani ka më shumë se 1 miliardë shfrytëzues. Instagrami u mundëson tinejxherëve të bisedojnë me njerëzit që i njohin, të njihen me njerëz të rinj, të mbeten në kontakt me miqtë nga kampimi ose sportimi duke u lidhur nëpërmjet shpërndarjeve të fotografive ose për të diskutuar.<sup>27</sup>

27 [https://www.pewresearch.org/internet/2018/05/31/teens-social-media-technology-2018/pi\\_2018-05-31\\_teenstech\\_0-01/](https://www.pewresearch.org/internet/2018/05/31/teens-social-media-technology-2018/pi_2018-05-31_teenstech_0-01/)

Ekzistojnë shumë rreziqe nga Instagrami, shumë më tepër se nëpër rrjetet të tjera. Instagram shfrytëzuesit kanë qenë dëshmitarë të një shkalle të lartë të shqetësimeve, shkaktimit të depresionit, maltretimit etj.

### 3.2.13. Tuiteri/Twitter



Tuiteri është media sociale që ka për qëllim primar lidhjen e njerëzve dhe të mundësojë shpërndarjen e mendimeve personale.

Përdorimi i Tuitërit zhvillon shkathtësi të veçanta për të shprehur me numër të vogël fjalësh, fjalëve kyçe, shkurtesave, fjalëve karakteristike etj. Kjo për arsye se Tuiteri paraqet një sistem të mikro porosive sepse mundëson dërgimin dhe pranimin e porosive të shkurta, të quajtura tuite që mund të jenë tekstuale me 280 karaktere në maksimum, ndërsa mund të përfshihen edhe linke të ueb-faqeve relevante.

Tuitërin e shfrytëzojnë fëmijët dhe tinxherët dhe atë më së shpeshti nëpërmjet llogarive publike (accounts) të qasshme për të gjithë, ndërsa motivimin e gjejnë në faktin që përmbajtjet e publikuara mund të shpërndahen dhe të shkëmbehen shpejtë dhe larg.

Shfrytëzuesit e Tuitërit i ndjekin (follow) shfrytëzuesit e tjerë.

Ajo që nënkupton mik në Fejsbuk, është ndjekës në Tuitëri. Kur dikush ndiqet në Tuitëri mund të shihen tuitet e tij. Mund të krijohen edhe tuite personale, ndërsa mund që edhe të ridërgohen dhe kontrollohen informata që janë dërguar nga të tjerët. Ri-tuitimi nënkupton se informatat mund të shpërndahen shpejtë dhe efikas me një numër të madh njerëzish.

Tuitëri është një ueb-platformë relativisht e sigurt, sepse të gjitha llogaritë (accounts) janë të mbrojtura me fjalëkalim për shfrytëzuesit, Përderisa shfrytëzuesi e ka të mbrojtur fjalkalimin dhe i respekton cilësimet e privatësisë, llogaria e tij është e sigurt.

Shfrytëzuesit e Tuitërit vazhdimisht rriten. Sipas një studimi të vitit 2012<sup>28</sup>, çdo ditë publikohen rreth 15,000 tuite në lidhje me maltretimin, që nënkupton se mbi 100,000 porosi të sikletshme vërehen në botën digjitale brenda një jave nëpërmjet këtij rrjeti social.

Ekzistojnë disa mundësi për mbrojtje në Tuitëri:

- opsioni që të ndërpritet ndjekja e ndonjë llogarie (unfolloë) dhe të ndërpritet me çdo komunikim nga një llogari e caktuar nëse përmban informata të padëshiruara, ofendime ose përmbajtje të tjera të palejuara;
- bllokimi i llogarisë – me çka personi i bllokuar nuk mund që t'u përcjellë, ta shohë fotografinë tuaj të profilit, e as që të marrë njoftime për përgjigjet dhe përmendjet e tija.

Përvoja flet se pas ndërmarrjes së njëres prej këtyre aktiviteteve, personat që nuk ndjekën ose janë të bllokuar e humbin interesin për të vazhduar mënyrën e papranueshme të komunikimit ose shkëmbimit të informatave, pasi që kuptojnë se nuk marrin përgjigje.

Sidoqoftë, nëse vazhdohet me pranimin e përgjigjeve të padëshiruara, tendencioze dhe të vazhdueshme në Tuitëri, që janë pjesë e keqpërdorimit të Internetit, personi mund të ndërmarrë masa për ta parandaluar, ndërprerë ose paraqesë maltretimin e fëmijëve nga ana e moshatarëve të tyre në @StopBullyingGov.

28 [https://www.huffpost.com/entry/bullying-on-twitter\\_n\\_1732952](https://www.huffpost.com/entry/bullying-on-twitter_n_1732952)

### 3.2.14. Tumblr/Tumblr



Tumblr është aplikacion që përmban karakteristika të kombinuara të blogut dhe Tuterit e që nëpërmjet tij mund të dërgohen tekste, fotografi dhe/ose video dhe audio klipe. Shfrytëzuesit krijojnë dhe shpërndajnë blogje të shkurta “tumblogs” që, nëse vendosen publikisht, mund t’i shikojë secili. Ngjashëm me Tuterin është e mundur që të publikohet përsëri e njëjta përmbajtje dhe të shkëmbehen përmbajtjet e publikuara paraprake. Mund të ketë edhe blogje private, të mbrojtura me fjalëkalim, që janë të qasshme vetëm për personat për të cilët vendos krijuesi i blogut.

Ky aplikacion shfrytëzohet nga shumë tinxherë që kanë blogje të tyre të shkurtër nëpërmjet të cilëve shpërndahen fotografi, video dhe përmbajtje argëtuese me moshatarët dhe miqtë e tyre nga i njëjti aplikacion.

Ekzistojnë rreziqe në aspekt të shkëmbimit të përmbajtjeve me karakter të pahijshëm – fotografdi dhe video pornografike, përmbajtje të dhunës, shkëmbimi i ofendimeve etj.

### 3.2.15. GrupMi/GroupMe



GrupMi (GroupMe) është aplikacion që është falas dhe nuk ka kufizime për dërgimin e porosive personale dhe grupore, fotografive, videove dhe orarit të aktiviteteve. E shfrytëzojnë tinxher më të moshuar/rritur, ndërsa aplikacioni mundëson dërgimin e GIF-ëve dhe emotikonëve si dhe të bëhen diskutime në tema të caktuara, përfshirë edhe ato për të rritur. Shfrytëzohet nëpërmjet telefonit, andaj edhe tinxherët janë gjithmonë në lidhje mes veti.

### 3.2.16. Kik Mesinxher/Kik Messenger



Kik Mesinxher është një aplikacion që u mundëson fëmijëve të dërgojnë porosi falas pa kufizime. Është e famshme sepse shfrytëzohet në telefon. Aplikacioni është i shpejtë dhe mundëson komunikim intensiv sepse nuk ka kufizime në aspekt të madhësisë së porosive që mund të dërgohen.

Ky aplikacion përmban rreziqe të mëdha sepse mundëson komunikim me persona të panjohur që i shpërndajnë emrat e tyre abonues në Kik për të gjetur persona për bisedë. Konsiderohet se aplikacioni shfrytëzohet gjatë veprave penale me profil të lartë, e që është përdorur edhe për vrasjen e një vajze 13 vjeçare, kurse nëpërmjet këtij aplikacioni janë vërejtur edhe shumë raste të pornografisë së fëmijëve.

### 3.2.17. Tik Tok/TikTok



TikTok, që më herët njihej edhe si musical.ly, ndërsa në Kinë njihet edhe si Douyin, paraqet aplikacion që shfrytëzohet në telefonët celularë për krijimin, shpërndarjen dhe publikimiin e videove të shkurta muzikore me këndim, vallëzim, komedi dhe sinkronizim të buzëve. Lehtë përdoret dhe shumë më lehtë mund të rregullohet përmbajtja, krahasuar me aplikacionet e të tjera, siç janë Instagrami ose Snapçati.

TikTok u mundëson shfrytëzuesve të krijojnë video të shkurtra të vetes, që shpeshherë mund të shoqërohet me muzikë, mund të rregullohet me filtra, lehtë shpërndahet me të tjerët në TikTok ose platforma të tjera sociale. Ky aplikacion mundëson incizimin e videove të shkurta për sinkronizim të buzëve, me muzika të popullarizuara.

## Test për mësime dhënësit

### Forenzika digjitale!

Çdo mësime dhënësit ka për detyrë që për veten të mbajë "shënim digjital 24 orësh"

Të shënojë brenda një dite se kur ka bërë shënim digjital për veten gjatë shfrytëzimit të rrjeteve të caktuara sociale...

Pasi të përpilojë listën, të mendojë se cilën përmbajtje do të donte ta shlyej, e cilën jo dhe përse.

Ora	Rrjeti social/komunikimi digjital	Dua që ta shlyej (shëno)

Qëllimi i këtij testi është:

√ të ngritet vetëdija për praninë e secilit në botën digjitale

√ të kuptohet rëndësia e ruajtjes së të dhënave të caktuara në rast të dhunës digjitale sepse disa të dhëna mund të shfrytëzohen si argumente gjatë hetimeve dhe proceseve gjyqësore.



**Pjesa IV**  
DHUNA NDAJ FËMIJËVE  
NË AMBIENTIN DIGJITAL



## Kontrolli i mësimdhënësve

Kontrolloni se sa të dhëna për ju ka në botën digjitale.

Shkruani emrin tuaj në ndonjë shfletues (me shkronja cirilike dhe latine)

Kërkoni fotografi dhe pastime tuaja.

Në bazë të aktivitetit tuaj të përgjithshëm në internet, vendosni një listë me nivelet prej në 1 deri në 10 se me cilin nivel të ekspozimit të të dhënave tuaja keni hasur. Për shembull nëse vështirë gjenden të dhënat e juaja në internet dhe emri juaj është i panjohur në botën virtuale do të shënoni nivelin 1, ndërsa në të kundërtën nëse gjendeni lehtë shënoni nivelin 10, e kështu me rradhë.

Pyeteni vetën nëse ju konvenon lehtësia me të cilën dikush mund t'ju gjejë dhe se a shkakton kjo kënaqësi te ju apo jo.

Vallë njohuritë e fituara ndikojnë në hapat tuaj të mëtejme?

## 4.1. Nocioni dhe përkufizimi i dhunës digjitale

Dhuna digjitale është fenomen relativisht i ri, i cili ka okupuar opinionin shkencor dhe profesional gjatë dy dekadave të fundit.

Dhuna digjitale (cyber-bullying) është shfrytëzimi i teknologjisë digjitale (Internetit dhe telefonëve celular) me qëllim që të shqetësohet një person tjetër, të lëndohet, nënçmohet dhe t'i shkaktohet dëm.

Ndaj dhunës digjitale mund të ekspozohet secili person, pa dallim të moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, njohurive të shkathtësive digjitale, shfrytëzimit të teknologjisë, shkathtësive sociale.

Hulumtimet në nivel të BE-së flasin se gjysma e fëmijëve që janë shfrytëzues të internetit të moshës ndërmjet 11-16 vjeç, hasin në një prej rreziqeve më të shpeshta të internetit siç është dhuna kibernetike, predatorët kibernetik, mashtrimet, maltretimet, mashtrimet me qëllim të fitimit të të dhënave personale, fjalëkalimeve, numrave të kartave kreditore etj. (phishing) etj.

Nga ana tjetër, i njëjti hulumtim tregon se më tepër se gjysma e të anketuarve nuk e dijnë se si të ballafaqohen me rreziqet e internetit.<sup>29</sup>

Për dhunën digjitale përdoren edhe nocine të tjera të ngjashme që do të përdoren në këtë material edhe atë si dhunë elektronike, dhunë në internet, "online" dhunë, dhunë kibernetike, maltretime në botën digjitale.

<sup>29</sup> [https://ec.europa.eu/education/education-in-the-eu/european-educationarea/digital-education-action-plan-action-7-cybersecurity-in-education\\_en](https://ec.europa.eu/education/education-in-the-eu/european-educationarea/digital-education-action-plan-action-7-cybersecurity-in-education_en)

## Test për mësimdhënësit

Së pari – bëni një listë me lloje të ndryshme të dhunës që e keni përjetuar deri tani në jetën tuaj dhe pasojat që i keni pasur nga e njëjta.

Nëse nuk keni përjetuar dhunë, shkruani një listë të llojeve të dhunës dhe pasojat nga e njëjta gjatë përvojës tuaj profesionale, përvojave nga nxënësit, kolegët, familja, të njohurit.

Së dyti – bëni një listë të posaçme me llojet e mundshme të dhunës digjitale, nëpërmjet rrjeteve sociale dhe pasoja nga e njëjta.

Së treti – krahasoni të dy listat dhe mendoni rreth pasojave nga dhuna tradicionale, klasike dhe ajo digjitale. Vallë kanë dallim apo ngajshmëri dhe në cilat pjesë?

## 4.2. Karakteristikat, format e dhunës digjitale dhe dallimet nga dhuna klasike

Si në jetën reale ashtu edhe në botën digjitale, individi mund të bëhet edhe viktimë edhe kryerës i një sjelljeje të caktuar të papranueshme shoqërore.

Zhvillimi i teknologjisë mundëson që të paraqiten vepra të reja penale në dëm të fëmijëve, por edhe format e vjetra të krimit filluan që të kryen në mënyrë më ndryshe, në formën digjitale.

Ekzistojnë dallime ndërmjet dhunës klasike dhe asaj digjitale, por që të dyja paraqesin fenomene sociale, sepse janë problem i komunikimit ndërnjerëzor.

Dhuna tradicionale/klasike në botën off-line	Dhuna digjitale në botën "online"
Sulm direkt fizik dhe cenim i shëndetit të njerëzve;	Në "botën virtuale" nuk është e mundur që fizikisht të lëndohet apo cenohet një person tjetër, por që arsyet ose pasojat janë nga ambienti real;
Komunikimi direkt, sulmet verbal dhe joverbale, si dhe ofendimet "sy më sy"	Gjatë komunikimit digjital, njerëzit tregojnë dhe bëjnë punë që nuk do t'i bënin "sy më sy"
Dhuna pushon kur burimi i dhunës, respektivisht personi i dhunshëm do të largohet	Dhuna digjitale vazhdon edhe kur do të çkyçet kompjuteri ose telefoni celular
Dhuna klasike bëhet në një kohë dhe vend të caktuar ku ballafaqohen sulmuesi dhe viktima	Dhuna digjitale mund të bëhet në çfarëdo kohe dhe vendi, pa ballafaqim direkt
Gjithmonë dihet dhunuesi/sulmuesi	Personat që prezantohen nëpërmjet profileve të tyre nuk janë të njëjtit edhe në jetën reale, sepse internet mundëson krijimin e profileve virtuale dhe të rrejshme
Lehtë përcaktohet dallimi i fuqisë	Është e pamundur të përcaktuar dallimi në fuqinë
Një numër i caktuar i dëshmitarëve	Publik i pafund

Mirëpo, dhuna është dhunë, pa marrë parasysh nëse ndodh në shkollë, park ose autobus, përsëri pasojat janë shumë të rënda dhe afatgjate. Dhuna digjitale ndonjëherë mund të jetë më e rrezikshme se ajo që ndodh në botën reale, por me pasoja afatgjate dhe dramatike për viktimën, në raste ekstreme edhe me vetëvrasje për viktimën.

### **Karakteristikat e dhunës digjitale janë:**

- Shkallë e lartë e anonimitetit të personit të dhunshëm ose grupit që shfrytëzon emra të rrejtshëm, nofka, numra telefoni ose profile të rrjeteve sociale, vështirë zbulohet identiteti i tyre sepse dhunën digjitale disa autorë e quajnë edhe si “formë qyqare e dhunës nga bashkëmohatarët” (Besley, 2006);
- Anonimiteti e inkurajon dhunuesit që të sillet në mënyrë që nuk do të silllej gjatë kontaktit direkt, kontribuon ndaj disinhibicionit si mungesë e vetëpërmbytjes dhe vetëkontrollit të sjelljes që nuk do të ndodhte në ambient real, por edhe të frikës më të vogël nga dënimi dhe zbulimi;
- Qasja e përhershme ndaj viktimës dhe ekspozimi në dhunë në çfarëdo kohe madje edhe atëherë kur nuk shfrytëzohet internet ose edhe kur personi do ta deaktivojë profilin e tij në rrjetin social, por dikush do të krijojë profil tjetër me emrin e tij dhe pa dijeninë e tij.
- Viktima nuk është e sigurt as në shtëpinë e vet;
- Dhuna zgjatë, forcohet dhe plotësohet;
- Gjatë dhunës digjitale mund të përfshihen numër i madh i dëshmitarëve (me dëshirën e vet ose të tjetërkujt) edhe atë shumë më tepër se sa në oborrin e shkollës gjatë një dhune klasike të moshatarëve;
- Informatat përhapen shumë shpejtë dhe pa kontroll rritet numri i personave që përcillen dhe komentohen;
- Një veçori e shfrytëzimit të këtij lloji komunikimi është se porosia që e dërgon personi është më e lehtë për transmetim sepse mungon informata kthyesë nga pala tjetër, siç është gjuha e trupit, për shembull, shprehjet e ndryshme të fytyrës dhe gjestet, madje edhe sulmi direkt, e që këtu është i përealizueshëm.

### **Dhuna digjitale ndaj fëmijëve mund të paraqitet ndërmjet fëmijëve dhe ndërmjet një fëmiju dhe të rrituri:**

- Dhuna ndërmjet fëmijëve në formë të dhunës së moshatarëve është kur fëmijët nëpërmjet internetit ose telefonit celular janë të ekspozuar ndaj sulmeve të fëmijëve tjerë ose grupeve. Qëllimi i këtij lloji dhune është shqetësimi, lëndimi, mbjelljen e frikës ose çfarëdo lloji tjetër të dëmit te fëmijët të cilët nuk mund të mbrohen nga porositë e këtilla. Mund të paraqiten në formë të porosisë tekstuale ose videos, fotografisë ose thirrjes;
- Fëmija mund të përjetojë dhunë digjitale nga një person i rritur ose nga grup i tillë dhe të bëhet viktimë e pedofilisë, mënyrave të ndryshme të keqpërdorimit seksual, pornografisë së fëmijëve, prostitucionit dhe tregtisë me njerëz, si dhe nëpërmjet faqeve që kanë tematikë të dëmshme si vetëvrasjet, anoreksinë, kidnapimet, drogën, terrorizmin e që mund të sjellin deri te lëndimi i fëmijëve, sëmundjeve madje edhe vdekjes. Përndjekja me qëllim të shfrytëzimit/keqpërdorimit seksual (grooming) shfrytëzohet për të gjitha hapat e motivuar si predatorë, respektivisht aktivitete që kanë për qëllim kontaktin, ruajtjen e komunikimit dhe qasjes fizike deri te fëmija.

Të gjithë fëmijët mund të jenë të prekur ose lënduar nga këto tema dhe të bëhen viktima potenciale. Si vëzhgues të paqëllimshëm dhe të rastësishëm, duke kërkuar nëpër faqet e internetit mund të hyjnë në ndonjë tekst, fotografi, video klip ose të bëhen subjekte, viktima të pedofilëve që i vërejnë nëpërmjet ndonjë fotografie të publikuar.

Dhuna digjitale paraqitet në më shumë forma dhe manifestohet në mënyra të ndryshme edhe atë nëpërmjet sulmit direkt dhe indirekt nëpërmjet një ndërmjetësuesi.

Sulmi direkt është kur fëmijës:

- i dërgohen porosi shqetësuese, ofenduese dhe kërcënuese në telefon celular, e-mail ose çat;
- përqeshet në çet dhomat dhe forumet e internetit;

- i vidhet ose ndryshohet fjalëkalimi për e-mail ose emri/nofka e çetit;
- shkelet diskrecioni i asaj që publikohet ose përhapen të pavërteta, të dhënat e fshehta private të dikujtë, fotografi kompromituese në blog, çet ose internet;
- incizimi dhe distribucioni i fotografive, porosive dhe materialit me përmbajtje seksuale;
- injorimi, përjashtimi nga grupet e rrjeteve sociale dhe nxitja e urrejtjes në baza të ndryshme;
- dërgohen viruse, fotografi shqetësuese, pornografi ose postë apo e-maile të tjera të padëshirueshme si dhe sms porosi në telefon celular;
- rrejshëm prezantohet si një person tjetër ose person i moshuar.


Sulm indirekt është kur sulmuesi e sulmon fëmijën nëpërmjet një personi të tretë (i cili mund të mos jetë i vetëdijshëm së është shfrytëzuar) edhe atë:

- Ndërmjetësuesi e zbulon fjalëkalimin e e-mail adresës së fëmijës dhe emrin/nofkën në çet, e shfrytëzon për dërgimin e porosive shqetësuese ndaj miqve të tij dhe len përshtypje se fëmija viktimë, në fakt është ai që bën keqpërdorime. Miqtë e dëbojnë, prindërit nuk marrin masa, do t'ia çkyçin internetin...ndërsa nuk janë të vetëdijshëm se janë ndërmjetësues në keqpërdorimin e fëmijës së tyre. Sulmi nëpërmjet ndërmjetësuesi është lloji më serioz dhe më i rrezikshëm i dhunës nëpërmjet internetit, sepse shpesh përfshinë persona të rritur me qëllime të këqija dhe më së shpeshti me përmbajtje pornografike.

Dhuna digjitale e një të rrituri ndaj një fëmije mund të jetë shumë më e rrezikshme dhe të marrë dimensione të papritura veçanërisht kur bëhet fjalë për predatorë seksual dhe pedofilë. Një hulumtim i publikuar në SHBA (Eolak, J., Finkelhor, D., Mitchell, K. J., and Ybarra, M. L. 2008. "online" Predators and Their Victims: Myths, Realities, and Implications for Prevention and Treatment. American Psychologist, February-March 2008.) thekson se nuk ekiston një profil i qartë i predatorit seksual në internet. Dihet vetëm se shumica e tyre janë burra, kurse prejardhja, profesioni dhe mosha e tyre në masë të madhe variojnë. Predatorët seksualë kalojnë kohë të gjatë në internet me qëllim që të vendosin kontakt me fëmijë, ju kushtojnë vëmendje të madhe, ju japin komplimente, ofrojnë miqësi, mirëkuptim për të fituar besimin e tyre dhe t'i lidhin me ta. Miqësohen në mënyrë që fëmijët zakonisht pajtohen për takime dhe nuk mendojnë se e njëjta mund të ketë përmbajtje seksuale.

## 4.3. Format e dukurisë së dhunës nëpërmjet internetit

### 4.3.1. Komunikimi onlajn me qëllim të keqpërdorimit seksual (grooming)



Krijimi i një lidhje besimi dhe emocionale ndërmjet një fëmije (më së shpeshti) dhe një personi të rritur nëpërmjet teknologjisë komunikuese ka për qëllim regrutimin dhe eksploatimin e personave të mitur për

qëllime seksuale, ndryshe njihet me emrin grooming. Fëmijët më lehtë involvohen në kontakte dhe aktivitete potencialisht të rrezikshme për shkak të moshës, kuriozitetit dhe pjekurisë së pamjaftueshme për të kuptuar dhe njohur rreziqet. Këto mundësi i shfrytëzojnë njerëz të cilët janë manipulatore jashtëzakonisht të mirë, që janë të aftë për vendosjen e kontakteve dhe fitimit të besimit dhe që dijnë se si vazhdimisht ti detyrojnë fëmijët për të dërguar fotografi dhe video të tyre lakuriq. Ata shfrytëzojnë joshjen, kërcënimet dhe kushtëzimet.

#### Çfarë kërkohet nga viktimat e grooming-ut?

- √ të bëjnë biseda seksuale nëpërmjet internetit ose porosive seksuale
- √ të dërgojnë fotografi lakuriq të tyre, që nganjëherë quhet edhe seksting
  - √ të dërgojë video seksuale të tij
- √ të emetojnë përmbajtje seksuale drejtpërdrejt në ueb-kamerë
  - √ komunikimi ka status të fshehtë
- √ shumë informata personale dhe intime
- √ personalisht të takohet keqbërësi.

Rrezik më të madh për grooming ka në Instagram.

Analiza e grooming-ut tregon se shumica e personave kanë plan që të vendosin lidhje besimi me një fëmijë, së pari e përcjellin komunikimin në kuadër të një grupi të rrjetit social ose në të a.sh chat room (dhomë për biseda), duke përzgjedhur viktimat potenciale dhe duke mbledhur informata për ta.

Pastaj ata kyçen në bisedë dhe fillojnë të vendosin lidhje, para se gjithash duke përcjellë interes dhe temat që janë të rëndësishëm për fëmijën. Ndonjëherë ata prezantohen si moshatarë. Në fazën fillestare ky kontakt nuk duket i rrezikshëm dhe joadekuat. Por, pas një kohe të caktuar vazhdojnë që të ndërtojnë raport të besimit dhe të potencojnë ndarjen e fshehtësive.

Kështu ata vendosin marrëdhënien e besimit, pastaj nisin tema të sjelljes së rrezikshme në bisedë, duke mbledhur informata për fëmijën e që më pas do t'i shfrytëzojnë për ta kushtëzuar. Bëhen tema për seksin, që thellohet deri në atë shkallë që kërkon materiale provokative, duke e bindur fëmijën se "çdokush e bënë këtë", duke e përkrahur fëmijën në mënyr që i tregon materiale të tilla joadekuate.

#### Gjashtë vende ku mund të ndodh grooming:<sup>30</sup>

- √ ueb-faqe për rrjetëzim social
- √ aplikacione për porosi të shpejta dhe paraqitje direkte
- √ aplikacione dhe faqe për ndarjen e fotografive, si instagrami
- √ chat rooms – dhomat për biseda
- √ aplikacionet për shoqërimi
- √ ueb-faqe për lojra.

Hulumtimi EU Kids "online" 2020<sup>31</sup> potencon se ndërmjet një të katërtës dhe një e dyta e fëmijëve kanë komunikuar nëpërmjet Internetit me dikë që nuk e kanë njohur ballë për ballë më herët; një në gjashtë fëmijë janë takuar me dikë të tillë. Shumica e fëmijëve më të rritur dhe djelmoshave komunikojnë me njerëz të panjohur se sa fëmijët më të rinj apo vajzat. Shumica e fëmijëve janë prononcuar se janë të lumtur pas takimit ballë për ballë me kontaktet e tyre të Internetit, përsëri duke potencuar faktin se ky aktivitet mund të jetë edhe mundësi, e jo vetëm rrezik.

30 <https://www.childline.org.uk/info-advice/bullying-abuse-safety/online-mobile-safety/online-grooming/>

31 Smahel, D., Machackova, H., Mascheroni, G., Dedkova, L., Staksrud, E., Ólafsson, K., Livingstone, S., and Hasebrink, U. (2020). EU Kids Online 2020: Survey results from 19 countries. EU Kids Online. Doi: 10.21953/lse.47fdeqj010fo, <https://www.lse.ac.uk/media-and-communications/assets/documents/research/eu-kids-online/reports/EU-Kids-Online-2020-10Feb2020.pdf>

### 4.3.2. Ndjekja nëpërmjet Internetit (cyberstalking)

Ndjekja nëpërmjet Internetit përfshin shfrytëzimin e internetit ose mjeteve të tjera elektronike për maltretimin, frikësimin ose shqetësimin e një individi ose grupi në formë të shqetësimit seksual, kontaktit joadekuat ose vëmendjes së padëshiruar në lidhje me jetën e viktimës dhe aktivitetet e familjes së tyre.

Karakteristikat e përbashkëta të keqpërdorimit nëpërmjet Internetit mund të përfshijnë akuza të rrejshme ose publikimin e deklaratave ofenduese, përcjelljen e aktivitetit të dikujt në Internet ose lokacionit në të cilin personi gjendet fizikisht, kërcënime, vjedhje të identitetit dhe shkatërrimit të të dhënave ose manipulimi përmes sdërgimit të virusit në pajisjet e viktimës.

Përndjekësit kibernetik mund të shfrytëzojnë e-postën, porositë e shpejta, thirrjet telefonike dhe regjime të tjera të komunikimit me qëllim të përndjekjes.

### 4.3.3. Shfrytëzimi i profileve të rrejshme me qëllim të dëmtimit të viktimës (catfishing)

Shfrytëzimi i profileve të rrejshme me qëllim të dëmtimit të viktimës (catfishing) është një formë e dhunës në internet (cyberbullying) dhe ka të bëjë me praktikën e vendosjes së një profili fiktiv nëpërmjet internetit, më së shpeshti me qëllim të tërheqjes së tjetrit në një lidhje mashtruese romantike, krijimit të një miqësie të rrejshme për dëmtimin e imazhit dhe për të turpëruar viktimën, pa përjashtuar edhe interes financiar. Së këndejmë mund që të përodren edhe emra, fotografi dhe lokacione të rrejshme.

Nuk përjashtohen rastet kur edhe kopjohet ndonjë profil ekzistues me qëllim që të sigurohet identiteti i personit të vërtetë dhe të shfrytëzohet për ta mashtruar viktimën.

#### **Rastet e shfrytëzimit të profileve të rrejshme me qëllim të dëmtimit të viktimës:**

I rritur ndaj një fëmije: Në vitin 2006, 13-vjeçarja MM kishte filluar lidhje nëpërmjet internetit me një djalë që e ka njohur si XHE. Ata i kanë shkruar njëri tjetrit pothuaj se një muaj dhe kanë komunikuar vetëm nëpërmjet internetit, sepse ai i kishte thënë se nuk ka telefon dhe se arsimohet në kushte shtëpie. Një ditë vajza kishte marrë porosi nga djali në profilin e saj në MySpace, në të cilën ai i kishte thënë se nuk dëshiron që të jenë shokë më tutje sepse ka kuptuar se ajo nuk sillet mirë me miqtë e saj, duke filluar më pas që t'i shkruajë vajzës se është "e trashë" dhe "k.rvë". Pasi i kishte parë porositë, vajza e shqetësuar ishte mbyllur në dhomën e saj, ku më vonë nëna e saj e kishte gjetur të varur. Vajza kishte qenë viktime nga catfishing, sepse pas vdekjes së saj është zbuluar se XHE nuk është djalë, por nëna e njëres prej shoqeve të saj që e ka krijuar profilin e rrejshëm për të spiunuar se çfarë flet MM për vajzën e saj.

Një fëmijë ndaj fëmijëve të tjerë: djalë i moshës 18 vjeç në vitin 2009 kishte hapur dy profile me emra të vajzave në Facebook. Ai është shoqëruar dhe ka krijuar lidhje romantike nëpërmjet internetit me një numër të madh të djemve të shkollës së mesme, të cilët ishin të bindur se po komunikojnë me vajza. Kishte arritur që të bind se paku 31 prej atyre djemve që t'i dërgojnë fotografi ose video lakuriq. Pastaj, duke vazhduar që të prezantohet si vajzë ka arritur që të bindë gjysmën e djemve të kenë takim me një shok "të saj" duke i lejuar që të kryejnë akte seksuale ndaj tyre. Nëse do të refuzonte "vajza" është kërcënuar se do t'ja publikojë fotografitë dhe videot. Shtatë djem janë pajtuar me kërkesën e këtyre të tmerrshme dhe i kanë lejuar 18-vjeçarit që të kryejnë akte seksuale ndaj tyre. Ai me telefonin celular ka barë shumë fotografi nga këto takime. Më vonë policia ka gjetur mbi 300 fotografi lakuriq të tinxherëve meshkuj në kompjuterin e tij. U akuzuar për më shumë vepra penale (mashtrime të fëmijëve, sulm seksual të shkallës së dytë dhe të tretë ndaj fëmijëve, posedim të pornografisë së fëmijëve dhe përsëritjen e sulmit seksual ndaj të njëjtit fëmij) dhe ishte dënuar me 15 vite burgim në fillim të vitit 2010.

Me qëllim që të mbrohen, fëmijët duhet të mësohen që të shmangin lidhjet e ngushta me një person tjetër të cilin e njohin vetëm onlajn, e që nuk e kanë njoftuar fizikisht. Së këndejmë, është e rëndësishme që të mos zbulohen shumë të dhëna personale, fshehtësi, qëndrime për persona të tjerë, qëndrime dhe dobësi personale etj, të cilat mund të keqpërdoren.

Skepsa dhe kujdesi, mosbesimin dhe rezervimi, komunikimi vetëm me persona që fizikisht njihet me qasjet kryesore mbrojtëse për mbrojtje nga catfishing me qëllim për cyberbullying.

Edhe një aspekt është i rëndësishëm për këtë formë të dhunës/dëmtimit nëpërmjet internetit, e që është turpi i viktimës që të pranojë se “ka rënë” në lidhjen mashtruese romantike me qëllim që të shmangë përqeshje nga rrethi, nga moshatarët, dënimet nga prindërit ose personat e tjerë të rritur. Gjendja e këtillë ndaj viktimave krijon ndjenjën e humbjes së vetëbesimit, vetë gjykimit, shpesh herë madje edhe vetë dënimit, depresionit, introvertës, shmangies së ngjarjeve sociale, shoqërimeve etj.

Sidoqoftë, nuk duhet të shkohet në skajshmëri se çdo njohje e re nëpërmjet internetit është e rrëshme dhe se personi ka qëllime të fshehta, jo të sinqerta dhe mashtruese. Dyshimet duhet të paraqiten vetëm nëse personi shmang mundësinë për njoftim personal dhe insiston vetëm për komunikim onlajn. Është e pëlqyeshme që njoftimi të realizohet në prani të disa personave të njohur prej më herët, me qëllim që të shmangen rreziqet e mundshme.

Shfrytëzimi i profileve të rrëshme shfrytëzohet si një metodë e arsyeshme me qëllim të zbulimit të pedofilëve si individ apo grupeve dhe rrjeteve të pedofilëve. Në këtë rast, profili i rrëshëm hapet nga personi i rritur që paraqitet si fëmijë me qëllim të mashtrimit, respektivisht identifikimit të pedofilëve, me çka nuk shkaktohet dëm, por përkundrazi insistohet që të vihet deri te argumentet e sakta të pedofilisë ose onlajn materiale pornografike me fëmijë.

#### Këshilla:

- Kontrolloni profilin/akauntin e shfrytëzuesit – se sa miq, ndjekës ka, sepse praktika tregon se profilet e rrëshme kanë numër të vogël të miqve/ndjekësve
  - Kontrolloni fotografinë e vendosur në profil, sepse në atë mënyrë kërkimi mund të çojë deri te burimi se ku është marrë fotografia nga profili i rrëshëm
- Kontrolloni albumin me fotografi, respektivisht fotot në dispozicion nga profili/akaunti dhe gjithmonë është i dyshimtë kur personi është i vetëm në fotografi, nuk ka fotografi me miq, familje etj.
  - Nëse në profil ka vetëm fotografi të modeluara, pejsazhe, ekziston një rrezik i madh që profili të jetë i rrëshëm
- Tentoni të vendosni video lidhje (nëpërmjet telefonit ose platformave tjera sociale) dhe nëse personi shmang këtë formë kontakti, menjëherë ndërpritni komunikimin/bllokoni komunikimin e mëtejshëm.

## 4.4. Trauma si pjesë e dhunës në internet

Trauma është rezultat i “ngjarjes”, së një sërë ngjarjeve ose një sërë rrethana që individit i përjeton si të dëmshme fizikisht ose emocionalisht ose të rrezikshme për jetën që ka efekte të përhershme negative ndaj funksionimit të individit dhe mirëqenies së tij mentale, fizike, sociale emocionale ose shpirtërore.<sup>32</sup>

Gjendja e këtillë shkakton shqetësim, simptomatologji dhe patologji te fëmijë dhe sjell deri te shqetësime që mund të kenë pasoja afatgjate mbi fëmijët edhe kur të rriten.

Prej të dhënave më të qasshme mund të veçojmë:

<sup>32</sup> <https://cyberbullying.org/trauma-bullying-cyberbullying>; SAMHSA's concept of trauma and guidance for a trauma-informed approach. HHS Publication No(SMA) 14-4884, 2014. [https://ncsacw.samhsa.gov/userfiles/files/SAMHSA\\_Trauma.pdf](https://ncsacw.samhsa.gov/userfiles/files/SAMHSA_Trauma.pdf)

- të maltretuar 37% nga numri i adoleshentëve britanik që kanë qenë të maltretuar, theksojnë nivele të konsiderueshme klinike të stresit post-traumatik.<sup>33</sup>
- 25% e të anketuarve të rritur duket se kanë pasur simptome të stresit post-traumatik, siç janë sulme nga kujtimet nga maltretimet madje edhe pas shumë viteve të mbarimit të shkollimit.
- 57% e personave të maltretuar, mesatarisht kanë shfaqur simptome të stresit posttraumatik mbi pragjet e dukurive (gjegjesisht, mjaftë ëqë formalisht të klasifikohen si traumë)<sup>3435</sup>

Mund të konstatohet që niveli i ballafaqimit të shpeshtuar të maltretimit është faktori më i madh për parashikimin e nivelit të traumës që mund të kalojë viktimat.

## Nacionet dhe terminologjia e rëndësishme për dhunën digjitale

Dhuna digjitale (Digital violence, cyber-bullying)	Shfrytëzimi i teknologjisë digjitale me qëllim që të shqetësohet një person tjetër, të lëndohet, nënçmohet, kushtëzohet ose të dëmtohet nëpërmjet internetit ose medimeve të tjera elektronike. Në vete përmban të gjitha llojet e dhunës nga eksploatimi, tortura fizike, verbale, emocionale, keqpërdorimi seksual. Shfrytëzohen edhe nocione të tjera të ngjashme: dhunë elektronike, dhunë në internet, dhunë "online", dhunë kibernetike, maltretime në botën digjitale etj.
Grooming	Kontakti me fëmijë nëpërmjet internetit që përfshin një sërë hapash të motivuar predatore, respektivisht aktivitete që kanë për qëllim mashtrimin, vendosjen e komunikimit dhe fitimin e besimit, ndërsa si qëllim final e kanë qasjen dhe kontaktin fizik, respektivisht keqpërdorimin seksual të fëmijës.
Ambienti digjital	Teknologjia informaitke-komunikuese (TKI) e cila në vete përfshinë internetin, telefonët celular dhe pajisjet dhe teknologjinë e lidhur, rrjetin digjital, bazën e të dhënave, përmbajtjet dhe shërbimet.
Identiteti në internet (ang. Identity on the Internet)	Identiteti që formohet në bazë të fotogradfisë, përmbajtjeve tekstuale, audio dhe video përmbajtjeve për personin që vetë (ose dikush tjetër) i vendos në internet.
Identiteti i rrejshëm në internet (ang. False identity on the Internet)	Fotografi të cilën e krijon personi për vete në internet, e që nuk përket me realitetin.
Përmbajtje eksplicite në internet (ang. Explicit content on the Internet)	Përmbajtje eksplicite në internet, Përmbajtje të padëshiruara, p.sh.: përmbajtje eksplicite seksuale dhe pornografike, përmbajtje të dhunshme në internet etj.
Internet predator (ang. Internet predator)	Person i cili shfrytëzon internetin (rrjetet sociale, dhomat për çat, "online" lojrat) për të krijuar kontakt me fëmijë dhe të rinj, me qëllim të kënaqjes së tyre personale nëpërmjet keqpërdorimit ose shfrytëzimit seksual të fëmijëve. Më së shpeshti shfrytëzojnë nofka, krijojnë miqësi, ndajnë të njëjtat interesa për t'u afruar te fëmijët.
Dhunuesit kibernetik	Persona që tentojnë të turpërojnë ose frikojnë fëmijët.

33 Mynard H, Joseph S, Alexander J. Peer-victimisation and posttraumatic stress in adolescents. *Personality and Individual Differences*. 2000, 29(5), pp. 815-821.

34 Rivers I. Recollections of bullying at school and their long-term implications for lesbians, gay men, and bisexuals. *Crisis*. 2004, 25(4), pp. 169-175.

35 Nielsen MB, Tangen T, Idsoe T, Matthesen SB, Magerøy N. Post-traumatic stress disorder as a consequence of bullying at work and at school. A literature review and meta-analysis. *Aggression and violent behavior*. 2015, 21, pp. 17-24.

Seksting (ang. Sexting)	Vendosja e në internet ose dërgimi i fotografive, porosive ose video-incizimeve me përmbajtje eksplicite seksuale, me qëllim të shqetësimit seksual, hakmarrjes ose të një agresioni tjetër.
Çetimi (ang. Chating)	Formë e komunikimit ndërmjet dy ose më tepër shfrytëzuesve që janë njëkohësisht në rrjet, nëpërmjet kompjuterit ose pajisjes tjetër digjitale si telefon i mençur, tablet, e që zhvillohet në "kohë reale". Sot janë në dispozicion një numër i madh i aplikacioneve për çetim (p.sh. Viber, WhatsApp, Skype, Snapchat etj).
Transmetim direkt në kohë reale (ang. Live streaming)	Keqpërdorim seksual i fëmijëve që ndodh në kohë reale dhe bëhet kur fëmija është i detyruar që të paraqitet para ueb kamerës dhe të kyçet në sjellje eksplicite seksuale ose të përjetojë keqpërdorim seksual. Këto përmbajtje nëpërmjet internetit transmetohen deri te kryerësi ose blerësi që ka paguar të shohë ose kërkon një lloj të caktuar të keqpërdorimit që e sheh në kohë reale.
Shpërndarja (ang. Sharenting)	Shpërndarja – ndarja e informatave personale dhe fotografive të fëmijëve në internet (më së shpeshti në faqe për lidhje sociale, blogje) nga ana e prindërve/kujdestarëve të tyre.
Hakerizëm (ang. Hacking)	Formë e dhunës elektronike, e njëherit edhe krim i teknologjisë së lartë, kur hakerët i shfrytëzojnë njohuritë e tyre të avancuara kompjuterike, në mënyrë të paautorizuar për të hyrë në sisteme të huaja kompjuterike për të shkaktuar dëm ose të realizojnë ndonjë përfitim. Te të rinjtë ky nocion shfrytëzohet kur njëri-tjetrit i marrin fjalëkalimin e ndonjë rrjeti ose platforme sociale.
Kontroll prindëror (ang. Parental control)	Masa teknike për mbrojtjen që ju mundësojnë të rriturve që të mbrojnë fëmijët gjatë shfrytëzimit të internetit edhe atë nëpërmjet kufizimit të kohës që e kanë kaluar në internet ose përmbajtjen te e cila kanë qasje, si dhe aktivitetin e fëmijës në internet (pamundësimin e bisedës me persona të panjohur, shpenzimit të parave për aplikacione etj.).
Arsimimi digjital ose kompetena digjitale (ang. digital literacy, digital competence)	Aftësi për gjetjen, analizën, krijimin dhe transmetimin e informatave në format digjital. Përmbledhje e njohurive, shkathtësive dhe sjelljeve që janë në lidhje me përdorimin e pajisjeve digjitale.
Shenjat digjitale (ang. digital footprint)	Ato janë shenja që lihen kur shfrytëzohet internet. Ekzistojnë shenja passive (kur të dhënat ruhen pa dijeninë e shdfrytëzuesit) dhe aktive (kur shfrytëzuesi vet lë të dhënat e veta personale në internet).
Cajbep përndjekje (ang. cyber-stalking)	Përndjekja e viktimës nëpërmjet internetit ose mjeteve të tjera elektronike me qëllim të shqetësimit dhe maltretim.
Reputacion digjital	Ndërtimi i "imazhit për veten" në botën digjitale, sjellja në ambientin e internetit, përmbajtja që e vendos shfrytëzuesi për veten dhe të tjerët.
Haker	Personi që modifikon programet, hyn ilegalisht në sistemet e huaja operative të sigurisë dhe ato personale duke shfrytëzuar informatat e huaja.
Inteligjenca artificiale (ang. artificial intelligence)	Inteligjenca që e manifestojnë makinat, kompjuterët, telefonët celular, konsolat e lojrave etj.

Catfishing

Shfrytëzimi i profileve të rrejshme me qëllim të dëmtimit të viktimës, paraqet formë e dhunës në internet. Tentime mashtruese për të marrë informata ose të dhëna të ndjeshme, siç janë emrat e profileve, fjalëkalime dhe detaje për kartela kreditore, duke aktruar gjoja se janë ndonjë subjekt i besueshëm gjatë komunikimit elektronik.



**Pjesa V**  
SHKOLLA DHE DHUNA DIGJITALE



## 5.1. Shënime hyrëse

Parandalimi dhe ndalimi i dhunës ndaj nxënësve në shkollë është rregulluar me ligjet për arsimin fillor dhe të mesëm që janë bazë e reagimit dhe veprimit në aspekt të të gjitha llojeve dhe niveleve të dhunës. Është obligim i drejtorit të shkollës që të paraqesë çdo formë të dhunës, keqpërdorimit ose neglizhimit të kryer ndaj një nxënësi nga ana e një nxënësi tjetër, prindi ose kujdestari, mësmdhënësi, bashkëpunëtor profesional ose person tjetër që është i punësuar në shkollë, deri te insitiucionet kompetente të përcaktuara me ligj. Procedura e paraqitjes dhe mbrojtjes së një nxënësi viktimë nga cila do formë e dhunës, keqpërdorimit dhe neglizhimit, përcaktohen me aktin nënligjor (neni 66 nga Ligji për arsimin fillor). Gjithsesi se këtu bën pjesë edhe dhuna digjitale ndaj nxënësve.

Cili është roli i shkollës?

Shkolla duhet të japë informata për prindërit dhe nxënësit, nëpërmjet trajnimeve, punëtorive, inkorporimit të njësive mësimore me tema të shfrytëzimit të sigurt të internetit dhe dhunës digjitale.

Njëherit shkolla patjetër duhet të realizojë bashkëpunim të mirë me prindërit<sup>36</sup>.

Por në mënyrë që shkolla të zbatojë këtë aktivitet, patjetër duhet të forcohen kapacitetet profesionale të punëtorëve profesional dhe mësmdhënësve nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme. Faktor kyç është ndërtimi i arsimit të tyre digjital dhe kompetencës digjitale, për shkak të parandalimit, zbulimit dhe intervenimit në rast të dhunës digjitale.

Në mungesë të të dhënave për situatën në shtetin tonë, hulumtimi i realizuar në Serbi në vitin 2013<sup>37</sup>, ka treguar se pothuajse gjysma e mësmdhënësve të anketuar (47%) konsiderojnë se janë jo mjaft të informuar lidhur me dhunën digjitale dhe se sa më shumë shfrytëzojnë internetin, aq më seriozisht e marrin dhunën digjitale. Edhe pse 66% e shkollarëve të mesëm në Serbi kanë përjetuar dhunë digjitale, vetëm 15% u janë drejtuar mësmdhënësve për ndihmë. Madje 66% të mësmdhënësve konsiderojnë se shkolla nuk ka kapacitet që të ballafaqohet me këtë formë të dhunës dhe se prindërit janë ata që kanë rolin kyç për zgjidhjen e problemeve.

### **Roli i shkollës në mbrojtjen e nxënësve nga dhuna digjitale është si vijon:**

- Parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna digjitale ndërmjet nxënësve në shkollë dhe jashtë saj;
  - Njohja dhe zbulimi i dhunës digjitale ndërmjet nxënësve dhe dhuna ndaj fëmijës nga një i rritur (pedofilia);
- Parandalimi, denoncimi dhe ndihma me përkrahje gjatë trajtimit të fëmijës viktimë dhe fëmijës që ka kryer dhunë digjitale
  - dhuna ndërmjet nxënësve ose dhuna ndërmjet fëmijës nga një të rrituri (pedofilia)
- Parandalimi, denoncimi dhe ndihma me përkrahje gjatë trajtimit të fëmijës viktimë dhe fëmijës që ka kryer dhunë digjitale

## 5.2. Hulumtimi i realizuar

Për shkak të rëndësisë së qëndrimeve adekuate, aksioneve dhe interaksioneve nëpërmjet internetit, për

36 Дигитално насиље – превенција и реаговање Издавачи: Министарство просвете, науке и технолошког развоја Републике Србије и Педагошко друштво Србије Ауторке: Добринка Кузмановић, Биљана Лајовић, Смиљана Грујић и Гордана Меденица, Штампа: Цицero, Београд, 2016

37 ibid

shkak të numrit të madh të nxënësve që kanë mësuar nga distanca gjatë pandemisë COVID-19, është realizuar një hulumtim me mbi 2.500 shkollarë të mesëm në SHBA (nga 12 deri në 17 vjeç)<sup>38</sup>.

Është vlerësuar sjellja e tyre e bazuar ndaj 12 aspekteve në vijim (të renditura sipas lartësisë së përqindjeve të marra nga përgjigjet e dhëna):

1	Gjithmonë mbaj llogari që rastësisht të mos lëndoje ndjenjat e dikujt me ndonjë publikim në Internet	71.1
2	Mbjaj llogari për reputacionin tim digjital dhe sigurohem që çdo vendim të ketë efekt pozitiv ndaj meje	64.1
3	Përpiqem që të mbrojë miqt e mi kur do të shoh se i maltretojnë në internet	60.4
4	Përpiqem që të mbrojë edhe personat që nuk i kam në rrethin e miqve kur do të shoh se i maltretojnë në internet	51
5	Njerëzit shpeshherë gabimisht i kuptojnë tekstet ose publikimet e mia në mediumet sociale	30.9
6	E humbi arsyen kur jam në internet	30.6
7	Më vjen shumë keq për disa punë që i kam publikuar në internet	26.2
8	Kam incizuar/shkarkuar përmbajtje digjitale (filma, softuere, libra etj) falas, edhe pse teknikisht është dashur që të paguaj për to	23.4
9	Ka pasur raste kur kam bërë shaka në llogari të huaj (ose kam tentuar që qëllimisht të nervozoj ose frustrtoj) dikë në internet	16
10	Kam parashtruar punime shkollore (ese ose përgjigje të testeve) që i kam gjetur dhe kopjuar nga internet kur atë ndoshta nuk është dashur që ta bëj	13
11	Jam shtirur se jam dikush tjetër në internet	9.1
12	Kam shfrytëzuar fjalëkalimin e huaj për kyçe në llogarinë e tyre pa e ditur	9

Hulumtimi i qëndrimeve të shkollarëve të mesëm ndihmon që të kuptohet prevalenca e disa sjelljeve digjitale, në lidhje me qytetarinë e të rinjve në kohën e fundit dhe që mund të shërbejë si pikë referuese për çfarëdo studimesh që dalin në të ardhmen e afërt me të dhënat për COVID-19.

Interneti e ka ndryshuar fëmijërinë e miliona fëmijëve. Fëmijët e sotëm e shfrytëzojnë internetin dhe pajisjet digjitale nga mosha më e hershme, ndërsa koha e kaluar në internet është rritur sipas moshës së fëmijëve.

Interneti e formëson përditshmërinë e fëmijëve, aktivitetet e tyre, mënyrën se si e kalojnë kohën, komunikimin, lojën, shoqërimin me moshatarët, mësimin dhe fitimin e përvojave të reja. Nëpërmjet shfrytëzimit të rrjeteve sociale fëmijët kanë mundësi që të krijojnë profile të tyre, të prezantojnë vetveten dhe intereset e tyre, qëndrimet e tyre, të mbajnë kontakte me moshatarët nga e tërë bota dhe të marrin pjesë në rrjetin e gjatë të interaksionit. Shërbimet e internetit për komunikim dhe ndërtim të identitetit virtual të fëmijët, janë bërë pjesë e rëndësishme e rritjes së tyre.

Sic edhe u theksua paraprakisht, internet sjell edhe rreziqe dhe mundësi për paraqitjen e dhunës në këtë hapësirë virtuale. Për dhunën ndaj fëmijëve në ambientin digjital, është e domosdoshme që të shfrytëzohet ndonjë pajisje digjitale, respektivisht telefon i mençur, kompjuter, tablet me qasje në internet. Për dallim nga

38 <https://cyberbullying.org/digital-citizenship-research>

Llojet tradicionale të dhunës ku ekziston komunikim direkt ndërmjet dhunuesit dhe viktimës, dhuna digjitale karakterizohet me anonimitet, edhe pse sipërfaqësisht por që e inkurajon dhunuesin, ndërsa e demoralizon dhe frikëson viktimën.

### 5.3. Parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna digjitale ndërmjet nxënësve në shkollë dhe jashtë saj

Parandalimi i dhunës digjitale duhet të zbatohet në të gjitha nivelet nga individ, prindërit respektivisht kujdestari dhe familja, shkollat, kompanitë e telekomunikimit, institucionet shtetërore dhe të gjithë sektorët tjerë si policia dhe sistemi i mbrojtjes sociale.

Shkolla gjithmonë lidhet me mbrojtjen primare të fëmijëve nga llojet e ndryshme të dhunës, keqpërdorimit dhe neglizhimit, në mesin e të cilëve edhe nga dhuna digjitale. Parandalimi nga dhuna në shkolla nënkupton një përmbledhje të aktiviteteve dhe masave që kanë për qëllim krijimin e një ambienti të sigurt dhe stimulues, ruajtjen e bashkëpunimit, respektimit, komunikimit konstruktiv dhe pozitiv në të cilën nuk ka vend për dhunë. Nëpër shkolla mund të veprohet në pjesën më të madhe të fëmijëve, ndërsa shkollat janë vende për të fituar njohuri, shkathtësi dhe zhvillimin e kompetencave. Në këtë kuptim shkollat në pjesën e parandalimit të dhunës digjitale kanë rol kyç në:

- Zhvillimin e arsimit digjital të fëmijët, me qëllim të avancimit të njohurive dhe shkathtësive të tyre për zbatimin e masave teknike për mbrojtje dhe siguri si dhe të zhvillohet vetëdija për rreziqet, por edhe potencialet nga aplikimi i teknologjisë digjitale;
- Zhvillimin e shkathtësive sociale, respektivisht shkathtësive për komunikim jo të dhunshëm në ambientin real dhe atë virtual.
- Përkrahjen dhe zhvillimin e klimës pozitive shkollore të mostolerancës të çfarëdo lloji dhune, përfshirë edhe atë digjitale.

Arsimi digjital dhe kompetencat digjitale janë shkathtësi kyçe në këtë kohë të teknologjisë së zhvilluar kulmore dhe të domosdoshme në realizimin e përditshëm të aktiviteteve profesionale dhe atyre të përditshme. Arsimi digjital nënkupton zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive teknike dhe informatike, përfshirjen e shfrytëzimit kritik të informative, shfrytëzimit të tyre të sigurt dhe zgjidhjen e problemeve në ambientin digjital.

Fëmijët nuk mund të arsimohen digjitalisht nëse nuk kanë përkrahje nga arsimimi formal. Në shumicën e vendeve evropiane arsimimi digjital është i integruar në planprogramin arsimor të shkollave filllore dhe të mesme, ndërsa konsiderohet se kompetenca digjitale mundëson që të fitohen edhe njohuri dhe kompetenca të tjera si ato gjuhësoret, matematikoret, të shprehurit kulturor.

Në Ligjin tonë për arsimin fillor (G. zyrtare nr.161/19) në qëllimet e arsimit fillor, neni 7 parasheh, mes të tjerash, edhe arritjen e standardeve nacionale për nxënësit gjatë arsimit fillor në fushën e arsimit digjital. Ndërsa në pjesën e planifikimit të punës së shkollës filllore në nenin 49 paragrafi 5, është paraparë që në kuadër të programit vjetor për punë të planifikohet edhe promovimi i mirëqenies së nxënësve, mbrojtjes nga dhuna dhe keqpërdorimi dhe anashkalimi.

Në mënyrë që të veprohet në mënyrë parandaluese duhet të punohet fillimisht me të rriturit, respektivisht mësimdhënësit dhe nxënësit e pastaj me fëmijët.

Nuk guxon që të lejohet që fëmijët të jenë më superiorë në njohuritë në raport me mësimdhënësit sepse të rriturit duhet të marrin përgjegjësinë për t'u njoftuar me këtë problem shoqëror e më pas t'i mësojnë fëmijët, t'u ndihmojnë dhe t'i përkrahin.

Nëpër shkolla, veçanërisht në ato me numër më të madh të nxënësve, nevojitet që të ekzistojë një **Ekip**

**për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna**, i cili do të përkujdeset për sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha llojet e dhunës, që nënkupton edhe atë digjitale. Ekipin duhet ta përbëjnë drejtori me bashkëpunorët profesionalë (pedagogun, psikologun, defektologun, punëtorin social) mësimdhënësit klasor, si dhe mësimdhënës nga lënda adekuate. Është mirë që këta të jenë profesionist që dëshirojnë dhe kanë afinitet dhe interes për të punuar në këtë problematikë.

Gjithsesi se ky ekip duhet të bashkëpunojë edhe me të punësuarit e tjerë në shkollë, me prindërit, nxënësit dhe bashkësinë lokale. Gjatë ndryshimit të anëtarëve në ekip, nevojitet që gjithmonë të mbeten anëtarë nga përbërja e kaluar për shkak të vazhdimësisë së punës dhe përvojave pozitive paraprake. Shërbimi pedagogjik i cili është pjesë e ekipit nevojitet që të përfshihet në aktivitete specifike të cilat mund të imponohen, e që janë adekuate me komeptencat e tyre profesionale.

Pedagogu nevojitet që të organizojë dhe udhëheq punëtoritë edukative për dhunën digjitale ndërmjet moshatarëve, psikologji të punojë me fëmijët që kanë përjetuar dhunë dhe me fëmijët që kanë kryer dhunën. Varësisht nga problemi, në punë mund të angazhohet edhe edukator special ose bashkëpunor i jashtëm (përfaqësues nga qendra për punë sociale, përfaqësues i policisë, punëtor shëndetësor etj.). Të gjithë mësimdhënësit dhe personeli ndihmës teknik në shkollë duhet të njoftohen me rolet dhe përgjegjësitë e secilit anëtar të ekipit dhe procedurat dhe hapat gjatë rasteve të dhunës.

Në përgjithësi, të gjitha aktivitetet duhet të çojnë drejt ngritjes së nivelit dhe vetëdijes dhe ndjeshmërisë të nxënësit, prindërit dhe të gjithë të punësuarit për njohjen e dhunës, keqpërdorimit dhe neglizhimit, e veçanërisht dhunës digjitale.

## Test për mësimdhënësit

Propozimet e mësimdhënësve për Ekipin për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në sferën e dhunës digjitale:

Përshkrimi i problemit	Aktivitetet parandaluese për uljen ose tejkalimin e problemit

Diskutoni me kolegët tuaj për problemet që paraqiten.

Diskutoni me kolegët tuaj për aktivitetet parandaluese për tejkalimin e problemeve.

### 5.3.1. Programi për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna

Nuk ekziston program i përgjithshëm për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna që mund të zbatohet për të gjitha shkollat. Ajo përpilohet në bazë të njohurive që shkolla i merr nëpërmjet vetëvlerësimit. Programi për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna duhet të përmbajë si vijon:

- Parimet themelore në pajtim me Konventën për të drejtat e fëmijës, që janë edhe kornizi e veprimit. Ato janë: e drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit, interesi më i mirë i fëmijës, mosdiskriminimi dhe barazia, pjesëmarrja më e madhe e fëmijëve;
- Harmonizimi i akteve ekzistuese nënligjore;
- Definimi i lloheve më të shpeshta të dhunës në shkollë – fizike, psikike, sociale, seksuale, me theks të veçantë të dhunës digjitale;
- Aktivitete parandaluese – krijimi i një ambienti të sigurt për jetesë dhe punë me nxënësit. Gjithcka që duhet të bëjë shkolla është që të pengohet dhe të zvogëlohet dhuna digjitale dhe të përcjellen efektet e parandalimit;
- Masat e intervenimit – çfarë ndërmerret kur ndodh dhuna digjitale, cilat procedura shfrytëzohen, si janë të ndara rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë anëtarëve të shkollës.

Pjesë e aktiviteteve të ekipit për mbrojtjen nga dhuna janë të përgjithshme dhe të zbatueshme në të gjitha shkollat, por pjesë e aktiviteteve mund të jenë më specifike dhe karakteristike në kontekst lokal. Në vazhdim, kemi listën e aktiviteteve potenciale në shkolla, në drejtim të mbrojtjes së nxënësve nga dhuna në botë digjitale:

- Programi për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, që është pjesë përbërëse e Programit vjetor të punës së shkollës
  - ◊ Në program, theks të veçantë vihet në dhunën digjitale dhe mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve;
  - ◊ Propozimet në program mund të jepen nga ana e prindërve, mësimitdhënësve dhe të punësuarve të tjerë në institucion, por edhe fëmijët të marrin pjesë në ide. Në realizimin e aktiviteteve mund të marrin pjesë të gjithë propozuesit;
- Definimi i rregullave për përdorimin e internetit dhe pajisjeve (kompjuterë, tablet, telefona celularë...) në shkollë dhe të njëjtët të potencohen në vende të dukshme në shkollë që të shihen nga të gjithë mësimitdhënësit dhe nxënësit;
- Mbrojtjen e evidencës për dhunën në shkollë dhe përpilimit të një raporti për realizimin e masave të zbatuara për mbrojtje, që është pjesë përbërëse e Raportit vjetor për punën në shkollë;
- Organizimi dhe pjesëmarrja në realizimin e përsosjes profesionale të të punësuarve në sferën e parandalimit të dhunës digjitale.
- Zbatimit të trajnimeve të fëmijëve për komunikim jo të dhunshëm dhe ndërmjetësim ndërmjet moshatarëve, bullingun dhe pasojat, dhunës elektronike, dhunës familjare, dhunës në lidhje etj.;
- Organizimi i bisedave, tribunave, shfaqjeve, ekspozitave për temën, por edhe në bashkëpunim me ekipet për mbrojtjen e fëmijëve nga shkollat e të tjera në komunë, për të shkëmbyer përvojat e fëmijëve dhe mësimitdhënësve;
- Bashkëpunimi me prindërit nëpërmjet Këshillit të prindërve dhe bashkëpunimit me personat e tjerë profesional nga institucionet relevante të bashkësisë lokale me qëllim të një mbrojtjeje gjithëpërfshirëse të fëmijëve nga dhuna (Ndiheja e shpejtë, institucione të tjera shëndetësore, qendrave për punë sociale, Kryqit të Kuq, organizatave civile lokale, policisë, komunës etj.)
- Dënimi i rregullave të sjelljes si dhe përpilimi i një Kodi të sjelljes së nxënësve në botën digjitale dhe pasojat nga mosrespektimi i rregullave (shqiptimi i masave pedagogjike, përgjegjësisë shoqërore etj.);
- Organizimi i kujdestarive për mësimitdhënësit dhe personelit ndihmës teknik në shkollë;
- Aktivitete të tjera parandaluese që mund të ndërmerret nga ana e ekipit të shkollës;
- Rregullimi i një pjese të veçantë në ueb-faqen e shkollës me përmbajtje për sigurinë e internetit, teksteve, propozimeve, bisedave;

- Përpilimi i panove shkollore me fotografi dhe tekste për sigurinë digjitale të nxënësve;
- Përpilimi i posterëve nga nxënësit ose marrjen e materialeve të gatshme për muret shkollore;
- Bisedë me nxënësit për dhunën digjitale, zhvillimin e debateve, shkëmbimit të përvojave, përcjelljen e filmave ose spoteve me atë tematikë;
- Organizimi i trajnimeve nga shtëpitë informatike për avancimin e shkathtësive digjitale dhe njohurive informatike të nxënësit;
- Organizimi i trajnimeve të nxënësve/moshatarëve ku nxënësit nga klasët/vitet më të moshuara do t'ju mbajnë trajnime atyre më të vegjëlvë;
- Mbajtja e punëtorive preventive për nxënësit dhe mësimeve nga ana e policisë, qendrës për punë sociale etj.
- Organizimi i kuizeve në nivel të shkollave ose në nivel të klasave/viteve me pjesëmarrjen e nxënësve, mësimeve dhe prindërve, nëpërmjet kontrollit të shkathtësive dhe njohurive digjitale të nxënësve por edhe për sigurinë në botën digjitale;
- Shënimi i ditës botërore për sigurinë në internet ose ditën e mësimit digjital (Safer Internet day – SID – 11 shkurt).

Parandalimi nga dhuna digjitale është i suksesshëm nëse nxënësit mësohen:

- Të jenë të vetëdijshëm për dhunën digjitale;
- Të mos jenë monitorues pasiv të dhunës digjitale dhe të heshtin. Nevojitet që të njëjtën ta paraqesin dhe të reagojnë;
- Të ndihmohen ndërmjet vete për t'u gjindur më mirë në internet, të jenë solidar, sepse ashtu do ta rrisin edhe sigurinë personale, ndërsa internet do të bëhet vend më i mirë për ta shfrytëzuar;
- Të ndërmarrin përgjegjësi për hapat e veta, të sillen denjësisht dhe të tregojnë vlera të caktuara;
- Të dijnë se kujt ti drejtohen nëse sulmohen, ofendohen, ose shqetësohen në aspekt digjital
- Të inkurajohen për të biseduar me mësimeve, prindërit ose personat e tjerë të rritur lidhur me të gjitha dilemat rreth përbajtjeve të internetit, e veçanërisht dhunës digjitale;
- Shfrytëzimi i internetit të jetë i arsyeshëm, respektivisht të mos shpenzohet kohë e tepërt në telefon ose kompjuter, ekzistojnë edhe mënyra të tjera për të kaluar kohën e lirë.

#### PARANDALIMI ËSHTË PRIORITET!

- √ Parandalimi i dhunës digjitale nëpër shkolla paraqet përmbledhje të masave dhe aktiviteteve që kanë për qëllim krijimin e një ambienti të sigurt dhe të mbrojtur, të zhvillojnë dhe kultivojnë një atmosferë të bashkëpunimit, respektimit të dallimeve, komunikimit konstruktiv dhe përcjelljen e rregullave të caktuara të sjelljes në kuadër të aktiviteteve edukative-arsimore, zhvillimin e shkathtësive për njohjen dhe reagimin efikas në situata të dhunës.

## 5.4. Njohja dhe zbulimi i dhunës digjitale ndërmjet nxënësve ose dhunës së fëmijës nga një i moshuar (pedofil)

### 5.4.1. Nivelet e dhunës

Shkolla duhet të reagojë dhe intervenojë ndaj secilit lloj të dhunës ndaj fëmijëve pa marrë parasysh intensitetin dhe shpeshësinë e saj. Shkolla duhet të jetë vendi për zero tolerancë ndaj dhunës. Të gjitha llojet e dhunës, keqpërdorimit dhe neglizhimit të fëmijëve dhe dhunës digjitale mund të ndahen në tri nivele sipas peshës së dhunës.



Për të intervenuar më lehtë ekipi për mbrojtjen e dhunës në secilën shkollë, rekomandohet përkufizimi i tri niveleve të dhunës ndaj fëmijëve dhe në pajtim me këtë edhe të reagohet.

**Niveli i parë:** Situata të nivelit të parë janë format më të lehta të dhunës që ndodhin ndërmjet nxënësve, që i zgjidh vetë masimdhënësi/edukatori/kujdestari i klasës. Në pjesën e dhunës digjitale ato janë thirrje të kohëpaskohshme me telefon, SMS, MMS – porosi pse rrjete sociale;

**Nivel i dytë:** Situata më të komplikuar në të cilët mësime/edukatori/kujdestari i lasës nuk mund ta zgjidhë atë në mënyrë të pavarur dhe e paraqet për të kërkuar bashkëpunim me ekipin për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna. Ato janë format e keqpërdorimit të nxënësve nëpërmjet publikimeve, video klipeve, blogjeve, keqpërdorimit të forumeve dhe bisedave, incizimit me kamerë të skenave të dhunshme ose seksuale, distribuimit të incizimeve dhe fotografive, tregimit të materialit pornografik, tregimin e pjesëve intime të trupit ose lakuriqësisë;

**Niveli i tretë:** Situata ose gjendje të ndërlikuara që zgjasin më shumë dhe që domosdoshmërisht duhet që krahas ekipit të përfshihen edhe institucione të tjera për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna. Në këtë nivel bëjnë pjesë incizimi i skenave vulgare dhe të dhunshme, të cilat masovikisht distribuohen, shfaqja e materialit pornografik, joshjen e fëmijëve nga ana e të rriturve, detyrimin, keqpërdorimin e fuqisë, ofendimin, kërcënimin dhe detyrimin për akte seksuale, përdhunimin, sulm gjinor ndaj një fëmije që nuk ka mbushur 14 vjet, kënaqjen e epsheve gjinore para dikujt tjetër dhe vepra duke keqpërdorur pozitën. Në pjesë e tyre janë edhe vepra të rënda penale kundër lirisë morale të fëmijëve.


Në tabelat në vijim<sup>39</sup> janë prezantuar nivelet e reagimit, llojet dhe format e dhunës.

Varësisht nga intensiteti, shpeshësia dhe pasojat që i lë dhuna, forma të caktuara përsëriten në më shumë nivele të ndryshme.

39 Дигитално насиље – превенција и реаговање, Министарство просвете, науке и технолошког развоја Републике Србије и Педагошко друштво Србије, Београд, 2016

	Dhuna digjitale	Dhuna seksuale
<b>1 NIVELI</b>	Dërgimi i porosive shqetësuese (SMS, MMS)	Fjalosja dhe sharja, përhapja e tregimeve të rrejshme me përmbajtje seksuale, etiketime, gjestikulacione të pahamendshme seksuale
	Aktivitete ndërmerr mësimsdhënësi/kujdestari i klasës në bashkëpunim me prindin/kujdestarin, punë edukative me grupe nxënësisht ose punë individuale	
<b>2 NIVELI</b>	Incizimi, dërgimi i video incizimeve, keqpërdorimi i formumeve, blogeve, bisedave në çat, incizimin kundër vullnetit të personit, incizimin e skenave të dhunshme, distribucionin e incizimeve dhe fotografive.	Prekje seksuale, tregimin e materialit pornografik, lakuriqësisë dhe tregimit të pjesëve intime të trupit.
	Aktivitete ndërmerr mësimsdhënësi/kujdestari i klasës me shërbimin pedagogjik, ekipin për mbrojtje nga dhuna së bashku me prindërit e informuar me qëllim të rritjes së punës edukative me nxënësit ose nëse nuk ka efekt shqiptimi i masave pedagogjike, si dhe informimit të Qendrës për punë sociale.	
<b>3 NIVELI</b>	Incizimi i skenave të dhunshme, distribucioni i incizimeve dhe fotografive, pornografisë së fëmijëve.	Vërbimi i fëmijëve nga ana e personave të rritur, keqpërdorimi i pozitës, nxitja, detyrimi në akte seksuale, përdhunime, incest.
	Aktivitete ndërmerr drejtori i shkollës me Ekipin për mbrojtje nga dhuna, me informim të prindërve dhe shërbimeve kompetente si policisë, QPS, shëndetësisë etj. Nëse burimi i keqpërdorimit është prindi ai nuk informohet por vetëm se policia ndërmerr aktivitetet. Në këtë nivel është e detyrueshme puna edukative me nxënësit, inicimin e masave pedagogjike, përfshirjen e shërbimeve dhe organeve të tjera, bashkëpunimi me sektorin civil, trajnimeve, edukimeve...	

Për vlerësimin e niveleve të dhunës ndaj fëmijëve duhet të merren parasysh këta faktorë:<sup>40</sup>



40 Дигитално насиље – превенција и реаговање, Министарство просвете, науке и технолошког развоја Републике Србије и Педагошко друштво Србије, Београд, 2016

## Test për mesimdhënësit

### Si të veproj në rast se...???

Problemi	Si të veproj
1. Nxënës (14 vjeç) ka shkruar disa sms porosi ofenduese deri te një nxënës i të njëjtës moshë. E ka ofenduar pamjen e tij të jashtme dhe rritjen e vogël duke përdorur fjalë fyese.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vetë do ta zgjidhi problemin (mësimdhënës/edukator/kujdestar i klasës)</li> <li>2. Vetë do ta zgjidhi problemin (mësimdhënës/edukator/kujdestar i klasës) me përfshirjen e fëmijës dhe prindit/kujdestarit</li> <li>3. Do ta paraqesë te Ekipi për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna</li> <li>4. Së bashku me Ekipin për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna do ta paraqesim në polici dhe qendrën për punë sociale, e sipas nevojës do të përfshijmë edhe institucione shëndetësore</li> </ol>
2. Nxënës i moshës 13 vjeçare në FB profilin e tij ka shkruar përmbajtje ofenduese për një shoqe klase, me çka e ka etiketuar, e ka krahasuar me të tjerët dhe e ofendon zgjedhjen e saj të veshjes. Këtë postim e kanë parë "të gjithë" shokët e tyre.	(Të njëjtat opsione për veprim vlejné për të gjitha rastet)
3. Në FB profil të një nxënëse 11 vjeçare, është vendosur një grup me emrin. Shtyp lajk nëse e urren Tean". Grupi për tri ditë ka 200 lajka.	
4. Prindërit e një nxënësi 10 vjeçar ju informojnë se fotografia e birit të tyre nga pushimet verore është vendosur në një sajt për shkëmbimin e fotografive të një grupi pedofilësh	
5. Nxënësi ju paraqet se para tri ditëve një shok i tij ka publikuar në Viber grupin e ekipit futbolistik të shkollës se është i marrë, sepse e ka huqur golin. Në viber grupin në të cilin është edhe një koleg i juaj, profesori i edukatës fizike, aty nxënësi merr ofendime nga fëmijët e tjerë.	
6. Një grup i prindërve ju informojnë se një nxënës ju ka thënë nxënësve të tjerë se viziton një sajt me përmbajtje pornografike dhe ju sqaron atë që ka parë.	
7. Nxënës i klasës së 7-të ka incizuar një video klip na vajzat në garderobë ku ato ndërrohen. Incizimi është paraqitur edhe në rrjetin YouTube. Për këtë ju informon edhe ekipi për mbrojtjen në shkollë.	
8. Një nxënëse 13 vjeçare gjatë dy muajve të fundit ka ndryshuar sjelljen, e ka ulur suksesin, mungon në mësim, vishet ndryshe, është dobësuar dhe nuk shoqërohet me shoqet.	

### 5.4.2. Profili i fëmijëve viktime – shenjat e dhunës digjitale

Identifikimi i ekzistimit të dhunës digjitale ndaj fëmijëve, respektivisht njohja e tyre është hapi i parë për mbrojtjen e tyre.

Fëmijët më të vegjël nuk kanë kapacitete mjaft të zhvilluara kognitive dhe emocionale të kuptojnë ato përmbajtje, por do t'i perceptojnë si të dhunshme, do të shqetësohen dhe hutohen dhe do të mbesin pasoja në zhvillimin e tyre psikik. Adoleshentët ndonjëherë janë të motivuar që të shikojnë përmbajtje më eksplicite nga kurioziteti, sepse janë në periudhën e pjekjes dhe ku zgjohet seksualiteti i tyre. Por duke ndërhyrë më thellë në këto përmbajtje mund të bëhen cak i dhunuesit dhe të paraqitet ndjenja e vetmisë në këtë problem, shqetësimi, frikës nga pasojat negative, si do të sqarohen të moshuarit nëse ju është ndaluar shfrytëzimi i internetit etj.

Nxënës që më së shpeshti janë të ekspozuar ndaj dhunës digjitale në shkollë janë:

- fëmijë me vetëbesim dhe vetërespekt të dobët, që vërehet edhe fizikisht (janë tepër të dobët ose tepër të mëdhenj, të ulët etj.) Më së shpeshti janë pasiv, të frikësuar, të turpshëm, të qetë dhe anksioz, emocionalisht tejet të ndjeshëm, lehtë qajnë dhe tërhiqen;
- fëmijë që janë të talentuar, kanë ndonjë talent dhe dhunti me të cilët edhe dallohen nga fëmijët e tjerë;
- fëmijë me pengesa në zhvillim që dallohen nga zhçillimi tipik;
- fëmijë nga grupe të ndryshme etnike, religjioze ose sociale, veçanërisht fëmijë të prekshëm nga familje më të varfra;
- fëmijë të sapoardhur në klasë/shkollë.

Këta fëmijë zakonisht nuk dijnë se si të kthejnë goditjen dhe tërhiqen nëse dikush i sulmon. Ata nuk janë agresivë, por nëse një periudhë më të gjatë ekspozohen në dhunë, mbeten të hutuar dhe mund të kundërveprojnë.

Edhe pse ka dallime individuale në mënyrën e reagimit, ekzistojnë shenja të caktuara që dallohen nga sjellja e zakonshme e fëmijëve në bazë të së cilës mund të konkludohet se fëmijët hasin në dhunë digjitale.

Njëherë, shenjat janë edhe pasoja nga dhuna e duruar, ato janë:

- Tregojnë shqetësim gjatë ose pas shfrytëzimit të internetit;
- Papritmas ndryshojnë shprehitë e tyre të shfrytëzimit të pajisjeve digjitale, bëhen më të kujdesshëm, ndërmarrin masa për mbrojtje etj;
- Fshihen, shpejt ndryshojnë faqen që e shfletojnë kur ju afrohet ndonjë i rritur, e fshehin monitorin, e fshijnë historinë e kërkimeve;
- Veprojnë të hutuar, pa disponim, të pasigurt, shmangin shoqërimet me moshatarët;
- Nuk kanë motivim për mësim, kanë probleme me koncentrimin dhe e ulin suksesin shkollor;
- Nëse shkollën e ndjejnë si vend të pasigurt, ata e lëshojnë edhe mësimin;
- Mund të përdorin alkool ose drogë;
- Mund të paraqiten simptoma psikosomatik (kokëdhëmbje, mundime në stomak, ankthe, mendime vetëvrasëse etj.).

Pa marrë parasysh që dhuna ndodh në botën digjitale, pasojat nga e njëjta janë të pranishme në botën dhe ambientin real.

Ato mund të jenë të ndryshme, e në disa raste edhe shumë serioze.

Edhe pse nuk ka lëndim direkt fizik, prapë se prap pasojat për shëndetin mental i fëmijëve janë të mëdha, e që reflektohen nëpërmjet funksionimit social dhe sjelljes që mund të jetë shumë destruktive.

Hulumtimi i realizuar në Serbi në vitin 2013 ka treguar se dhunë digjitale kanë përjetuar 37% e nxënësve të shkollës fillore dhe 66% të shkollës së mesme<sup>41</sup>.

Në hulumtimin e realizuar në Holandë<sup>42</sup> të fëmijët e moshës prej 11 deri 12 vjeçare i kanë hulumtuar streset e përfitshme dhe strategjitë për ballafaqim me dhunën digjitale, si dhe ndikimin e tyre ndaj depresionit

41 Дигитално насиље – превенција и реаговање Издавачи: Министарство просвете, науке и технолошког развоја Републике Србије и Педагошко друштво Србије Ауторке: Добринка Кузмановић, Биљана Лајовић, Смиљана Грујић и Гордана Меденица, Штамп: Цицера, Београд, 2016

42 Völlink, T., Bolman, C., Dehue, F., & Jacobs, N. (2013). Coping with cyberbullying: differences between victims, bully-victims and children not involved in bullying. *Journal of Community and Applied Social Psychology*, 23, 7-24

dhe mirëqenies digjitale (well-being) të viktimës së dhunës digjitale. Në hulumtim përmendet model i Lazarusit të strategjive të ballafaqimit. Lazarusi dallon dy strategji themelore të ballafaqimit: ballafaqim i orientuar drejt problemit (problem focused coping) dhe ballafaqim i drejtuar drejt emocioneve (emotion focused coping).

Gjatë hulumtimit autorët kanë hasur në njohuri se fëmijët që kanë qenë viktimë të dhunës, dhunën digjitale e shohin si situatë të përshtatshme ndaj ndryshimeve dhe zbatojnë strategji të orientuara drejt problemit dhe për këtë do të kërkojnë ndihmë nga të tjerët. Fëmijët që kanë përjetuar dhunë digjitale, në të nuk shohin si në situatë të ndryshueshme. Shpeshherë ndiejnë se nuk kanë zgjidhje tjetër përveç që të pranojnë situatën, që rezulton me zbatimin e ballafaqimit të orientuar kah emocionet që shihet nëpërmjet shmangies së kërkimit të ndihmës, zemërimit, frustrimit, pafuqisë dhe mërzi.

Grupi i parë që zbaton ballafaqimin e orientuar drejt problemit kërkojnë zgjidhje dhe ndihmë, por nëse zgjatë më tepër ajo gjendje dhe nuk e marrin përkrahjen, kalojnë në strategjinë e orientuar drejt ballafaqimit të emocioneve.

Sa më shpesh që fëmijët hasin dhunë digjitale ndaj së cilës nuk ka reagim dhe intervenim, do të shmangen drejt strategjisë së dytë.

Nëse merret parasysh se ekziston kontinuitet të stresuesve dhe dhunës "online" dhe offline, autorët deklarojnë se çdo përjetim i dhunës i rrit gjasat për shfrytëzimin e strategjisë ballafaqimit ndaj emocioneve. Për këtë përkrahja dhe mbrojtja nga dhuna digjitale patjetër duhet të jetë e pranishme edhe në ambientin fizik edhe në atë digjital.

Për atë se sa janë të rëndësishme masat preventive aq janë edhe masat intervenuese, që duhet të zbatohen në më shumë nivele.

Ajo nënkupton reagim nga ana e prindërve, respektivisht familjes, shkollës, bashkëmoshatarëve që mund të jenë dëshmitarë të dhunës. Zbulimi në kohë dhe i dhunës digjitale e zvogëlon dëmin e mundshëm dhe mundësinë e përsëritjes.

### 5.4.3. Si të reagojë mësuesi / bashkëpunëtori profesional dhe si të bisedojë me nxënësit që janë viktimë të dhunës digjitale

Në përgjithësi nxënësit kanë besim te mësuesi, që e njohin dhe janë çdo ditë me të, andaj shumë është e rëndësishme se në cilën mënyrë do të qasen ndaj fëmijës nëse hasin në shenja të shqetësimit dhe dyshimit. Biseda me nxënësin në shkollë është përparësi sepse fëmija nuk do të "viktimizohet" në hapësirat zyrtare të p.sh policisë, me persona të panjohur, por në ambientin që është mësuar dhe që është më i përshtatshëm ndaj moshës së tij.

Kur mësuesi do të zbulojë se nxënësi është viktimë e dhunës digjitale nga moshatarët ose pedofilisë, shpeshherë nuk dijnë se si të reagojnë, të veprojnë ose të bisedojnë me nxënësin lidhur me atë problem. Ndonjëherë mund ta dërgojnë edhe te punëtorët profesional që ndoshta edhe kanë përvojë të mjaftueshme se si të bisedojnë me fëmijën, si të hapet ai duke ndjerë edhe përkrahjen.

Para së gjithash është e rëndësishme që të sigurohet atmosfera e besimit të ndërsjellë e mësuesit ose një punëtor tjetër profesional të shkollës dhe nxënësit. Gjatë intervistës me nxënësin, patjetër duhet ta kemi parasysh ndjeshmërinë e fëmijës nga ngjarja që i ka ndodhur. Por, ekziston edhe mundësia që nxënësi ta ndryshojë deklaratën e vet për shkak të reagimit të mësuesit i cili mund t'i manifestojë ato edhe pa vetëdije (verbale ose joverbale) nga ajo që mund ta dëgjojë nga nxënësi. Më së miri është që të mbahet qëndrimi neutral, pavarësisht nga ajo që fëmija e deklaron.

Zbulimi është proces i tërë e jo ngjarje. Nxënësi në bazë të reagimit të njerëzve të cilëve ua kumton ngjarjen do të zbulojë edhe të tjera detaje. Gjithsesi, e tërë kjo varet nga moshë e fëmijës. Fëmijëve më të vegjël të mësimit klasor është e panevojshme që në atë moshë t'u sqarohen sanskionet që i parashah liogjtit, por duhet të theksohen shembuj konkretë të sjelljes për të cilat mendohet ose mësuesi do të përmendë

disa ngjarje të ngjashme që kanë përfunduar me rezultat pozitiv. Në këtë drejtim mësimitdhënësi patjetër duhet të përmendë se masat e ndërmarra kanë për qëllim pengimin e dhunës në mënyrë që nxënësi të ndihet i sigurt dhe i mbrojtur. Gjithmonë duhet që nëpërmjet bisedës të theksohet raporti mbrojtës i mësimitdhënësit dhe se qëllimi është të pengohet dhuna.

Nxënësit duhet t'i lejohej që ta tregojnë ngjarjen sipas mënyrës së tij. Në vazhdim të bisedës me nxënësin, nëse është më i vogël në moshë, mund të shfrytëzohen mjete ndihmëse (kukulla, vizatime etj.) në pajtim me moshën e fëmijës, rrethanat e keqpërdorimit dhe përvoja e mësimitdhënësit/punëtorit profesional.

Mjetet ndihmëse shfrytëzohen për stimulimin e nxënësit që të tregojë se çfarë ka ndodhur dhe drejtpërdrejt të përgjigjet në disa pyetje.

Fëmijët e vegjël ndonjëherë ndodh që dhunën e tregojnë nëpërmjet lojës, simulimit ose bisedës së drejtpërdrejt në temë tjetër. Gjatë realizimit të bisedës me fëmijën asnjëherë nuk duhet që ai të detyrohet të tregojë më tepër për të mbledhur më shumë indikatorë ose të kërkohet përshkrim i detajuar i ngjarjes, sepse mbledhja e argumenteve konkrete është pjesë edhe e institucioneve të tjera. Nxënësi në atë moment ka nevojë për dikë që ta dëgjojë, kuptojë dhe inkurajojë për të shprehur ndjenjat e tij.

Mësimitdhënësi asnjëherë nuk guxon ta sulmojë personin që e kryen dhunën nëpërmjet të shprehurit e qëndrimeve personale, të gjykojë ose të shprehë zemërim, sepse nxënësi atë do ta njohë si sulm të personalitetit që ndoshta e do ose ka lidhje miqësore, pa dallim që është i dhunshëm. Kur nxënësi do t'i besojë ndokujt dhe do të shprehë ndjenjat e tij, ai ndihet më lehtë, por përsëri është i prekshëm. Për këtë është me rëndësi që të informohet se çfarë hapa do të merren në të ardhmen, e që ai informacion të jepet në mënyrë adekuate me moshën e tij. Nxënësi duhet që të informohet konkretisht se kush do të njoftohet për t'u bindur se për atë ngjarje do ta dinë vetëm disa persona të caktuar.

Duke marrë parasysh besueshmërinë e të dhënave, mësimitdhënësi/punëtori profesional që i ka marrë informatat, patjetër duhet të jetë i denjë ndaj premtimeve dhe fjalëve të tij ndaj nxënësit. Nxënësit nuk i hyn në ndihmë nëse është i etiketuar nëpër korridore dhe të gjithë e pyesin për situatën edhe atë si "me qëllim të mirë". Nëse nxënësi nuk është i sigurt se biseda do të jetë në dobinë dhe mbrojtjen e tij, respektivisht "prononcimet" e tij do t'i përjetojë si një tregim pa ndërmarrë veprime konkrete, atëherë ai mund të përjetojë traumë shtesë dhe në të ardhmen asnjëherë nuk do të flasë për dhunën.

## ME RËNDËSI

Si duhet të reagojë mësimitdhënësit/punëtori profesional në rast se nxënësi i beson:

- √ gjeni një vend të qetë për të biseduar;
- √ kini mirëkuptim të plotë;
- √ tregoni se dëshironi që ta dëgjoni atë që ka për ta thënë;
- √ besoni;
- √ dëgjojeni deri në fund dhe mos e detyroni të flasë më shumë se sa që është e gatshme;
- √ nuk duhet të parashtroni shumë pyetje, por të jeni vetëm përkrahja e fëmijës;
- √ nxënësit mund të mos jetë i gatshëm që menjëherë të flasë për ngjarjet, dicka mund që edhe të mohojë, por ajo është alarm se duhet ta kontrolloni dhe përcjellni;
- √ nëse ndiheni të pasigurt dhe ju duhet ndihmë, drejtohuni deri te punëtori profesional i institucionit tuaj ose ekipit për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, që është i edukuar për këtë problematikë.

## 5.5. Parandalimi, denoncimi, ndihma dhe përkrahja në trajtimin e fëmijës viktimë dhe fëmijës që kryen dhunën digjitale

### 5.5.1. Veprimi me një nxënës viktimë të dhunës digjitale

Në situatë kur është zbuluar dhuna nga një i rritur ose kur nxënësit e zbulojnë vetë dhe i tregojnë ndokujt, është e domosdoshme që të ketë reagim të shpejtë për ndërprejen e dhunës dhe të kërkohet ndihmë.

Hapi i parë është që të sigurohet ambienti i sigurt për fëmijën e sulmuar, që ai të ndihet i sigurt dhe të krijohet një atmosferë e besimit dhe përkrahjes. Nëse mësimitdhënësi ose ndonjë person tjetër i moshuar në shkollë sheh shenja të dhunës digjitale të nxënësi ose nëse vetë nxënësi alarmon dhe kërkon ndihmë, duhet të ndërmerren këto hapa:

- Mos u kundërpërgjigjini me porosi të dhunshme, kërcënuese ose lloje të tjera, emaile ose thirrje telefonike ndaj profilit të dyshimt;
- Mos i fshini porositë ose fotografitë që mund t'u shërbejnë si argument;
- Kontaktoni policinë dhe paraqitne rastin e dhunës digjitale, sidomos nëse porositë përmbajnë pornografi të fëmijëve, kërcënime, kushtëzime, frikësime;
- Mund të kontaktohet dhe informohet edhe operatori i internetit nëse atë nuk e kryen detyrimisht policia.

Informatat që nxënësi ia ka dhënë mësimitdhënësit, edukatorit ose një personi tjetër të rritur të cilit ia ka zbuluar dhunën, duhet të jenë bazë për të paraqitur dhunën në polici ose qendër për punë sociale.

Përkrahja emocionale e nxënësit në periudhën e zbulimit të dhunës digjitale nënkupton:

- Të dëgjohet pa u akuzuar, të nxitet një komunikim i hapur dhe i besueshëm, pa frikë nga masat repressive, të inkurajohet që t'i ndihmohet të zhvillojë qëndrueshmëri në procesin e zgjidhjes së problemit.

Përkrahja arsimore nënkupton:

- Nxënësi të përkrahet në procesin e mësimin dhe të mirëkuptohet nga ana e mësimitdhënësve nëse ka stres dhe shqetësime të mëdha, të marrë ndihmë në tejkalimin e materialit mësimor ose qëndrimin në orë, të shfrytëzohen të gjitha resurset për ndihmë dhe përkrahje edhe nga grupet e moshatarëve.

Përkrahja sociale nënkupton:

- Përkrahja nga shoku i afërt, krjimi i grupit të moshatarëve për përkrahje, pranimin e fëmijës viktimë në grip me një ndjeshmëri të posaçme të traumës së përjetuar, biseda dhe komunikimi vetëm në mënyrë të cilën do ta zgjedhë vetë fëmija viktimë, të mos pyetet shumë dhe vazhdimisht të mos i përkujtohet problemi;
- Në fazën e mëvonshme, pas uljes së tensionit dhe përfundimit të rastit me dhunën digjitale, mund të hapet diskutim me nxënësit në klasë/shkollë, për të realizuar punëtori ose trajnime për temën.

Gjatë reagimit të përfaqësuesve të institucioneve nevojitet që të veprohet në pajtim me Ligjin për drejtësi të fëmijëve dhe Protokollit të përbashkët për veprim në rastet e neglizhimit dhe keqpërdorimit të fëmijëve.

Ky lloj dhune mund të fusë dilema të caktuara, pasiguri dhe të panjohura te personat profesionalë gjatë veprimit, sepse ende nuk kemi përvojë të madhe në këtë fushë. Por dhuna digjitale nuk është shumë më ndryshe se format tradicionale të dhunës ndaj fëmijëve, e që shpeshherë dhuna digjitale mund të sjellë deri te kontaktet fizike me dhunuesin dhe lëndimin e fëmijës.

Për këtë, veprimi është identik dhe në drejtim të intervenimit të shpejtë, mbrojtjes së fëmijës, vlerësimi të mirë të nevojave, rreziqeve dhe potencialeve të fëmijës dhe dhënien e përkrahjes së planifikuar psikosociale, e sipas nevojës edhe për mbrojtjen shëndetësore.

Gjatë kësaj duhet të respektohen parimet për mbrojtjen e fëmijës viktimë e veprës penale, respektivisht urgjencë në veprimin, një intervistë me shënim video-auditiv duke shmangur bisedat e shumta me fëmijën për të mbrojtur atë nga viktimizimi sekondar, pjesëmarrja e fëmijës dhe informimi i tij lidhur me të gjitha procedurat dhe bashkëpunimin e ndërsjellë duke i informuar edhe institucionet përkatëse. Të gjitha argumentet deri te të cilat mund të vijnë rastësisht personat profesionalë, si informata ose materiale, është me rëndësi që të dorëzohen te përfaqësuesi i qendrës për punë sociale, policia ose prokurori publik në kuadër të së cilëve ka departamente që merren me dhunën digjitale ndaj fëmijëve.

Intervenimi në shkollë për të zbuluar dhe kuptuar dhunën digjitale nënkupton reagimin adekuat të shërbimeve shkollore, para se gjithash ekipit për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në situatat kur ka dyshime ose kur ka ndodhur dhunë.

Është e domosdoshme që të intervenohet në kohë gjatë të gjitha formave të dhunës, por edhe të asaj digjitale në mënyrë që fëmijët të ndihen të sigurt në shkollë.

Qëllimi i intervenimit është të ndërpritet dhuna, të mundësohet siguria e fëmijës, të zvogëlohet rreziku nga përsëritja e dhunës dhe të zbuten ose largohen pasojat e dhunës.

Intervenimi përfshin si vijon:

- zbatimin e denjë të procedurave dhe hapave të përcaktuar në situatat e dhunës;
- bashkëpunimi me shërbimet relevante;
- evidentimi i rasteve të dhunës;
- analiza e llojeve dhe shpeshësisë së dhunës në shkollë;
- dhënia e përkrahjes së fëmijëve viktimë të dhunës digjitale;
- përkrahje psikosociale dhe punë me fëmijët që kryejnë dhunë digjitale;
- punë dhe përkrahje ndaj fëmijëve që janë viktima të dhunës dhe udhëzimet për bashkëpunim konstruktiv;
- punë këshilluese me prindërit e fëmijëve viktimë dhe fëmijëve që kryejnë dhunë digjitale.

Pjesa më e madhe e situatave të dhunës digjitale që ndodhin në shkollë ndërmjet fëmijëve duhet t'i zgjidhin të punësuarit e institucionit. Bëhet fjalë për situatë me rrezik më të vogël, respektivisht të nivelit të parë dhe të dytë të dhunës, sepse mësimdhënësit janë më kompetentë, më së miri i njohin nxënësit dhe vetë konteksti i situatës janë më së shpeshti të mjaftueshme që të sigurojnë zgjidhje konstruktive.

Rastet më të rënda të dhunës digjitale, të nivelit të tretë, respektivisht kur pasojat janë më serioze dhe kur ekziston rrezik nga përsëritja e dhunës, si dhe situatat kur ka dyshime se nxënësi ka qenë i ekspozuar ndaj dhunës digjitale, veçanërisht nga ana e një personi të moshuar, kërkojnë përfshirjen e institucioneve të sistemeve të tjera. Në rastet e këtylla ekipi për mbrojtje nga dhuna ka për detyrë që të bashkëpunojë me

institucionet e të tjera, të marrë pjesë në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve dhe ta përcjellë efektin e masave të ndërmarra. Mënyrat dhe format e bashkëpunimit e të gjitha këtyre sistemeve janë të definuara me Protokollin e përbashkët për veprim në rast të keqpërdorimit dhe neglizhimit të fëmijëve.

Pas zbulimit të rastit dhe pas të gjitha aktiviteteve të ndërmarra të policisë, qendrës për punë sociale dhe prokurorisë publike për mbrojtjen e fëmijës, ajo më së shpeshti mbetet në të njëjtin ambient, andaj në këtë drejtim shkolla në fazën e trajtimit paraqet një resurs të konsiderueshëm për ndihmë dhe përkrahjen e fëmijës. Roli i mësimit/shërbimit pedagogjik dhe punëtorëve të tjerë profesionalë është shumë i rëndësishëm.

Në këtë fazë, është me rëndësi që shkolla ta përcjellë nxënësin në mënyrë që nuk e shenjon/etiketon dhe diskriminon nga fëmijët e tjerë. Gjithashtu, është e rëndësishme që shkolla të respektojë udhëzimet që i merr nga institucionet e të tjera në përcjelljen dhe përkrahjen e nxënësit. Ajo mund të jetë një vizitë e rregullt e qendrës për punë sociale, trajtime psikiatrike, terapi me medikamente etj.

Është e domosdoshme që nxënësit t'i jepet përkrahje, me ndihmën e së cilës do të forcohen aftësitë e tij mbrojtëse, tejkalimi i problemit dhe kthimi i vetëbesimit të tij. Përkrahjen që e jep shkolla gjithsesi se duhet ta bëjë në bashkëpunim me institucionet e të tjera të inkuadruara në trajtim, gjatë informimit të ndërsjellë ose me përfshirjen aktive në punën e ekipeve ndërmjet resoreve. Në fakt shkolla paraqet një resurs i cili me të gjitha insitucionet e të tjera në koordinim, para së gjithash, me qendrën për punë sociale, marrin pjesë dhe janë pjesë e trajtimit.

### 5.5.2. Profili i nxënësit që ushtron dhunë digjitale

Nxënësit që ushtrorjnë dhunë digjitale njihen sipas disa karakteristikave:

- Fëmijë agresivë ndaj prindërve, fëmijëve të tjerë, mësimitshësve;
- Dominues, liderë, dëshirojnë të sundojnë mbi të tjerët dhe të tregojnë fuqinë e tyre;
- Superior, konsiderojnë se janë më të mirë dhe më të veshëm se të tjerët;
- Nuk pranojnë dështime, nuk janë tolerantë, nuk pranojnë dallime.

Te këta fëmijë nuk është mjaft e zhvilluar empatia dhe nuk kuptojnë se si ndihen fëmijët viktime, nuk i kuptojnë marrëdhëniet kauzale, insistojnë që të përmbushin vetëm nevojat e veta.

Pas këtij imazhi të fëmijës që kryen dhunë, mund të fshihet pasiguri, urrejtje, hidhërim, vetëbesim i ulët, probleme në famlje, ndërsa shpesh mund të jetë edhe viktimitë e ndonjë lloj dhune. Raportet në familje, pozita e fëmijës dhe stili edukues i prindit është faktor kyç për rritjen e drejtë dhe zhvillimin e fëmijës.

Fëmijët/nxënësit që kryejnë dhunë digjitale janë fëmijë me rrezik dhe fëmijë që ndeshen me ligjin dhe trajtimi i tyre do të vazhdojë në pajtim me Ligjin për drejtësi për fëmijët duke inkuadruar edhe institucionet e të tjera që janë në sistemin e drejtësisë së fëmijëve.

Pa marrë parasysh se a ka procedura gjyqësore ose jashtëgjyqësore për fëmijën që kryen dhunë digjitale, zbatohen masa për ndihmë dhe mbrojtje ose ehde sanskione, shkolla është përkrahës i rëndësishëm dhe i domosdoshëm i fëmijës në procesin e korrigjimit të tij.

### 5.5.3. Profili i nxënësve dëshmitarë ose vëzhgues të dhunës digjital

Grupi i tretë më i rëndësishëm dhe më në numër i fëmijëve që gjithashtu kanë pasoja nga dhuna digjitale, ndaj të cilave shpesh dhe harrohet, janë nxënësit vëzhgues ose dëshmitarë. Ky grup i fëmijëve i kanë të njëjta ose të ngjashme pasojat e dhunës si dhe viktimitës, por me intensitet më të vogël.

Më së shpeshti janë të frikësuar dhe ndiejnë frikë që e njëjta të mos u ndodhë edhe atyre.

Për këtë është shumë e rëndësishme që të punësohet me këtë kategori të fëmijëve që është me numër më të madh, të përfshihen në trajnime, por edhe në trajtime individuale nëse ndihen të cenuar ose janë viktime

indirekte nga dëshmimi i dhunës.

## 5.6. Roli i shtetit dhe prindërve në parandalimin, zbulimin dhe pengimin e dhunës digjitale

### 5.6.1. Krijimi i rrjetit për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna digjitale në kuadër të komunitetit



Një prej parimeve më të rëndësishme gjatë definimit të modelit të mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna digjitale është parimi i bashkëpunimit sistematik dhe të planifikuar ndërmjet të gjitha institucioneve, shërbimeve dhe organeve të pushtetit, organizatave joqeveritare dhe organizatave të tjera civile që kanë një rol të caktuar në procesin e mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna. Ajo nënkupton edhe përpilimin e një protokollit për bashkëpunim ndërmjet nxënësve dhe një sistemi të komunikimit.

Protokolli i përbashkët për veprim në rast të keqpërdorimit dhe neglizhimit të fëmijëve, është i përpiluar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale me pjesëmarrjen e të gjithë sektorëve të tanguar, në mesin e të cilëve është edhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës, por i njëjti ndoshta nuk është i mjaftueshëm për të vepruar në raste të shpeshtimit të dhunës digjitale ndaj fëmijëve.

Duhet të mendohet për udhëzues të rinj, mënyra të mbrojtjes por edhe veprime në situata të dhunës digjitale ndaj fëmijëve. Por është fakt se në shtetin tonë nuk ka hulumtime dhe analiza që do ta potenconin vëllimin e problemit, përhapjen demografike, nevojat e viktimave, por edhe pengimin e problemit.

Është e pamundur që i tërë veprimi për mbrojtje të vendoset vetëm në një sektor, për arsye se të gjithë subjektet që veprojnë në sistem, kanë obligime dhe përgjegjësi të ndryshme. Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet sektorëve të caktuar sjell derit e rezultatet e pamjaftueshme që duhet të arrihen në procesin e menjimit të dhunës. Për këto arsye nevojitet një qasje e koordinuar, duke respektuar të gjitha përgjegjësitë e sektorëve.

Rrjeti i zhvilluar i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, qeveritare dhe joqeveritare, duhet që gjithmonë të avancohet në tri nivele:

1. Avancimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit me të gjitha institucionet kompetente të përfshira në procesin për parandalimin dhe kontrollin e dhunës digjitale;

2. Intensifikimin dhe ngritjen e kualitetit të komunikimit ndërmjet të gjitha institucioneve (policisë, qendrave për punë sociale, shëndetësisë, gjyqësorit, qendrave për trajtime psikosociale, shkollave, kopshteve të fëmijëve, komunës, komuniteteve për ndihmë, shoqatave...);
3. Tendencë për rritjen e përgjegjësisë dhe ndjenjës ëpër dhunën digjitale për të gjitha institucionet kompetente.

### 5.6.2. Pse është i rëndësishëm bashkëpunimi i institucioneve të sistemit?

Rrjeti i institucioneve dhe bashkëpunimi i tyre në kuadër të procesit të parandalimit dhe kontrollit të dhunës digjitale është me rëndësi shumë të madhe, sepse përfshin:



- zbulimin e hershëm dhe parashikimin e dhunës digjitale ndërmjet fëmijëve ose nga një person i rritur;
- informimin e ndërsjellë dhe shkëmbimin e të dhënave;
- planifikimin e përbashkët gjatë mbledhjes së të dhënave dhe informatave të nevojshme;
- Harmonizimin dhe adaptimin e standardeve profesionale ndaj nevojave specifike të fëmijës viktimë dhe respektimin e parimit të individualitetit;
- Urgjencë dhe efikasitet gjatë intervenimeve të veçanta mbrojtëse individuale (ndërpitjen e dhunës dhe mbrojtjen e fëmijës gjatë procedurave që e cenojnë integritetin e tij);
- Uljen e mundësisë për "viktimizim" shtesë të fëmijës viktimë të dhunës digjitale;
- Qasje të njëjtë gjatë veprimit;
- Tejkalimi i të gjitha vështirësive dhe sfidave që paraqiten gjatë zgjidhjes së rasteve individuale;
- Konsultime ndërmjet punëtorëve profesionalë dhe marrjen e përkrahjes për punën që bëjnë, duke zhvilluar përgjegjësi dhe vlera etike.

### 5.6.3. Kujdesi për fëmijët dhe kujdesi prindëror në erën e internetit

Një prej sfidave më të mëdha para prindërve/jujdestarëve është se si ta adaptojnë rolin dhe kujdesin e tyre për fëmijët në erën e internetit.

Paraqitja e internetit e ndryshoi mënyrën e jetesës edhe në të ardhmën do ta ndryshojë çdo ditë. Sidoqoftë, esenca e kujdesit për fëmijët dhe kujdesi prindëror mbetet i njëjtë dhe i pandryshuar. Kjo nënkupton se prindërit dhe personat e tjerë të rritur të cilët kujdesen për fëmijët, siç kujdesen për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve (edhe pse nuk janë mjek me profesion), për arsimimin e tyre (edhe pse nuk janë mësues), mënyrën e sjelljes (edhe pse nuk janë pedagog, psikolog, sociolog), gjithashtu edhe pse nuk janë informatikanë, do të mësojnë që të kujdesen për arsimimin digjital të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna në internet.

Kur prindërit i mësojnë fëmijët të notojnë, ata nuk i hedhin menjëherë në ujë për t'i lënë të gjinden vetë, por ju tregojnë, sqarojnë, ju japin përkrahje me gomë, instruktor, deri sa nuk sigurohen se kanë mësuar dhe kanë fituar aftësinë e të notuarit. Pasi që të mësohen, në kohë të caktuar prindi i mbikëqyr fëmijët deri sa të pavarësohen gradualisht.

E njëjta është edhe me internetin, nga prindi pritet që të bëjë hapat e parë për shfrytëzimin e tij dhe të pajisjeve digjitale dhe të ndërmjetësojë gjatë shfrytëzimit të tyre nga ana e fëmijëve deri sa nuk sigurohen

se fëmijët janë të gatshëm (në aspekt intelektual, social, emocional dhe edukativ) për shfrytëzim të pavarur. Nevojitet që të jetë mentor i tyre digjital. Ajo nuk nënkupton se duhet të jetë ekspert për teknologji, por një njohës i mirë i fëmijës së tij dhe të nevojave të tyre.

Fëmijët që kanë lindur në dy dekadat e fundit i quajmë net gjeneratë, google gjeneratë, fëmijë të mileniumit të ri etj.

Të gjitha rregullat që vlejnë për komunikimin, "sy më sy" vlejnë edhe për komunikimin digjital. Për këtë të rriturit, respektivisht prindërit dhe mësime dhënësit ndoshta kanë më së paku njohuri dhe shkathtësi digjitale dhe kjo nuk guxon që të anashkalohej.

## Këshilla për prindërit/kujdestarët për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna digjitale

1. Zbatoni parimet e kujdesit pozitiv prindëror: lidhjen me fëmijën, respektimin e nevojave dhe të drejtave të fëmijës, prindëri proaktive, udhëheqje empatike dhe disiplinë pozitive. Në këtë mënyrë do të afrohen me fëmijët, do të bashkëpunojnë me ju, pa kundërshtime dhe mospajtime ndaj propozimeve tuaja;
2. Vendosni rregulla për shfrytëzimin e internetit dhe pajisjeve digjitale. Së bashku me fëmijët duhet të përcaktoni se cila pajisje sa kohë duhet të përdoret brenda ditës, në cilat raste nuk përdoret, si do të veprohet në situata të paparashikuara jashtë marrëveshjes, cilat janë privilegjet e cilat pasojat. Qëndroni të denjë ndaj asaj marrëveshje;
3. Qëndroni të hapur me fëmijët dhe bëni ata të bashkëpunojnë. Bisedoni për tema që mund t'i "mësojnë" në internet, në mënyrë adekuate, për dashurinë për seksualitetin, që të mund të jeni të hapur dhe t'ju drejtohen kur do të hasin në ndonjë problem. Është shumë me rëndësi të mësojnë të kyçen sigurt në botën virtuale, se sa t'i mbani vazhdimisht për dore;
4. Mësoni fëmijët se si ta shfrytëzojnë internetin dhe pajisjet digjitale dhe si ti njohin rreziqet. Mësoni se si të sillen në rrjetet sociale dhe si në jetën reale, sepse edhe atje vlejnë të njëjtat vlera dhe rregulla, të mos kontaktojnë me persona të panjohur dhe të mos pranojnë dhurata (lojëra, karta, mbushje për celularin etj.). Bisedoni shpesh dhe hapur me ta për atë që kanë bërë, kanë parë dhe me kë kanë kontaktuar në internet, njëkohësisht përkujtojani rreziqet dhe rregullat;
5. Mësoni fëmijët që nga mosha e hershme të mos shpërndajnë fotografi private, të dhëna personale dhe mendime intime;
6. Rregulloni pajisjet digjitale dhe rrjetet sociale më privatësinë më të madhe të mundshme. Shfrytëzoni veglat e rekomanduara ose konsultoni operatorët e internetit;
7. Kini kujdes me shpërndarjen (sharing), sepse dhunuesi hulumton dhe përcjell të gjitha forumet që fëmija i shpërndan dhe me kë bisedon;
8. Reagoni shpejtë dhe në kohë nëse fëmija është shqetësuar nga dikush tjetër. Zbuloni se çfarë komunikimi kanë shfrytëzuar, mos i fshini porosinë, bisedat, emaillet, sepse mund të jenë argument. Mes të tjerash në përmbajtje nëse zbuloni përmbajtje eksplicite seksuale ose pornografike, detyrimisht ato paraqitni në polici;
9. Nëse ndonjë shfrytëzues tjetër ju kërkon fotografi fëmijëve, ndizni alarmin-pse, si, kush? Bisedoni me fëmijët, mësoni që tju tregojnë nëse dikush fillon t'i kërcënojë, kushtëzojë, lëndojë;
10. Mësoni fëmijët që të ndërpresin komunikimet e dyshimta me personat e panjohur dhe bllokoni ata. Me komunikim të dyshimtë mendojmë në bisedat e pakëndshme, nëse dicka që nuk e dojnë ju imponohet, insistohet që të shikojnë ndonjë film etj.;
11. Mësoni që ta njohin dhunuesin potencial. Zakonisht ata kanë profile të rrejshme, por që ta njohin sipas sjelljes së tij, sipas mënyrës dhe përmbajtjes së pyetjeve të parashtruara, nëse shmangin përgjigjen e pyetjeve për ta dhe me çdo kusht duan që t'u afrohen fëmijëve.

12. Respektoni, pavarësinë, interesat dhe aktivitetet e tyre nëse janë adekuate për moshën e tyre;
13. Nëse keni situatë që fëmija insiston të njoftohet me një shok/shoqe në internet, potencioni se ajo duhet të ndodhë patjetër në vend publik dhe në takimin e parë detyrimisht të sjellin me vete një shok/shoqe ose person të rritur. Potencojeni këtë situatë pa e prekur privatësinë e fëmijës;
14. Mësoni fëmijët të mos shpërndajnë komente dhe përmbajtje të pahijshme të cilat përmbajnë ofendime, gjuhë të urrejtjes dhe që mund tikë të lëndojnë ose të humbin ndonjë shok. Të jenë lojtarë fer në poligonin virtuel;
15. Mësoni më tepër për mundësitë e pajsiveve digjitale, nocionet themelore që shfrytëzohen në botën virtuale, që të mund të bisedoni me fëmijët lidhur me aktivitetet dhe përvojat e tyre;
16. Informohuni për programet që filtrojnë ueb-faqet që nuk doni të jenë të qasshme për fëmijët. Mund të angazhoni një profesionist që t'i aplikojë, por patjetër duhet të potencohet se asnjë program nuk është i përsosur, por mund të kuptohen vetëm si vegla ndihmëse.

Në Raportin e Qustodio<sup>43</sup> për vitin 2020 ju rekomandohet si vijon:

- Fikni ekranet 1 orë para gjumit që të shmangni dritën e kaltër dhe të përmirësoni kualitetin e gjumit. Koha në ekran asnjëherë nuk duhet ta zëvendësojë kohën e gjumit;
- Shembni muret ndërmjet ju dhe fëmijëve tuaj duke shikuar së bashku video klipe dhe duke luajtur së bashku video lojra kur keni mundësi;
- Balanconi kohën e kaluar para ekranit me lëvizje dhe ushtrime përkatëse, së paku 60 minuta brenda ditës. Koha e kaluar para ekranit nuk duhet të jetë në llogari të aktivitetit fizik.
- Vetëdijësohuni se shumica e platformave për "online" video, lojra dhe rrjete sociale janë të disejuara që të krijojnë varshmëri, andaj vendosja e kufizimeve të ekranit është kyçe dhe kështu vendosni pauzë pas 45 minutave;
- Theksoni modelet pozitive të rrjeteve sociale që fëmija juaj mund t'i përcjellë;
- Ruani konzolat për video lojra në vendet e zakonshme të shtëpisë, që të siguroheni se fëmijët gjatë natës nuk i shfrytëzojnë ato;
- Kontrolloni rejtingun e video lojrave игри (PEGI, ESRB, Common Sense) që të siguroheni se përmbajtja është e përshtatur me moshën, bllokoni lojra që përmbajnë mundësi për të shfrytëzuar kuti me dhurata (loot boxes), kuti dhe dhoma për bisedë me të huaj dhe vendosni kufizime të rrepta kohore;
- Sigurohuni se fëmija juaj shfrytëzon aplikacione për arsimim për të plotësuar mësimin, e jo për ta zëvendësuar atë, munfesa e kontaktit të gjallë ka ndikim negative ndaj mësimin dhe zhvillimit të fëmijës.

Sifoqoftë, filtri më i mirë është prania e prindit/kujdestarit, mbikëqyrja e denjë, sqarimi dhe përkrahja. Gjithsesi se këto këshilla të selektohen gjatë zbatimit të tyre dhe të merret parasysh individualiteti i secilit fëmijë, nevojat e tij, moshën si dhe sfidat që i keni kaluar me të.

Këto këshilla janë bazë për ndërtimin e besimit ndërmjet fëmijëve dhe të rriturve, nxitje për bashkëpunim, transparencë dhe inkurajim për fëmijët që ti besojnë dikujt. Gjithsesi se këto këshilla përsosin vazhdimisht dhe përditë, siç rriten edhe mundësitë e internetit. Por më e rëndësishme është që fëmijët të paraqesin dhënë dhe të posedojnë njohuri të mjaftueshme për ta njohur dhe për të reaguar. Për këtë, është shumë me rëndësi edhe sistemi arsimor që duhet t'u mundësojë fëmijëve arsimimin digjital, ndërsa siguria e internetit është pjesë përbërëse e tij. Vetëm ashtu nga mbikëqyrës pasivë të dhunës digjitale, fëmijët do të jenë proaktivë dhe të inkurajuar që ta paraqesin atë.

43 [https://qweb.cdn.prismic.io/qëeb/f5057b93-3d28-4fd2-be2e-d040b897f82d\\_ADR\\_en\\_Qustodio+2020+report.pdf](https://qweb.cdn.prismic.io/qëeb/f5057b93-3d28-4fd2-be2e-d040b897f82d_ADR_en_Qustodio+2020+report.pdf)

## Test i shkurtër!

Që prindërit/kujdestarët/edukatorët të kontrollojnë nëse internetin dhe pajisjet digjitale që shfrytëzojnë fëmijët janë adekuate me nevojat e tyre zhvillimore, duhet të përgjigjen në këto 3 pyetjet në vazhdim:

Çfarë kualiteti është përmbajtja që është e qasshme për fëmijë, nëse e nxit zhvillimin kognitiv, kreativitetin, zhvillon interesa, aftësi, talente?

Në çfarë konteksti e shfrytëzon internetin? Vallë fëmijët, para, gjatë dhe pas shfrytëzimit të internetit kanë mundësi të bisedojnë me të rriturit ose moshatarët dhe të flasin se çfarë kanë përjetuar ose parë?

Vallë interneti dhe pajisjet digjitale janë të përshtatura me nevojat, aftësitë dhe interesat e fëmijëve, respektivisht karakteristikat e tyre personale?

Nëse përgjigjja e këtyre tri pyetjeve është afirmative, atëherë jeni në rrugën e drejtë!

## ME RËNDËSI

- √ Çdo fëmijë ka të drejtë të rritet pa dhunë, lëndime ose keqpërdorime;
- √ Sjellja e fëmijës është problemi, jo vetë fëmija;
- √ Edhe fëmijës viktimë edhe fëmijës dhunues i nevojitet ndihmë;
- √ Përfshini prindërit/kujdestarët;
- √ Në shkollë askush (nxënës, i punësuar) nuk guxon të jetë i dhunshëm;
- √ Më efikase është ju vetë të dëshmohe mi model pozitiv i sjelljes;
- √ Shkolla patjetër duhet të jetë vendi ku të gjithë do të ndihen të sigurt, me siguri dhe të mbrojtur.

## KONKLUZION

Edhe pse teknologjia digjitale ka lehtëuar mësimin dhe lidhjen e fëmijëve me botën rreth tyre, nuk duhet të nënçmohen rreziqet në aspekt të sigurisë, privatësisë dhe mirëqenies së fëmijëve.

Në veçanti fëmijët e prekshëm të ballafaquar me shumë rreziqe të përditshmërisë, u bënë edhe më të prekshëm në botën virtuale, ndërsa dhuna e përjetuar mund t'ju lëjë pasoja që do të ndikojnë në jetën e tyre dhe vendimet që do t'i sjellin. Dhuna digjitale sjell rreziqet nga të gjitha format e dhunës në kuptim më të gjerë të fjalës, siç janë, dhuna seksuale, dhuna psikike, dhuna e moshatarëve, gjuha e urrejtjes, nënçmimi, stigmatizimi, por edhe nxitja e urrejtjes në shumë sfera që detyrimisht con drejt pasojave përkatëse, respektivisht domino efektit edhe në të gjitha sferat e jetës fëmijërore.

Dhuna digjitale është e fshehtë, jo mjaft e njohur dhe në vetvete fsheh shumë fshehtësi. Ky Doracak duhet të kontribuojë që ajo të mbetet e dukshme, duhe u dhënë mësimdhënësve dhe punëtorëve profesionalë një përmbajtje të dukshme, informata dhe resurse për punë me fëmijët, me qëllim të ngritjes së njohurive, informatave dhe qasjes së tyre në botën digjitale, pasojat e dukshme, ku jo vetëm që mbrohen fëmijët, por edhe inkurajohen edhe fëmijët viktimë që të ngrenë zërin, të inkurajohen që të paraqesin dhe të gjejnë një ambient që nuk i gjykon, por që ju ofron ndihmë dhe përkrahje.

Në shtetin tonë ka rregullativë solide ligjore për mbrojtjen e fëmijëve nga çdo lloj dhune, por nevojitet koordinim i denjë dhe strukturor i institucioneve, forcimin e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe përkushtim në zgjidhjen e problemeve të fëmijëve. Për këtë nevojitet rritje e kapaciteteve profesionale të profesionistëve nëpërmjet trajnimeve dhe përmirësimit të kushteve dhe resurseve për zbatimin e parandalimit, mbrojtjes dhe përkrahjes së fëmijëve.

Të moshuarit duhet të punojnë në interes të fëmijëve dhe të gjitha procedurat të orientohen drejt interes më të mirë të fëmijëve. Përgjegjësia e të moshuarve është që të krijohet një ambient i sigurt për fëmijët, me mekanizma të qasshëm për parandalim dhe mbrojtje, por edhe përkrahje profesionale dhe shërim të shpejtë të fëmijëve viktimë. Për këtë duhet të edukojnë fëmijët të inkurajuar dhe të fortë, t'ju japim zë dhe mundësi për të punuar, për të besuar dhe për të kyçur alarmin, ndërsa të rriturit t'i shohin ato dhe të japin përkrahje.


Doracaku ofron informata për inernetin, përfitimet nga shfrytëzimi i tij, por edhe rreziqet e fëmijëve, jep një pasqyrë për njohjen e dhunës digjitale dhe veprimet të mësimdhënësve dhe rolit të shkollës, si dhe këshilla praktike, tekste të shkurta dhe ushtrime për kontrollin e njohurive të mësimdhënësve, që mund të shfrytëzohen nga ana e tyre edhe gjatë punës me fëmijë ose që të japin ide dhe udhëzime për punëtoritë e të tjera. Përmbajtja e Doracakut është përplot me informata për mediet aktuale sociale dhe gjuhën e komunikimit në botën digjitale që e shfrytëzojnë fëmijët dhe mund të jetë nxitës për avancimin e shkathtësive personale të mësimdhënësve.

Besojmë se vlerat që promovohen në këtë Doracak për komunikim të sigurt të komunikimit si në botën reale ashtu edhe në atë digjitale, Do të inkurajojë mësimdhënësit që të rrinë afër nxënësve e që ata kanë një vend të veçantë në jetën e tyre fëmijërore, duke vazhduar t'i mësojnë për kulturën e komunikimit, përvojat e vlefshme, përfitimet të shkathtësive jetësore që janë të rëndësishme edhe për botën digjitale. Vetëm me punë ekipore dhe angazhim e përkushtim të përbashkët mund të kontribuohet ndaj kulturës së komunikimit në internet dhe ambientit të sigurt të nxënësve.

Dhe për në fund.... Të gjithë jemi përgjegjës për parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe krijimit të një zone të sigurt për rritjen dhe zhvillimin e tyre të drejtë.

Ushtrim edukativ me nxënës:

## Krijimi i miqësisë në internet



1. Zana ka 11 vjet dhe e do shumë internetin. Shfleton material për në shkollë, e intereson muzika, lexon për modën, por veçanërisht dëshiron ta shfrytëzojë chat/chat opsionin. Di të bisedojë me orë me të njohur dhe të panjohur për modën dhe muzikën.



2. Një ditë njoftohet me Agimin i cili ka 12 vjet. I pëlqen e njëjta muzikë sikur Zanës, ndërsa merr vesh shumë edhe nga moda e meshkujve. Me ditë bisedojnë për koncertet e bendit që e adhurojnë, por njëkohësisht edhe për problemet familjare, për prindërit e saj dhe motrën e vogël. Edhe ai ka të njëjtin problem që është vazhdimisht i vetëm, sepse prindërit i ka në punë gjatë tërë ditës. Por edhe shumë bukur duket në fotografinë që e ka dërguar.



3. Gjithnjë e më shpesh bisedojnë për problemet në shtëpi, për prindërit që ju vendosin ndalesa. Zana ndihet shumë e afërt dhe ia dha numrin e telefonit celular për të shkëmbyer porosi. Por pas disa ditëve arriti një porosi me propozim për t'u takuar dhe njohtuar. Zana e pranoi atë me kënaqësi.



4. Kur Zana arriti në vendin e caktuar nuk mund ta shihte Agimin, por një person të moshuar që rrinte ulur në tavolinë. Zana u befasua kur e pa se njeriu u përgjigj në thirrjen e saj telefonie kur ajo e kërkoi Agimin.




5. Shpejtë e ndërpreu lidhjen, sepse kuptoi se ai njeri kishte komunikuar me të e jo 12 vjeçari Agim. Arriti të gjindet dhe filloi të largohet shpejt nga vendi, por ndiente se zemra do t'i dalë nga shqetësimi dhe frika. Ajo u lehtësua kur arriti në shtëpi dhe ju lajmërua së ëmës për t'i treguar se çfarë i kishte ndodhur.



6. Gabimet që i bëri Zana janë:

- Nuk i informoi prindërit për komunikimin me mikun e ri në çat
- Nuk e kontrolloi fotografinë që Agim ia dërgoi
- Ia dha numrin e vet të telefonit;
- I zbuloi atij shumë fakte familjare, emra të prindërve dhe motrës, ku punojnë me çfarë probleme ballafaqohen;
- Caktoi një takim me të pa ju treguar prindërve për vendin dhe orën e takimit
- Në takim shkoi e vetme.

Mësimdhënësi pas përpunimit dhe diskutimit me ngjarjen paraprake, ju jep nxënësve detyrë që të shkruajnë një tregim të ri me të njëjtat fotografi.





## Burimet e shfrytëzuara (sipas renditjes së citimit):

- Is COVID-19 Making Cyberbullying Worse?, June 15, 2020;  
<https://www.pandasecurity.com/en/mediacenter/mobile-news/covid-19-cyberbullying/>
- Facts About Bullying;  
<https://www.stopbullying.gov/resources/facts>
- Internet in Europe Stats;  
<https://www.internetworldstats.com/stats4.htm>;
- The Top 20 Valuable Facebook Statistics – Updated October 2020;  
<https://zephoria.com/top-15-valuable-facebook-statistics/>
- European Education Area;  
<https://ec.europa.eu/education/education-in-the-eu/european-education-area>
- Digital Education Action Plan (2021-2027);  
[https://ec.europa.eu/education/education-in-the-eu/digital-education-action-plan\\_en](https://ec.europa.eu/education/education-in-the-eu/digital-education-action-plan_en)
- Регистар на педофили;  
<http://registarnapedofili.mk/>;
- Завод за статистика на Република Северна Македонија;  
<http://www.stat.gov.mk/>
- Hasebrink et al., 2009-преземено од EU Kids “online” Network: Hasebrink, Livingstone & Haddon, 2009.  
<https://www.unicef.org/press-releases/children-increased-risk-harm-online-during-global-covid-19-pandemic>
- Online and ICT facilitated violence against women and girls during COVID-19, UN WOMEN;  
<https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/04/brief-online-and-ict-facilitated-violence-against-women-and-girls-during-covid-19>
- Leaders' statement - Violence against children: A hidden crisis of the COVID-19 pandemic;  
<https://violenceagainstchildren.un.org/news/leaders-statement-violence-against-children-hidden-crisis-covid-19-pandemic>
- Inter-Agency Working Group on Violence against Children;  
[https://www.ohchr.org/Documents/Events/COVID-19/Agenda\\_for\\_Action\\_IAWG-VAC.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/Events/COVID-19/Agenda_for_Action_IAWG-VAC.pdf)
- Социјалните и економските ефекти од КОВИД-19 врз децата во Северна Македонија, Брза анализа и предлози за политиките;  
<https://www.unicef.org/northmacedonia/mk/socijalnite-i-ekonomskite-efekti-od-KOVID-19-vrz-decata>
- Council of Europe Strategy for the Rights of the Child (2016-2021);  
<https://rm.coe.int/168066cff8>
- Recommendation CM/Rec(2018)7 of the Committee of Ministers to member States on Guidelines to respect, protect and fulfil the rights of the child in the digital environment;  
<https://edoc.coe.int/en/children-and-the-internet/7921-guidelines-to-respect-protect-and-fulfil-the-rights-of-the-child-in-the-digital-environment-recommendation-cmrec20187-of-the-committee-of-ministers.html>
- Internet: Case-law of the European Court of Human Rights;  
[https://www.echr.coe.int/Documents/Research\\_report\\_internet\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Research_report_internet_ENG.pdf)
- Smahel, D., Machackova, H., Mascheroni, G., Dedkova, L., Staksrud, E., Ólafsson, K., Livingstone, S., and Hasebrink, U. (2020).
- EU Kids Online 2020: Survey results from 19 countries;  
<https://www.eukidsonline.ch/files/Eu-kids-online-2020-international-report.pdf>

- COVID-19: CHILD SEXUAL EXPLOITATION;  
<https://www.europol.europa.eu/covid-19/covid-19-child-sexual-exploitation>
- COVID-19 in children and the role of school settings in COVID-19 transmission;  
<https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/COVID-19-schools-transmission-August%202020.pdf>
- Instagram is leading social media platform for child grooming;  
<https://edition.cnn.com/2019/03/01/uk/nspcc-grooming-social-media-report-scli-gbr-intl/index.html>
- The easiest way to supervise your kids online;  
<https://www.qustodio.com>
- StopBullying.gov. Bullying as an Adverse Childhood Event (ACE), 2017;  
<https://www.stopbullying.gov/sites/default/files/2017-10/bullying-as-an-ace-fact-sheet.pdf>
- J. Clement, Global social networks ranked by number of users 2020;  
<https://www.statista.com/statistics/272014/global-social-networks-ranked-by-number-of-users/>
- YouTube, Instagram and Snapchat are the most popular online platforms among teens;  
[https://www.pewresearch.org/internet/2018/05/31/teens-social-media-technology-2018/pi\\_2018-05-31\\_teenstech\\_0-01/](https://www.pewresearch.org/internet/2018/05/31/teens-social-media-technology-2018/pi_2018-05-31_teenstech_0-01/)
- Bullying On Twitter: Researchers Find 15,000 Bully-Related Tweets Sent Daily;  
[https://www.huffpost.com/entry/bullying-on-twitter\\_n\\_1732952](https://www.huffpost.com/entry/bullying-on-twitter_n_1732952)
- Online Grooming;  
<https://www.childline.org.uk/info-advice/bullying-abuse-safety/online-mobile-safety/online-grooming/>
- Trauma, Bullying, and Cyberbullying  
<https://cyberbullying.org/trauma-bullying-cyberbullying>
- SAMHSA's concept of trauma and guidance for a trauma-informed approach. HHS Publication No (SMA) 14-4884, 2014;  
[https://ncsacw.samhsa.gov/userfiles/files/SAMHSA\\_Trauma.pdf](https://ncsacw.samhsa.gov/userfiles/files/SAMHSA_Trauma.pdf)
- Mynard H, Joseph S, Alexander J. Peer-victimisation and posttraumatic stress in adolescents. *Personality and Individual Differences*. 2000, 29(5), pp. 815-821.
- Rivers I. Recollections of bullying at school and their long-term implications for lesbians, gay men, and bisexuals. *Crisis*. 2004, 25(4), pp. 169-175.
- Nielsen MB, Tangen T, Idsoe T, Matthiesen SB, Magerøy N. Post-traumatic stress disorder as a consequence of bullying at work and at school. A literature review and meta-analysis. *Aggression and violent behavior*. 2015, 21, pp. 17-24.
- Дигитално насиље – превенција и реаговање Издавачи: Министарство просвете, науке и технолошког развоја Републике Србије и Педагошко друштво Србије Ауторке: Добринка Кузмановић, Биљана Лајовић, Смиљана Грујић и Гордана Меденица, Штампа: Цицero, Београд, 2016
- Völlink, T., Bolman, C., Dehue, F., & Jacobs, N. (2013). Coping with cyberbullying: differences between victims, bully-victims and children not involved in bullying. *Journal of Community and Applied Social Psychology*, 23, 7-24
- Qustodio 2020 Report on Children's Digital Habits: Connected More than Ever,  
<https://bit.ly/2J3cN5m>

